# VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ARSIMIT (2022 – 2026)

# PËR PERIUDHËN 2022-2023

**Prishtinë**

**Qershor 2024**

## Përmbajtja

**1. Hyrje** ..... 3

**2. Metodologjia** ..... 4

**3. Përmbledhje e arritjeve të përgjithshme të zbatimit të Strategjisë së Arsimit** ..... 6

**4. Zbatimi i Pesë Objektivave Strategjike të Strategjisë, Sfidat, dhe Rekomandimet** ..... 9

**4.1. Objektivi strategjik 1: Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme** ..... 9

**4.2. Objektivi strategjik 2: Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore** ..... 13

**4.3. Objektivi strategjik 3: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës** ..... 17

**4.4. Objektivi strategjik 4: Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë** ..... 22

**4.5. Objektivi strategjik 5: Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital** ..... 27

**SHTOJCA I – MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITET 2022-2023** ..... 30

# 1. Hyrje

Ky raport paraqet raportin vlerësues për zbatimin e pesë Objektivave Strategjikë (OS) të Strategjisë së Arsimit (2022-2026) për vitet 2022 – 2023. Strategjia e Arsimit (SA), e cila u miratua në shtator të vitit 2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë në periudhën 2022-2026. Strategjia e Arsimit bazohet në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025 dhe analizën e gjendjes të fushave prioritare të sektorit të arsimit.[1]

Pesë objektivat strategjikë të Strategjisë të cilat synojnë adresimin e problemeve kyçe të fushave prioritare të sektorit të arsimit në Kosovë, janë:

1. **Objektivi strategjik 1:** Ritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme
2. **Objektivi strategjik 2:** Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore
3. **Objektivi strategjik 3:** Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës
4. **Objektivi strategjik 4:** Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë
5. **Objektivi strategjik 5:** Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital

Për secilin objektiv strategjik të Strategjisë së Arsimit, është përgatitur Plani i Veprimit të Strategjisë (2022-2026)[2], me aktivitetet apo veprimet e parapara për arritjen e atij objektivi, treguesit përkatës, si dhe koston përkatëse. Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së Arsimit (2022-2026), pesë objektivat strategjikë më tej ndahen në gjithsej 28 objektiva specifike, të cilat përfshijnë aktivitete apo veprime të ndryshme që parashihen të realizohen deri në fund të vitit 2026.

Raporti i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë ka për qëllim që të evidentojë shkallën e zbatimit të aktiviteteve të paraqitura në Planin e Veprimit të Zbatimit të Strategjisë së Arsimit (2022-2026) për periudhën 2022-2023, si dhe të evidentojë sfidat dhe të propozojë rekomandime për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse. Më tej, vlerësimi i SA-së synon të mbështesë politikë-bërjen e bazuar në prova dhe të nxjerrë mësime kyçe nga ndërhyrjet programatike të Strategjisë, të cilat do të mbështesin përmirësimin e ndërhyrjeve gjatë periudhës së mbuluar (2022-2026) si dhe të ofrojë udhëzime në zhvillimin e ciklit të ri të Strategjisë.

[1] Në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025, janë përcaktuar 5 fusha si orientime kryesore për intervenim dhe zhvillim në sektorin e arsimit: 1) Arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar, 2) Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës, 3) Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, 4) Arsimi i lartë me cilësi dhe integritet, në harmoni me standardet ndërkombëtare, dhe 5) Përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion.

[2] Plani i veprimit, buxheti i SA dhe treguesit për secilën objektivë, janë paraqitur në pjesën e shtojcave të Strategjisë së Arsimit (2022-2026).

## 2. Metodologjia

Ky raport fokusohet në vlerësimin e zbatueshmërisë së objektivave specifikë të parapara në Strategjinë e Arsimit (2022-2026), për periudhën 2022-2023. Vlerësimi i kriterit të *zbatueshmërisë* nënkupton rishikimin se deri në çfarë mase janë zbatuar intervenimet apo veprimet e parapara të Strategjisë.[3]

Për qëllimet e vlerësimit është zhvilluar një matricë apo tabelë e vlerësimit (shih Shtojca I), në bazë të së cilës janë organizuar përditësimet dhe vlerësimet e veprimeve të zbatuara, të plotësuara nga nëpunësit përgjegjës në nivelin qendror dhe lokal të arsimit, për të kuptuar më mirë intervenimet e zbatuara nga Strategjia.

Ndër të tjerash, matrica apo tabela e përdorur për vlerësim përfshin të dhëna cilësore dhe sasiore mbi të arriturat, sfidat, dhe rekomandimet përkatëse për secilin veprim të planifikuar në pesë objektivat strategjikë të SA-së. Për më tepër, ajo gjithashtu përfshin edhe kategorizimin e progresit të arritur drejt zbatimit të atij aktiviteti, sipas kornizës së vlerësimit paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1. Korniza e vlerësimit të zbatueshmërisë së veprimeve të parapara në Strategjinë e Arsimit**

| KORNIZA E VLERËSIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **Vlerësimi** | **Kriteret** | **Shkalla** | **%** |
| **Shumë pak ose aspak përparim** | • Nuk ekzistojnë ligjet primare, udhëzimet, rregullat, strategjitë dhe politikat.<br>• Kemi mungesë të hapave për zbatim të ligjeve dhe politikave.<br>• Nuk janë alokuar burime për menaxhim, burime njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatim të ligjeve, rregullave, udhëzimeve, strategjive dhe politikave | 1 | 0-19% |
| **Pak përparim** | • Ekzistojnë ligjet primare, rregullat, udhëzimet, strategjitë dhe politikat<br>• Ka vetëm përpjekje të kufizuara për zbatim të praktikave të mira. Mirëpo zbatimi nuk është dukuri e zakonshme.<br>• Nuk janë alokuar burime financiare apo janë të pamjaftueshme | 2 | 20-39% |
| **Në përparim e sipër** | • Janë miratuar të ligjet dhe politika në kuadër të sektorit apo objektivit.<br>• Ekzistojnë praktika të mira dhe legjislacioni ka filluar të zbatohet në dy vitet e fundit. Mirëpo ende ka ngecje në zbatim të praktikave të caktuara, në legjislacion dhe praktika.<br>• Janë alokuar mjete modeste financiare për zbatim të pjesëve të caktuara të legjislacionit dhe politikave | 3 | 40-59% |

[3] Përshtatur nga OECD: Kriteret e Vlerësimit

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Përparim i theksuar** | • Të gjitha ligjet, udhëzimet dhe politikat janë miratuar<br>• Kemi një praktikë të zhvilluar në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve. Ligjet janë zbatuar në mënyrë konsistente në katër vitet e fundit.<br>• Kapacitetet institucionale janë në funksion mirëpo me shkurtesa financiare | 4 | 60-79% |
| **Përmbushur plotësisht** | • Janë miratuar të gjitha ligjet dhe udhëzimet.<br>• Kemi zbatim konsistent të legjislacionit në pesë vitet e fundit.<br>• Zbatimi i është normë dhe pengesat mund të jenë shumë të rralla apo të izoluara.<br>• Kapacitetet institucionale janë plotësisht funksionale dhe financimi është adekuat për rrjedhën e zbatimit të legjislacionit dhe praktikave | 5 | 80-100% |

Kapitulli në vijim paraqet arritjen e zbatimit të objektivave strategjikë në tërësi, sipas përqindjeve të shtjelluara më lart. Më pas, kapitulli 4 shtjellon të arriturat, sfidat, dhe rekomandimet për secilin nga 5 objektivat strategjikë.

Vlen të theksohet se progresi mbi arritjen e disa veprimeve të planifikuara sipas Planit të Veprimit nuk është raportuar, kryesisht si pasojë e mungesës së të dhënave lidhur me nivelin e zbatueshmërisë së veprimit në fjalë. Në sigurimin e të dhënave përkatëse, raporti do të përditësohet për të reflektuar zbatueshmërinë e veprimeve të mbetura.

## 3. Përmbledhje e arritjeve të përgjithshme të zbatimit të Strategjisë së Arsimit

Ky raport paraqet përmbledhjen e arritjeve të përgjithme të zbatimit të Strategjisë së Arsimit, duke reflektuar lidhur me nivelin e zbatueshmërinë së objektivave strategjike një deri pesë. Ky kapitull përqendrohet në paraqitjen e përqindjet e veprimeve që vlerësohen të jenë zbatuar gjatë viteve 2022-2023, për pesë objektivat strategjike të SA-së.

Në nivelin e përgjithshëm të zbatimit të objektivave strategjike, OS1 ka rezultuar me përparim më të theksuar, me 38% të veprimeve të cilat janë zbatuar me përparim të theksuar (60-79%) apo përmbushur (80-100%). Më pastaj, rangohet OS3, me 35% të veprimeve që kanë përparim të theksuar apo janë përmbushur, ndërsa tutje është OS4 me 34%, respektivisht OS2 me 49% të veprimeve që kanë përparim të theksuar apo janë përmbushur përgjatë periudhës raportuese.  Gjithashtu duhet theksuar se, përderisa OS3 dhe OS4 kanë nivel më të lartë të veprimeve që kanë pasur përparim përgjatë periudhës raportuese (një e treta, respektivisht 31% të veprimeve janë në përparim e sipër), OS2 ka nivelin më të lartë (31%) të veprimeve që kanë pasur pak progres.  Objektiva strategjike 5 ka nivelin me të ultë të raportuara të përmbushjes, ku vetëm 7% të veprimeve janë përmbushur. Për këtë objektivë, njëherit, ka edhe numër më të madh të veprimeve që nuk ka raportime, respektivisht për 83% të veprimeve nuk ka raportime për nivelin e zbatimit.

**Grafiku 1. Përmbledhja e nivelit të zbatimit të veprimeve të Objektivave Strategjike të Strategjisë së Arsimit (OS1 – OS5), gjatë viteve 2022-2023**




Në analizën e mëtutjeshme të të dhënave, del se nga 5 objektivat strategjike të trajtuara, objektivi strategjik 1 ka arritur zbatueshmërinë më të madhe me 22% të veprimeve duke u përmbushur në shkallën 80-100%. Më pas është OS2 me 18%, OS4 me 17%, dhe në fund OS3 me 15%.

**Grafiku 1a. Përqindja e veprimeve të zbatuara plotësisht për katër Objektivat Strategjike të Strategjisë së Arsimit (OS1 – OS5), gjatë viteve 2022-2023**




Në anën tjetër, në grafikun e mëposhtëm gjithashtu është paraqitur niveli më i ulët i përmbushjes së veprimeve për objektivat strategjike veçmas. Sipas kësaj analize, objektivi strategjik 1 ka arritur zbatueshmërinë më të ultë me 21% të veprimeve në të cilat ka pak apo aspak përparim, respektivisht zbatim në shkallën 0-19%. Më pas është OS2 me 18%, OS4 me 17%, dhe në fund OS3 me 15%. Objektiva strategjike 5 ka 5% të veprimeve që nuk kanë shënuar aspak progres, por ka nivel shumë të lartë të veprimeve të paraportuara.

**Grafiku 1b. Përqindja e veprimeve me pak apo aspak përparim për katër Objektivat Strategjike të Strategjisë së Arsimit (OS1 – OS5), gjatë viteve 2022-2023**



# 4. Zbatimi i Pesë Objektivave Strategjike të Strategjisë, Sfidat, dhe Rekomandimet

Ky kapitull shtjellon më detajisht zbatueshmërinë e veprimeve për secilin objektiv strategjik, duke pasqyruar nivelin e zbatueshmërisë së veprimeve të parapara sipas objektivave specifike strategjike përkatëse. Gjithashtu, ky kapitull shtjellon edhe sfidat kryesore lidhur me zbatueshmërinë e veprimeve në fjalë.

## 4.1. Objektivi strategjik 1: Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme

**Përshkrim i shkurtër i Objektivit Strategjik**

Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (EFH) synon zhvillimin parësor të nevojave shoqërore, emocionale, njohëse dhe fizike të një fëmije, në mënyrë që të ndërtojë një bazë të fortë dhe të gjerë për të mësuarit dhe mirëqenien gjatë gjithë jetës, prandaj përfshirja dhe pjesëmarrja e barabartë për të gjithë fëmijët në edukimin cilësor të hershëm, nuk mund të realizohet pa krijimin e infrastrukturës adekuate.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik, MASHTI fillimisht ka paraparë kryerjen e një analize të mirëfilltë për këtë nivel të arsimit, ashtu që të planifikohet tejkalimi i sfidave me të cilat përballet EFH, siç janë: rritja e numrit të institucioneve parashkollore (IP) dhe organizimi i shpërndarjes adekuate të tyre; zhvillimi i kornizës legjislative, kurrikulës për EFH dhe krijimi i ambientit edukativ cilësor; krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve; si dhe koordinimi nder-sektorial për ofrimin e shërbimeve cilësore në EFH.

Objektivi Strategjik 1 pritet të arrihet përmes zbatimit të këtyre objektivave specifikë:

- Objektivi Specifik 1.1.: Krijimi i mjediseve të shëndetshme me kushte adekuate për EFH dhe sigurimi i resurseve njerëzore
- Objektivi Specifik 1.2.: Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe ofrimi i shërbimeve cilësore në EFH
- Objektivi Specifik 1.3.: Ofrimi i mundësive të zhvillimit dhe arritjes së potencialit të plotë të fëmijëve, përmes shërbime të integruara ndër-sektoriale
- Objektivi Specifik 1.4.: Ngritja e vetëdijes shoqërore për zhvillimin në fëmijërinë e hershme

**Niveli i zbatueshmërisë së veprimeve sipas matricës së vlerësimit**

Nga 29 veprime të objektivit strategjik të parë, për të gjitha është nxjerrë niveli i zbatueshmërinë.

Siç mund të shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, 17% apo 5 nga 29 veprimet e raportuara nën këtë objektiv strategjik janë përmbushur plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 80-100%), 24% apo 7 kanë shënuar zbatim të theksuar por nuk janë realizuar plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 60-79%), 21% apo 6 janë në zbatim e sipër (40-59%), 17% kanë shënuar pak zbatim (20-39%), ndërsa 21% kanë shënuar shumë pak zbatim apo nuk janë realizuar fare (0-19%).

**Grafiku 2. Zbatueshmëria e veprimeve të Objektivit Strategjik 1 (sipas kornizës së vlerësimit)**




**Veprimet kryesore të realizuara dhe sfidat përkatëse**

Ndër arritjet kryesore të realizuara në kuadër të Objektivit Strategjik 1 gjatë viteve 2022-2023, janë:

- Hartimi i 2 analizave mbi nevojën për ndërtimin e çerdheve të reja (njëra analizë e zhvilluar nga MASHTI dhe tjetra nga UNICEF).
- Monitorimi i rregullt mbi zbatimin e normave dhe standardeve të përcaktuara për hapësirat e institucioneve të EFH.
- Hartimi i analizës për "Nxjerrjen e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private, dhe publiko-private për edukimin parashkollor ne Republikën e Kosovës", zhvilluar nga ekspertë të angazhuar nga Banka Botërore në bashkëpunim me divizionin për edukim parashkollor. Gjithashtu, me angazhimin e ekspertit nga UNICEF, është bërë edhe hartimi i dokumentit për standardizimin e kostos për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve që ofrojnë shërbimet e EFH.
- Janë ndërtuar 4 çerdhe në vitet 2022-2023 dhe vazhdon ndërtimi i 19 çerdheve tjera të kontraktuara.
- Janë adaptuar 3 shkolla në çerdhe për fëmijë në vitin 2023 dhe vazhdon adaptimi i 7 shkollave në çerdhe të kontraktuara.
- Miratimi i Ligjit të ri për EFH dhe Udhëzimit Administrativ për licencimin e institucioneve parashkollore private.
    - Në vitin 2022 janë licencuar për herë të parë rreth 55 IEAPP, gjithsej nr. i fëmijëve në bazë të hapësirave të përcaktuara në m/2 është rreth 2,495.

- Në vitin 2023 janë licencuar për herë të parë rreth 26 IEAPP, gjithsej nr. i fëmijëve në bazë të hapësirave të përcaktuara në m/2 është rreth 1,500.

- Hartimi i tre dokumenteve të kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme, i aprovuar nga kabineti për pilotim. Trajnimi i 11 trajnerëve për trajnimin e edukatorëve për pilotim te kurrikulës si dhe stafi tjetër relevant. Gjithashtu janë trajnuar 50 edukatorë nga institucionet parashkollore dhe 16 edukatorë të klasave parafillore, 12 drejtorë të IP-ve, 13 staf profesional (pedagog, psikolog, logoped dhe asistentë të fëmijëve me NVA), 10 zyrtar nga DKA. Ky proces do të shtrihet ne 10 komuna, në 12 institucione parashkollore dhe në 20 klasa parafillore.
- Punësimi i 25 psikologëve në institucionet edukativo-arsimore në Prishtinë, punësimi i 2 pedagogëve në Podujevë, punësimi i 5 psikologëve në shkollat e qytetit në Gjakovë.
- Në bashkëpunim me UNICEF-in, janë ngritur kapacitetet e 200 edukatorëve në Mitrovicë dhe 16 në Dragash për ofrim të edukimit kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në grupet e margjinalizuara. Në Dragash, 10 edukatore janë trajnuar mbi të ushqyerit e shëndetshëm.
- Në platformën "Edukimi në Distancë - Kujdesi dhe Zhvillimi në EFH" janë hartuar 1,075 aktivitete ditore për fëmijët 0-6 vjeç, ku përfshihet edhe nivelin zero sipas ISCED 2011, që lehtësisht mund të realizohen në shtëpi; janë realizuar 20 video; janë trajnuar 1,600 edukatorë për përdorim të platformës dhe janë hartuar 1,749 raporte digjitale nga ana e edukatorëve.
- Lansimi i aplikacionit "Foleja" në bashkëpunim me UNICEF, aplikacion ky të cilin prindërit lehtësisht mund ta përdorin për zhvillimin e fëmijëve 0-6 vjeç në fushën e shëndetit, mirëqenies dhe edukimit. Aplikacioni Foleja është prezantuar në mbi 20 sesione informuese me rreth 200 prindër pjesëmarrës, të organizuara në 13 komuna. Mbi 15400 përdorues janë regjistruar deri në dhjetor 2023.
- Me mbështetje të UNICEF, është organizuar ngjarja mbi vetëdijesimin e rëndësisë së EFH-së, me ç'rast është prezentuar Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme. Të pranishëm në këtë ngjarje kanë qenë rreth 100 pjesëmarrës dhe po ashtu është përgatitur një video që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe prezantimin e Ligjit. Videoja është prezantuar në këtë ngjarje dhe si e tillë do të prezantohet edhe para opinionit të gjerë. Më tej, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Bankën Botërore, është organizuar tryeza e diskutimit mbi Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, duke u fokusuar në temën e financimit dhe diversifikimin e modeleve të ofrimit të shërbimeve për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, me qëllim zgjerimin e çasjes dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

**Sfidat dhe Rekomandimet**

| Veprimi | Sfida | Rekomandimi |
|---|---|---|
| 1.1.1.;<br>1.1.3.;<br>1.1.4. | Këto analiza, ndonëse janë realizuar, mungon raportimi mbi atë se në çfarë niveli ka filluar zbatimi apo adresimi i rekomandimeve të dalura nga këto analiza. | · Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga këto analiza, përfshirë periudhën kohore, akterët relevantë, përgjegjësitë, buxhetin, etj.<br>· Zbatimi i planit sipas afatit kohor të planifikuar |
| 1.1.2. | Ndonëse MASHTI konfirmon monitorimin e rregullt të institucioneve të EFH, nuk ka të dhëna lidhur me numrin e institucioneve të monitoruara, zbatimin e politikave apo normave përkatëse nga këto institucione, etj. | Zhvillimi i raporteve të rregullta (në baza vjetore) mbi monitorimet e kryera, ku ceket numri dhe emri i institucioneve të monitoruara sipas komunave, zbatimi i normave përkatëse, shkeljet, rekomandimet për përmirësimin e tyre, etj. |
| 1.1.5. | Sfida drejt sigurimit të lokacioneve me dokumentacionin përkatës, projekt-dizajneve, si | · Angazhimi i komunave për sigurimim e lokacioneve dhe lejeve të ndërtimit |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe sigurimin e lejeve të ndërtimit (dokumenteve të legalizimit) të cilat qojnë në vonesa të ndërtimit apo funksionalizimit të çerdheve.<br><br>Gjithashtu sfidë është edhe numri i ulët i të punësuarve në disa institucionë parashkollore më numër të madh të fëmijëve të regjistruar. | · Përshpejtimi i procesit të legalizimit të objektit në Dragash<br>· MASHT të mundësojë shtimin e numrit të të punësuarëve sidomos në ato çerdhe që kanë numër të lartë të fëmijëvë të regjistruar (si p.sh. Xixëllonja në Prishtinë) |
| 1.1.6. | Numri i ulët i adaptimeve të realizuara, përpos në Komunën e Deçanit, kryesisht si pasojë e mungesës së iniciativave nga Komunat. Sfidë është raportuar të jetë edhe sigurimi i projekt-dizajneve dhe përshkrimeve të punës me paramasë dhe parallogari nga komunat respektive | · Angazhimi i DKA-ve për analizë dhe vlerësim të hapësirave për adaptim të institucioneve në shërbim të EFH Angazhimi i komunave për sigurim të projekt-dizajneve<br>· Sigurimi i buxhetit për realizimin e adaptimeve, p.sh. mbështetja për inventar, etj. |
| 1.1.7. | Mungesa në raportim më të detajuar lidhur me masat të ndërmarra nga komunat/shkolla për krijimin e mjediseve të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta;<br><br>*apo*<br><br>Mungesa e iniciativave të Komunave. | Sigurimi i të dhënave përkatëse rreth asaj se cfarë është investuar në këtë drejtim nga komunat. Gjurmimi mbi aktivitetet që përfshijnë nivelin komunal në planifikimin, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e veprimeve. |
| 1.2.5. | Mungesa e psikologëve (sipas numrit të paraparë me UA) në të gjitha nivelet të arsimit parauniversitar. Numri i kufizuar i të punësuarëve mbetet sfidë kryesore për punësimin e stafit mbështetës dhe profesional si pedagog, psikolog etj. | Të mundësohet punësimi përmes ndryshimit administrativ i asistenteve për fëmijë me nevoja të veçanta, i pedagogëve, psikologëve. |
| 1.2.13., 1.2.14., 1.2.15 | Mungesa e të dhënave lidhur me arritjen e këtyre veprimeve (përpos disa të dhënave të pranuara nga Komuna e Dragashit) | Të sigurohen të dhënat edhe nga komunat tjera lidhur me arritjen e këtyre veprimeve përmes një komunikimi më bashkëpunues më komunat. |
| 1.4.2. | Mungesa e organizimit të aktiviteteve nga Komunat për vetëdijësimin rreth rëndësisë së EFH (konferenca, diskutime, etj.) | Nxitja e komunave për organizimin e aktiviteteve për vetëdijesimin rreth rëndësisë së EFH. |
| / | Shtyerja e disa veprime për realizim në vitin 2024 | Të analizohet situata që ka krijuar nevojën për shtyerje të afateve dhe të reflektohet mbi identifikimin e pengesave që kanë shkaktuar ngecjen e realizimit të këtij veprimi, në mënyrë që të të sigurohet zbatimi i tyre në afatin kohor të paraparë. |

## 4.2. Objektivi strategjik 2: Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore

**Përshkrim i shkurtër i Objektivit Strategjik**

Objektivi strategjik 2 synon ngritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore. Për të ngritur cilësinë në arsimin parauniversitar, objektivi parasheh nevojën e një sistemi i cili ofron llogaridhënie në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Për këtë qëllim objektivi parasheh menaxhim më efektiv dhe efikas përmes zbatimit dhe avancimit të politikave dhe kornizës ligjore në fushën e arsimit, ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies. Për më shumë ai parasheh fuqizimin e mekanizmave për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore me fokus në ngritjen e cilësisë, rritjen e besueshmërisë së testeve kombëtare dhe shfrytëzimin e rezultateve për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Gjithashtu, avancimi i cilësisë së arsimit paraunivesitar parashihet të arrihet përmes zbatimit efektiv të kurrikulës si dhe fuqizimit të mekanizmit funksional për ta udhëhequr dhe zbatuar atë. Për ngritjen e rezultateve të nxënësve, krahas masave tjera, objektivi parasheh edhe përgatitjen e teksteve cilësore dhe në përputhje me kurrikulën si dhe do të sigurohen mjete, materiale dhe burime mësimore alternative.

Objektivi Strategjik 2 pritet të arrihet përmes zbatimit të këtyre objektivave specifikë:

- Objektivi Specifik 2.1.: Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës dhe llogaridhënies.
- Objektivi Specifik 2.2.: Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë.
- Objektivi Specifik 2.3.: Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e margjinalizuara përmes krijimit të klimës nxitëse dhe përkrahëse.
- Objektivi Specifik 2.4.: Sigurimi i mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas normave dhe standardeve, që mundësojnë mësim cilësor.
- Objektivi Specifik 2.5.: Rritje e besueshmërisë së rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për politikëbërje, krahas rezultateve të testeve ndërkombëtare.
- Objektivi 2.6.: Zbatimi efektiv i të gjitha elementeve të kurrikulës së arsimit parauniversitar.
- Objektivi 2.7.: Sigurimi i teksteve shkollore cilësore, burimeve, mjeteve e materialeve mësimore në harmoni me kurrikulën dhe standardet përkatëse.
- Objektivi 2.8.: Zbatimi i plotë i sistemit të licencimit të mësimdhënësve dhe shtimi i mundësive për zhvillim dhe avancim profesional të mësimdhënësve bazuar në standardet e mësimdhënies.
- Objektivi 2.9.: Përgatitja cilësore e mësimdhënësve para shërbimit të cilët iu përshtaten me kompetencë kërkesave të kurrikulës dhe nevojave praktike të punës me fëmijë/nxënës.
- Objektivi 2.10.: Promovimi i multikulturalizmit dhe diversitetit në arsimin parauniversitar.

**Niveli i zbatueshmërisë së veprimeve sipas matricës së vlerësimit**

Nga 92 veprime të objektivit strategjik të dytë, u raportua mbi zbatueshmërinë e 90 (apo 98%) prej tyre, ndërsa si pasojë e mungesave të të dhënave përkatëse apo vendosjes për shtyrjen e zbatimit të tyre në një afat tjetër kohor, mungon raportimi mbi të arriturat e 2 veprimeve (apo 2%). Në rast të sigurimit të të

dhënave përkatëse edhe për veprimet e paraportuara, do të përditësohet raporti final i vlerësimit për të reflektuar edhe realizimin e tyre.

Sic mund të shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, 16% nga 90 veprimet e raportuara nën këtë objektiv strategjik janë përmbushur plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 80-100%), 13% kanë shënuar zbatim të theksuar por nuk janë realizuar plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 60-79%), 22% janë në zbatim e sipër (40-59%), 31% kanë shënuar pak zbatim (20-39%), ndërsa 18% kanë shënuar shumë pak zbatim apo nuk janë realizuar fare (0-19%).

**Grafiku 3. Zbatueshmëria e veprimeve të Objektivit Strategjik 2 (sipas kornizës së vlerësimit)**




**Veprimet kryesore të realizuara dhe sfidat përkatëse**

Ndër arritjet kryesore të realizuara në kuadër të Objektivit Strategjik 2 gjatë viteve 2022-2023, janë:

- Hartimi një udhëzues për rolin mbikëqyrës të DKA-ve dhe gjithashtu është përgatitur edhe një modul i veçantë për DKA për mënyrën e monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijëve (parandalim të dhunës, braktisjes dhe përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme). E nevojshme ngritja e kapaciteteve për komunat për të përdorur materialet mbështetëse për ushtrimin e rolit të tyre si mbikëqyrës.
- Mbajtja e takimeve të rregullta mujore me nivelin menaxherial të MASHTI.
- Është hartuar Rregullorja për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit stafit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës. Inkurajim i vazhdueshëm i DKA-ve për respektimin e Ligjit për barazi gjinore në procedurat e punësimit të stafit të institucioneve edukative dhe arsimore.

- Janë aprovuar 6 programe për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës dhe janë trajnuar rreth 900 staf të shkollës (drejtor, zv. drejtorë dhe mësimdhënës).
- Përfundimi i procdurave të diskutimit paraprak dhe publik për UA për ristrukturimin e brendshëm të shkollës dhe është proceduar për procedura të mëtutjeshme në Kabinetin e Ministres.
- Është realizuar një pyetësor në 4 komuna me 31 shkolla lidhur me nevojat e fuqizimit të KDSH dhe KP-ve.
- Është krijuar kolegjiumi për drejtorë për çerdhe dhe për shkollat e arsimit profesional. Mbahen kontakte dhe koordinime me drejtorë të IEA me qëllim të zbatimit të politikave.
- Është hartuar një draft i UA-së për zbatimin e formulës së financimit cili është përcjellë në Kabinetin e Ministres.
- Është hartuar analiza e gjendjes mbi riorganizimin e rrjetit të shkollave, ku janë identifikuar shkollat me numër të vogël të nxënësve. Po ashtu, është hartuar UA-10/2023 që rregullon themelimin dhe procedurat e pushimit të veprimtarisë së IEAAP.
- Publikim i rregulltë i statistikave të arsimit në Kosovë.
- Angazhim në rekrutimin e 20 inspektorëve të rinjë. Konkursi është anuluar pas shqyrtimit të ankesave të dorëzuara.
- Trajnimi i 20 inspektorëve për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe arsim gjithëpërfshirës.
- Është kryer vlerësimi  i performancës së 68 drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave (54 drejtorë dhe 14 zëvendësdrejtorë). Po ashtu, është kryer edhe vlerësimi i jashtëm i performancës së 28 shkollave (VJPSh). Krahas kornizës përtej VPSH, VBSH dhe VJSH, MASHTI ka hartuar modul të veçantë për inspektorë për mënyrën e monitorimit të politikës së mbrojtjes së fëmijës (parandalim të dhunës, braktisjes dhe përfshirjes së fëmijëve në punë të detyrueshme.
- Kontrollimi i vazhdueshëm i performancës së stafit menaxhues të shkollës, koordinatorëve të cilësisë, mësimdhënësve, si dhe përpilimit dhe zbatimit të dokumenteve drejtuese dhe menaxhuese të shkollës. Reflektimi mbi të gjeturat dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e performancës së stafit menaxhues, KC-ve dhe shkollave në përgjithësi.
- Raportimet e rregullta pranë Kabinetit të Ministres, si dhe organizimi i konferencave për rezultatet nga vlerësimet ndërkombëtare, siç janë PISA, TIMSS, etj.

**Sfidat dhe Rekomandimet**

| Veprimi | Sfida | Rekomandimi |
|---|---|---|
| 2.1.2 | Sfidë është pjesëmarrja e vogël e përfaqësuesve nga DKA-të në mbledhjet e rregullta mujore me Kabinetin e Ministres. | · Identifikimi i modaliteteve për inkurajimin e pjesëmarrjes së DKA-ve në mbledhjet e rregullta në nivelin ministror.<br>· Sintetizimi i mbledhjeve të rregullta me angazhime tjera të zhvillimit dhe raportimit të indikatorëve të arsimit në nivel të Ministrisë, në mënyrë që DKA-të të motivohen për pjesëmarrje aktive. |
| 2.1.4 | Mungojnë programet e avancuara të cilët duhet të hartohen dhe duhet të angazhohen ekspertë për hartimin e programeve të avancuara. | · Gjetja e modaliteteve zbatuese për programet e përpiluara të cilat do të mund të zbatohen me stafin menaxherial të shkollave.<br>· Identifikimi i ekspertëve që mund të përfshihen në ngritjen e kapaciteteve |

| | | |
|---|---|---|
| | | menaxheriale të shkollave.<br>· Inkurajimi i përfshirjës së këshillave drejtues shkollor në përparimin e zbatimit të programeve menaxheriale për shkolla. |
| 2.1.5 | Sfidë është ligji i pagave dhe rregulloret për shtesa të cilat i kanë përcaktuar pozitat e punës në sektorin publik dhe nuk kanë paraparë pozitat të cilat janë në ketë UA. | Intensifikimi i angazhimeve për ndryshimet e nevojshme ligjore për pagat në sektorin publik |
| 2.1.6 | Vërehet mungesa e pjesëmarrjes së prindërve në takime dhe në aktivitetet e shkollës në përgjithësi. | Përkrahja e përshtatshme për KDSH-të dhe KO-të, në procesin e hartimi të rregulloreve dhe aktiviteteve jashtëshkollore, duke u përqendruar në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të PZHSH-së (Plani Zhvillimor i Shkollës), menaxhimit financiar të shkollës, etj. dhe të mbështetën për të kuptuar se si vendimet e tyre (KDSH, KP, AKTIVEVE) ndikojnë në performancën dhe rezultatet e nxënësve |
| 2.1.7 | Vështirësi në koordinimin e DKA-ve për krijimin e kolegjiumeve të shkollave fillore dhe te mesme. | Përforcimi dhe përparimi i rrjetëzimit të DKA-ve që funksionojnë në ambient dhe kontekst të ngjajshëm, lidhur me shpërndarjen e eksperiencave dhe përkrahjen në krijimin e kolegjiumeve. |
| 2.1.11 | Sfidë mbetet zbatimi i dispozitave të UA 10/2023 për kriteret dhe procedurat për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së shkollës. Si dhe ka hezitim nga DKA-të për inicimin e procedurave për pushim të veprimtarisë. | · Inkurajim i DKA-ve për raportim të drejtë dhe të saktë të zbatimit të UA 10/2023.<br>· Intensifikim i angazhimit me zyrtarët e DKA-ve për zbatimin e kornizës ligjore, duke adresuar rreziqet dhe dilemat që rezultojnë nga raportimet e sakta që kërkohet nga ata. |
| 2.1.12 | Sfide mbetet mungesa e stafit për mirëmbajtjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të SMIA. Mos raportimi i të dhënave në sistem nga ana e shkollave me mësim në gjuhën serbe. | · Identifikimi i nivelit të përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, përfshirë edhe nivelin që ky sistem është në përputhje me kërkesat dhe nevojat e përdoruesve, politikbërësve dhe shfrytëzuesve tjera të të dhënave.<br>· Ngritje dhe rekrutim i kapaciteteve teknike dhe menaxheriale për përditësimin dhe përparimin e përdorimit dhe shfrytëzimit të SMIA.<br>· Inkurajim i përdorimit aktiv të SMIA nga të gjithë akterët relevant. |
| 2.2.2., 2.2.3 | Sfidë mbetet numri i vogël i inspektorëve dhe nevoja për ngritje të kapaciteteve të inspektorëve për të përdorur materialet mbështetëse për ushtrimin e rolit të tyre mbikëqyrës për sa I përket politikave të mbrojtjes së fëmijëve. | · Planifikimi dhe përgatitja adekuate për shpalljen e e konkursit për inspektorë, në përputhje strikt me kornizën ligjore, analizën e nevojave dhe planifikimin e zhvillimit të arsimit në Kosovë.<br>· Përkrahja e vazhdueshme e ngritjes së kapaciteteve të inspektorëve ekzistues lidhur me realizimin e detyrave të tyre të punës. |
| 2.2.8 | Mungesa e zhvillimit të sofverit për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e Kartës Raportuese të Shkollës | Identifikim i pengesave apo ngecjeve në zhvillimin e softverit dhe hartim i planit për zhvillimin dhe zbatimin sa më të shpejtë të |

| | | |
|---|---|---|
| | | softverit në fjalë |

## 4.3. Objektivi strategjik 3: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës

**Përshkrim i shkurtër i Objektivit Strategjik**

Cilësia e pamjaftueshme e ofertës së arsimit dhe aftësimit profesional ka rezultuar me shkallë të ulët të kënaqshmërisë së punëdhënësve me shkathtësitë/kompetencat e arritura nga kandidatët e diplomuar në IAAP, si dhe me shkallë të ulët të tranzicionit nga shkolla në punë. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe mobilitetet janë të kufizuara dhe nuk janë në hap me nevojën për riaftësim të vazhdueshëm të fuqisë punëtore. Rrjedhimisht, përqendrimi kryesor në kuadër të këtij objektivi është rishikimi i ofertës së arsimit dhe aftësimit profesional si dhe përmirësimi i cilësisë, në funksion të zhvillimit të shkathtësive të transferueshme, shkathtësive digjitale, shkathtësive të ndërmarrësisë dhe shkathtësive teknike profesionale, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendet e transformimit digjital dhe të gjelbër.

Objektivi Strategjik 3 pritet të arrihet përmes zbatimit të këtyre objektivave specifikë:

- Objektivi Specifik 3.1.: Përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur.
- Objektivi Specifik 3.2.: Konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë, në nivel qendror, lokal dhe në nivel të IAAP-ve, për të mundësuar qasje sistemore për menaxhim të cilësisë.
- Objektivi Specifik 3.3.: Finalizimi i pakos kurrikulare për kualifikimet që ofrohen nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendet e transformimit.
- Objektivi Specifik 3.4.: Sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit në karrierë.
- Objektivi Specifik 3.5. Përmirësimi i ofertës dhe rritja e pjesëmarrjes në ARr.

**Niveli i zbatueshmërisë së veprimeve sipas matricës së vlerësimit**

Nga 43 veprime të objektivit strategjik të tretë, janë nxjerrën statistika mbi zbatueshmërinë e 41 (apo 95%) prej tyre, ndërsa si pasojë e mungesave të të dhënave përkatëse apo vendosjes për shtyerjen e zbatimit të tyre në një afat tjetër kohor, mungon raportimi mbi të arriturat e 2 veprimeve (apo 5%). Në rast të sigurimit të të dhënave përkatëse edhe për veprimet e paraportuara, do të përditësohet raporti final i vlerësimit për të reflektuar edhe realizimin e tyre.

Sic mund të shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, 22% nga 41 veprimet e raportuara nën këtë objektiv strategjik janë përmbushur plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 80-100%), 12% kanë shënuar zbatim të theksuar por nuk janë realizuar plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 60-79%), 31% janë në zbatim e sipër (40-59%), 20% kanë shënuar pak zbatim (20-39%), ndërsa 15% kanë shënuar shumë pak zbatim apo nuk janë realizuar fare (0-19%).

**Grafiku 4. Zbatueshmëria e veprimeve të Objektivit Strategjik 3 (sipas kornizës së vlerësimit)**




**Veprimet kryesore të realizuara dhe sfidat përkatëse**

Ndër arritjet kryesore të realizuara në kuadër të Objektivit Strategjik 3 gjatë viteve 2022-2023, janë:

- Projekti Fit for Jobs/GIZ ka bashkëpunuar me MASHTI-n për të përgatitur një raport që vlerëson gjendjen e sistemit të qeverisjes dhe menaxhimit të AAP-së në Kosovë, përderisa raporti ofron analize të strukturës aktuale institucionale për qeverisjen dhe menaxhimin e AAP-së, identifikon kufizimet dhe rekomandon ndërhyrje prioritare për zbatimin më efektiv të politikave të AAP-së. Kontributi i projektit ALLED2 ne vitin 2022 zgjerohet në analiza dhe publikime lidhur me ndërthyrjen e zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave të institucioneve arsimore dhe sektorit privat.
- Projekti 'Fit for Jobs/GIZ' ka angazhuar ekspert për rishikimin e Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.
- Janë zhvilluar kurrikulat për klasat 11 dhe 12 për 12 profile të arsimit dual, në fusha të ndryshme të zhvillimit të shkathtësive. Është bërë rishikimi dhe standardizimi i 6 kurrikulave të TI që janë duke u pilotuar nga viti i kaluar.
- AKK ka hartuar një draft Manual për zhvillimin e Standardit të Profesionit, kualifikimit dhe Kurrikulës Profesionale. Është zhvilluar Regjistri i Kualifikimeve të Kosovës (RKK). Projekti ALLED2, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), ka zhvilluar RKK duke punuar

në mënyrë aktive në aspektet e përmbajtjes dhe softuerit të RKK(KRQ), duke kontribuar në zhvillimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe duke mbështetur përpjekjet e qeverisë për dixhitalizim.

- Është hartuar draft dokumenti për Udhëzimin Administrativ për Studime Gjurmuese 'Platforma/Sistemi i Informimit për Studime Gjurmuese i përditësuar dhe funksional i vendosur në data qendrën shtetërore në kuadër të ASHI-së'.
- Janë trajnuar mbi 400 staf të IAAP-ve. Është zhvilluar platforma për matjen e kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet që ofrohen nga këshilltarët e karrierës në IAAP. Janë trajnuar Këshilltarë të Karrierës janë trajnuar për përdorim të platformës dhe e kanë në funksion të plotë.
- Është hartuar drafti i UA për Parametrat dhe Kriteret e Financimit të AAP-së. ALLED2 bashkëpunoi me DAAP/MASHTI në zhvillimin e Formulës së re të financimit për AAP-së.
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka marrë asistencë nga projekti GIZ/Fit for Jobs për të zhvilluar Kornizën Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë  dhe një Manual gjithëpërfshirës të Përdoruesit për Kornizën Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKAF). Ky manual do të shërbejë si pikë referimi si për AKK-në ashtu edhe për palët e tjera të interesuara brenda sektorit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), me synimin për avancimin e AAP-së përmes përmirësimit të vazhdueshëm.
- 27 inspektorë të arsimit (18 burra dhe 9 gra) janë trajnuar për sigurimin e cilësisë në IAAP, me theks në vlerësimin e jashtëm të performancës së IAAP- ve dhe në rolin e inspektoratit të arsimit si pjesë e sistemit të sigurimit të cilësisë në IAAP. MASHTI ende nuk i ka trajnuar inspektorët e arsimit për vlerësim të jashtëm të IAAP.
- Një model i Rregullores për proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë në IAAP është përgatitur në bashkëpunim me 20 IAAP, partnere të ALLED2.
- Programi i zhvillimit profesional të koordinatorëve për sigurim të cilësisë dhe drejtorëve të IAAP, përfshirë  menaxhimin e cilësisë, është hartuar bazuar në një vlerësim të nevojave për zhvillim profesional, zhvilluar në 20 IAAP. Pas realizimit të programit të trajnimit dhe mentorimit, tërë pakoja e programit është finalizuar, dhe 16 trajnerë për ofrimin e programit janë certifikuar.
- Është hartuar drafti i Kornizës Bërthamë të AAP-së. Si pjesë e reformës në vazhdim, Projekti Fit for Jobs/GIZ ka ofruar mbështetje teknike për zhvillimin e Kornizës Bërthamë të Kurrikulës së AAP-së në përputhje me MASHTI dhe Strategjinë e Arsimit 2022-26.
- Është zhvilluar kurrikula e trajnimit SIM (Sistemi i Menaxhimit të Informatave) mbi e-Mësimin për mësimdhënësit e AAP-së, i përbërë nga 30 njësi mësimore të ofruara në formë të mësimit të kombinuar me 70% online dhe 30% trajnim personal. Sesioni i parë i trajnimit njëditor u ndoq nga 205 (109 gra/vajza) mësimdhënëse dhe mësimdhënëse të praktikës profesionale, ndërsa trajnimi i mbetur u zhvillua online deri në qershor 2023. Projekti ALLED2 ka zhvilluar platformën EON ARV(realiteti virtual) me  600 licenca. Janë trajnuar 62 mësimdhënës të praktikës profesionale, për zbatimin e "mësimit dual".  Në 22 IAAP, tani kanë së paku nga 1 mësimdhënësve të praktikës profesionale të trajnuar, në funksion të zbatimit të "mësimit dual".
- Është hartuar draft  Standardi i kualifikimit për programin për mësimdhënës të AAP. Është bërë një Analizë e bazës ligjore për intervenim në këtë sektor.
- GIZ ka mbështetur 11 shkolla në aplikimin e tyre në Fondin Nacional dhe Rajonal "Sfidë" të KfË. Si rezultat, 7 konsorciumeve të përbërë nga këto shkolla dhe biznese të AAP-së iu dhanë në total 2,900,000 EUR apo nga 415,000 EUR mesatarisht për secilën nga shkollat përkatëse. Granti

mbulon shpenzime të ndryshme, si pajisje për shkollat e AAP-së, trajnime dhe aktivitete të tjera mësimore të bazuara në punë.

- Është krijuar Rrjeti i Qendrave të Karrierës në IAAP. Aktualisht Rrjeti përbëhet nga 19 Qendra të Karrierës të themeluara nga projekti EYE dhe disa të tjera të themeluara nga donator tjerë, me rreth 50+ anëtarë. Deri me tani janë mbajtur 3 takime të Rrjetit.
- Është kontraktuar operatori ekonomik për hartimin e normave dhe standardet për infrastrukturën e objekteve të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. Është hartuar plani për investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional bazuar në nevoja, por ka ngecur për shkak të procedurave të prokurimit.
- MASHTI/DAAP ka ndarë buxhet për infrastrukturë, pajisje për realizimin e mësimit praktik, pajisje të mençura çdo vit, por për shkak të procedurave të prokurimit nuk është shpenzuar buxheti.
- Bazuar në ligjin e buxhetit në Grantin Specifik për sigurim aksidental dhe përmirësim të praktikës profesionale (ku përfshihet transporti i nxënësve dhe realizimi i mësimit në vendin e punës) ndahen 3.5 milion çdo vit. Udhëzuesit për zbatimin operacional të Mësimit në Vendin e Punës (MVP) janë duke u rishikuar. Për të siguruar që MVP të zbatohet siç duhet në nivel shkolle, janë kryer iniciativa të shumta trajnimi.
- Në vazhdimësi ofrohen trajnime për mësimdhënësit e praktikës profesionale, siç janë Trajnim për zhvillimin e planit mësimor të MVP; Trajnim mbi udhëzuesin operacional për MVP; Trajnim për bashkëpunimin e biznesit shkollor; Trajnim për zhvillimin e planit mësimor – Arsimi Dual; Trajnim për Zhvillimin e Kurrikulës – Arsimi Dual; Trajnim për zbatimin e Arsimit Dual; Trajnim për zhvillimin e planit mësimor të MVP; Trajnim mbi udhëzuesin operacional për MVP; Trajnim për bashkëpunimin e biznesit shkollor; Trajnim për zhvillimin e planit mësimor – Arsimi Dual; etj
- Janë miratuar të dy udhëzimet administrative. Janë hartuar dhe është miratuar nga ana e ministres UA për këshilltarë të karrierës në institucionet e arsimit parauniversitar së bashku me standardet për organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë në arsimin parauniversitar për arsimin e mesëm të ulët, gjimnaze dhe institucione të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP).
- Janë trajnuar 30 këshilltarë për karrierë. Eshtë miratuar Programi për kualifikimin e këshilltarëve të karrierës.
- Është themeluar rrjeti i Këshilltarëve për këshillim dhe orientim në karrierë. Rreth 16,000 nxënës te klasave te 9'ta kane përfituar nga sesionet informuese dhe aktivitete tjera te organizuara nga qendrat e karrierës ne 18 IAAP. Gjatë kësaj periudhe janë themeluar 5 qendra të karrierës (tani kemi gjithsej 23 qendra të karrierës)
- Të gjitha IAAP-të organizojnë sesione informuese për nxënësit e klasave të 9-ta. Prezantohen në ëebfaqet e shkollave dhe qendrave për karrierë. Fushata për promovimin e arsimit Dual në fushën e AAP-së është lansuar në nëntor 2023. Projekti Fit for Jobs mbështeti përgatitjen përmbajtjesorë të fushatës si dhe fasilitimin e këtij procesi.
- Programi është zhvilluar për trajnimin e mësimdhënësve për Arsimin për të Rritur (ARr). Mbështetja e pjesëmarrjes nga kategoritë e cenueshme sociale dhe grupet e nën përfaqësuara në ARr. MASHTI i mbështet tri kategori të grupeve të margjinalizuara: rastet sociale, invalidët e luftës dhe fëmijët e dëshmorëve. Janë trajnuar 20 mësimdhënës të IAAP-ve për zbatim të ARr. Janë 90 praktikues të trajnuar për zbatim të NJMP-së. Është themeluar rrjeti i ARRr (ALENK). Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare për ARr për të nxitur lëvizshmërinë dhe përvojën

ndërkombëtare. Rreth 20 mësimdhënës kane përfituar nga intershipet dhe programet e mobilitetit.

- Janë zhvilluar dy programe/kurrikula të reja nga Agjencia AAP. Në mbështetje të DVV International janë duke u zhvilluar trajnimet në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, konkretisht Fakultetin e Edukimit, për përgatitjen e master trajnerëve të cilët më pastaj do t'i trajnojnë mësimdhënësit e shkollave profesionale të cilat ofrojnë arsim për të rritur.

**Sfidat dhe Rekomandimet**

| Veprimi | Sfida | Rekomandimi |
|---|---|---|
| 3.1.5 | Riorganizimi i rrjetit të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës. Mungesë e përfundimit të veprimit të 3.1.1 dhe 3.1.2 që i paraprin këtij veprimi. | · Identifikimi i kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimi programeve që përputhen me kërkesat e tregut të punës.<br>· Intensifikim i angazhimit me akterët gjegjës, përfshirë sektorin privat, për të identifikuar kërkesat dhe nevojat e tyre dhe për të zhvilluar programe që lidhin kërkesat e tregurt dhe zhvillimin e shkathtësive që ofrohen nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional |
| 3.5.3 | Subvencionimi i ofruesve formal për ofrim të programeve për ARr. | Identifikimi i nevojave për ofruesit e programeve për ARr dhe planifikimi adekuat i burimeve njerëzore dhe mjeteve për realizimin e masave që adresojnë këtë çështje |
| 3.1.3 | Ngritja dhe plotësimi i kapaciteteve njerëzore ne sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur – mungesë punësimi në AKK | · Zhvillimi i organogramit të ri që do të merr parasysh pozitat e nevojshme për funksionimin dhe përmirësimin e përformancës.<br>· Të rritet numri i zyrtarëve në DAAP për të përballuar rritjen e volumit të punës dhe kërkesave.<br>· Shqyrtimi i definimit të rolit të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, duke rritur kapaciteteve dhe caktimi i përgjegjësive të reja me qëllim të forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në AAP dhe, veçanërisht, në IAAP-të publike |
| 3.1.8. | Ngritja e kapaciteteve për shfrytëzimin e platformave në nivel qendror, lokal dhe në nivel të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional | · Trajnimi i trajnerët për ngritjen e kapaciteteve të IAAP-ve tjera për përdorim të platformës për matjen e kënaqshmërisë, duke alukuar burime financiare për trajnerët dhe koston e trajnimit.<br>· Zyrtarët përgjegjës në nivel qendror, lokal dhe në nivel të IAAP-ve të informohen sa më shumë dhe të trajnohen për përdorimin efektiv të platformave dhe barometrave të zhvilluara për monitorimin dhe vlerësimin e performancës në fushën e tyre specifike. |
| 3.1.9. | Zhvillimi i metodologjisë së financimit të institucioneve të arsimit dhe aftësimit | · Ministria e Financave të udhëzojë MASHTI për zbatimin e plotë të Formulës së re të |

| | | |
|---|---|---|
| | profesional dhe ngritja e kapaciteteve për zbatim | financimit të Sistemit të AAP-së, duke e mbështetur MASHTI në finalizimit e udhëzimin administrativ.<br>· Integrimi i aplikacioneve të zhvilluara ""PlanVET" në faqen e internetit të MASHTI ose të një institucioni tjetër, për të lejuar qasje për shkollat e AAP-së, Drejtoritë e Arsimit në komuna të Kosovës (DKA), dhe studentët për të praktikuar kalkulimin e buxhetit për shkollat e AAP-së, bazuar në nevojat e tyre. |
| 3.2.2. | Përcaktimi i procedurës për vlerësimin e jashtëm të performancës së IAAP-ve nga Inspektorati i Arsimit (IA) | · Trajnimi i inspektorëve të arsimit për vlerësim të jashtëm të IAAP.<br>· Intensifikim i bashkëpunimit mes akterëve gjegjës, respektivisht që IA, gjatë draftimit të aktit nënligjor për vlerësimin e jashtëm të performancës së IAPP-ve nga IA, të bashkëpunojë me DAAP-në dhe AKK. |
| 3.5.5. | Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve të IAAP-ve për zbatim të ARr dhe NjMP. | Analiza e faktorëve kontribues në përfshirjen e IAPP publike në zbatimin e NJMP |

## 4.4. Objektivi strategjik 4: Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë

**Përshkrim i shkurtër i Objektivit Strategjik**

Ky objektiv është formuluar në përgjigje të mangësive strukturore në fushën e arsimit të lartë dhe synon të përmirësojë cilësinë dhe integritetin e arsimit të lartë, nëpërmjet zbatimit të procesit të akreditimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilësisë, që ndër të tjera do të mundësojë rikthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA dhe EQAR. Reformimi i arsimit të lartë synohet të arrihet nëpërmjet avancimit të kuadrit ligjor, zhvillimit të kapaciteteve të mekanizmave për sigurim të cilësisë, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe përmirësimit të infrastrukturës akademike dhe kërkimore. MASHTI, do të rregullojë bazën ligjore dhe rishikojë legjislacionin ekzistues lidhur me formulën e financimit dhe zhvillimin e një sistemi të avancuar të menaxhimit të informatave në arsimin e lartë.

Objektivi Strategjik 4 pritet të arrihet përmes zbatimit të këtyre objektivave specifikë:

- Objektivi Specifik 4.1.: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes rishikimit të programeve të studimit, avancimit të infrastrukturës akademike, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.
- Objektivi Specifik 4.2.: Përmirësimi i qeverisjes dhe financimit të arsimit të lartë përmes rishikimit të legjislacionit, zhvillimit të sistemit të avancuar të menaxhimit të informatave, rritjes së kapaciteteve profesionale, përmirësimit të shërbimeve për studentë dhe sigurimit të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në arsimin e lartë.

- Objektivi Specifik 4.3.: Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit, rritjes së mundësive për punë praktike të studentëve, bashkëpunimit me ndërmarrje dhe rritjes së programeve ndërdisiplinare dhe programeve STEM.
- Objektivi Specifik 4.4.: Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor si dhe integrimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

**Niveli i zbatueshmërisë së veprimeve sipas matricës së vlerësimit**

Nga 37 veprime të objektivit strategjik të katërt, u raportua mbi zbatueshmërinë e 36 (apo 97%) prej tyre, ndërsa si pasojë e mungesave të të dhënave përkatëse apo vendosjes për shtyerjen e zbatimit të tyre në një afat tjetër kohor, mungon raportimi mbi të arriturat e 1 veprimi (apo 3%). Në rast të sigurimit të të dhënave përkatëse edhe për veprimet e paraportuara, do të përditësohet raporti final i vlerësimit për të reflektuar edhe realizimin e tyre.

Sic mund të shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, 17% apo 6 veprimet e raportuara nën këtë objektiv strategjik janë përmbushur plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 80-100%), 19% kanë shënuar zbatim të theksuar por nuk janë realizuar plotësisht (shkalla e zbatueshmërisë: 60-79%), 31% janë në zbatim e sipër (40-59%), 17% kanë shënuar pak zbatim (20-39%), ndërsa 17% kanë shënuar shumë pak zbatim apo nuk janë realizuar fare (0-19%).

**Grafiku 5. Zbatueshmëria e veprimeve të Objektivit Strategjik 4 (sipas kornizës së vlerësimit)**




**Veprimet kryesore të realizuara dhe sfidat përkatëse**

Ndër arritjet kryesore të realizuara në kuadër të Objektivit Strategjik 4 gjatë viteve 2022-2023, janë:

- Ekipi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, ka monitoruar oraret e ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe vijueshmërinë e stafit akademik në 3 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL) gjatë vitit 2022, dhe në 11 IAL gjatë vitit 2023. AKA ka monitoruar dhe verifikuar të gjitha publikimet dhe shpalljet e programeve të studimit të IAL në përputhje me vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) edhe vitin 2022 edhe 2023.
- Është në proces ndërtimi i objektit të Fakultetit të Shkencave të Natyres (buxheti: 10 milion Euro nga fonded e IPA dhe 1 milion nga MASHTI). Në mbështetje të projektit HERAS, MASHT, në bashkëfinancim me ADA në vitin 2023 ka mbështetur 5 projekte për infrastrukture laboratorike në vlerë prej 130,000 euro. Në IAL publike janë instaluar edhe rrjetet e brendshme (ËIFI/LAN) dhe të gjitha këto janë të lidhura me rrjetin KREN (Rjetin Kosovar për hulumtim dhe edukim). 17 staf akademik janë trajnuar për përdorimin e platformës MOODLE.
- MASHTI ka përkrahur 68 publikime shkencore në 2022, dhe 57 publikime shkencore në vitin 2023.
- Universiteti i Prishtinës ka hapur programin e ri të doktoratës në Shkencat e Edukimit i cili është program i përbashkët me Universitetin e Lublanës. Diploma do të jetë e dyfishtë.
- Zhvillimi dhe lansimi i platformës KRIS, e cila përmban edhe modulin e veçantë për hulumtuesit shkencorë nga diaspora. Është kryer pilotimi dhe ka filluar edhe regjistrimi i perdoruesve (deri tani janë regjistruar 174 përdorues)
- Miratimi i Ligjit për Agjencinë e Akreditimit të Kosoves Nr.08/L 110 nga Kuvendi I Kosovës në qershor 2023
- Udhëzimi Administrative për mbështetje financiare për studentë është nënshkruar nga Ministrja, nr.20/2023, data: 04.08.2023. Është finalizuar dhe është nënshkruar Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Udhëzimi administrativ për Regjistrin e Institucioneve inovantive shkencore ka kaluar fazën e diskutimit paraprak dhe atij publik dhe tani ndodhet në Divizionin Ligjor për procedim të mëtutjeshëm.
- AKA tashmë është anëtare me të drejta të plota në Rrjetin Global të Integritetit Akademik (GAIN). Anëtarësimi në këtë organizatë është bërë me rekomandimin e ENQA.
- Përmirësime të ndryshme në sistemin SMIAL gjatë vitit 2023 (p.sh. sigurimi i qasjes së studentëve për verifikim të të dhënave, lehtësim në gjenerimin e raporteve, etc.)
- MASHTI përmes skemës së bursave në STEM ka stimuluar pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në studime të programeve STEM
- Nga 8 IAL, 6 prej tyre kanë aprovuar strategjitë e Institucioni ose integruar komponentin e nderkombëtarizimit ne strategjitë bazë. Dy te tjera janë hartuar dhe janë draftet në proces të miratimit.
- Programi ERASMUS+
- Për thirrjen e vitit 2023, në fushën e arsimit të lartë janë përzgjedhur për financim nga Komisioni Europian gjithsej 13 projekte me 27 insitucione përfituese nga Kosova, prej të cilave në 4 projekte IAL-të nga Kosova janë bartës/koordinator, përfshirë përfitimin në projektin strukturor në avancimin e edukimit të bazuar në vlera përmes zhvillimit të politikave dhe praktikave të reformave në mësimdhënie në Kosovë.
- Gjatë vitit 2023, 7 institucione të arsimit të lartë nga Kosova e kanë fituar Erasmus Charter të Arsimit të Lartë ECHE. Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar programin Master "Menaxhimi i

Integruar i Resurseve Ujore", programi studimor është ndërdisiplinor dhe ofrohet në gjuhën angleze. Universiteti i Prishtinës ka hapur programin e ri të doktoratës në Shkencat e Edukimit i cili është program i përbashkët me Universitetin e Lublanës. Diploma do të jetë e dyfishtë. Kolegji IBCM ka zhvilluar programin e studimit Master në menaxhim ndërkombëtar dhe lidership me Universitetin Sapienza. Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar programin e studimit në gjuhën angleze "Human Rights, International Criminal Laë, Transitional Justice. Programi zhvillohet në gjuhën angleze dhe rekruton edhe studentë ndërkombëtar.

- Gjatë vitit 2023 në total janë zhvilluar pesë programe studime në gjuhën angleze: një në nivel të doktoratës dhe 4 në nivelin master.
- 4 Universitete kanë themeluar Qendrat për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve të themeluara në të gjitha IAL-të.
- Sa i përket mobiliteve në kuadër të programit Erasmus+, në vitin 2023, 1,266 studentë dhe staf kanë marrë pjesë në programe mobiliteti në BE. 113 mobilitete të realizuara me programin e shkëmbimit akademik CEEPUS.
- Gjatë tërë vitit 2023 janë trajnuar pjesëmarrësit për programet si në vijim: Rreth 100 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në ëebinare dhe sesione informative për programin Erasmus +. Rreth 130 pjesmarrës janë trajnuar për programin Horizon Europe. Takime të personalizuara për programin Asiociacioni COST (30 takime me hulumtues) dhe informim dhe komunikim i rregullt me email me palët e interesuara. Në programin Horizon Europe janë realizuar gjithsej 20 projekt propozime ndërsa janë përfituar 5 projekte më vlerën prej 605.831,25. Në kuadër të programit COST gjatë vitit 2023 ka rritje substanciale të pjesëmarrjes. Hulumtuesit nga Kosova i janë anëtarësuar në 70 aksione (projekte) duke e ngritur numrin e pjesëmarrjes në 140 aksione.

**Sfidat dhe Rekomandimet**

| Veprimi | Sfida | Rekomandimi |
|---|---|---|
| 4.1.1. | Mungesa e stafit për monitorim të cilësisë së programeve | · Krijimi i divizionit për monitorim me staf përkatës të trajnuar në monitorimin e cilësisë së programeve<br>· Identifikimi i nevojave të AKA për të realizuar detyrat e përcaktuara me ligj.<br>· Identifikimi, rekrutimi dhe trajnimi i stafit për monitorimin e cilësisë së programeve.<br>· Zhvillimi i procedurave dhe protokolleve të veprimit për monitorimin e cilësisë së programeve.<br>· Intensifikimi i aktiviteteve për monitorimin e zbatimit të standardeve të cilësisë. |
| 4.1.4 | Zhvillimi i tregueseve kombëtarë të arsimit të lartë. Nuk ka progres Mungesa e stafit. | · Identifikimi i kërkesave dhe nevojave të AKA për të realizuar detyrat e përcaktuara me ligj.<br>· Identifikimi, rekrutimi dhe trajnimi i stafit për zhvillimin e treguesve.<br>· Zhvillimi i procedurave dhe standardeve të veprimit për zhvillimin e treguesve. |
| 4.1.6 | Nuk ka të dhëna të sakta por pjesa dërmuese e IAL-ve mbajnë trajnime me stafin akademik. Sfidë është mos raportimi nga IAL-të. (Zhvillimi | · Identifikimi i pengesave të përfshirjes së IAL në proceset e raportimit<br>· Intensifikimi i aktiviteteve komunikuese dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | profesional i stafit akademik të IAL-ve në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.) | koordinuese me IAL-të<br>· Ndërtim i platformës të grumbullimit dhe raportimit të indikatorëve kyç me përfshirjen adekuate dhe kuptimplotë të IAL-ve |
| 4.1.10. | Mungesa e stafit për administrimin e platformës KRIS si dhe mungesa e regjistrimeve në këtë platformë. | · Rekrutimi i stafit të dedikuar për administrimin dhe mirëmbajtjen/menaxhimin e kësaj platforme<br>· Nxitja e stafit akademik për regjistrim në këtë platformë |
| 4.2.3. | Rishikimi i Ligjit për Profesionet e Rregulluara | · Analizë e kontekstit dhe klimës ligjore dhe administrative për rishikimin e kornizës ligjore<br>· Identifikimi i burimeve të nevojshme, njerëzore dhe teknike, për realizimin e veprimit<br>· Alokimi adekuat i resurseve financiare dhe kohore, si dhe planifikimi i udhërrëfyesit për rishikim dhe aprovim të Ligjit për Profesionet e Rregulluara |
| 4.2.8. | Në 2022 MASHTI ka nxjerrë vendim me të cilin e autorizon AKA-në për verifikimin e plagjiarizmit në tema të doktoratës.<br>Mirëpo, deri me tani, MASHTI nuk ka përfunduar blerjen e softver-it i cili do të mundësonte ekzekutimin e këtij procesi. | · Blerja e softver-it nga MASHTI |
| 4.2.11. | Mungesa e stafit në NARIC | · Bashkëpunimin dhe vizitat në Qendra të ENIC/NARIC në vende të tjera me qëllim të përfitimit të përvojave të reja.<br>· Plotësimi me zyrtarë të rregullt<br>· Dixhitalizimi i shërbimeve. Zvogëlimi i barrierave administrative per verifikim te dokumentacionit shkollor. |
| 4.3.3. | Mungojnë të dhënat lidhur me numrin e vajzave dhe grave të cilat kanë përfituar në programet STEM | · Mbledhja e rregullt e të dhënave (përmes një databaze) e cila pasqyron numrin e femrave dhe grave në studimet STEM |
| 4.3.4. | Mungon raportimi mbi numrin dhe funksionalizimin e qendrave për zhvillim të karrierës në IAL-të publike dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të tyre | · Mbledhja adekuate e informatave nga IAL – të hulumtohet sa qendra janë aktive, numri I përfituesve, efektiviteti I tyre, etj. |
| 4.4.3. | Buxhet i limituar, kapacitete humane të limituara për funksionalizimin adekuat të qendrave për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve në IAL (shumica e qendrave të themeluara me nga 1 zyrtar). Mungesa e trajnimeve apo programeve për ngritje të kapaciteteve të kuadrit. | · Rritja e kapaciteteve njerëzore (ekspert, trajner, etj., sidomos në fushat e shkrimit të projekteve dhe hulumtimit)<br>· Trajnime për stafin e këtyre qendrave për ngritje të kapaciteteve |
| 4.4.5. | Kjo objektivë specifike ndërlidhet me objektivin 4.4.3. Sfidë janë kapacitetet e limituara mbështetëse për stafin akademik për koordinim të projekteve. Nga 12 projekte të përfituara në programin Horizon Europe, vetëm 2 projekte janë përfituar nga IAL-të (Universiteti i Prishtinës). | · Investimi në zyrat /qendrat për zhvillim dhe koordinim të projekteve të trajtohet si invetim strategjik nga IAL-të. Të planifikohen rekrutimi i resurseve humane. Njeherit zhvillimi/koordinimi i projekteve ndërkombëtare, posaçërisht i projekteve shkencore të vlerësohet në performancën e |

| | | |
|---|---|---|
| | | stafit akademik. |

## 4.5. Objektivi strategjik 5: Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital

**Përshkrim i shkurtër i Objektivit Strategjik**

Me qëllim që Kosova të lëvizë sa më shpejt në drejtim të digjitalizimit të të dhënave, ofrimit të shërbimeve digjitale dhe automatizimit të proceseve në fushën e arsimit, si dhe me qëllim të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale për nevoja arsimore e në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme do të punojë në pesë drejtime: (i) krijimin dhe funksionalizmin e një platforme digjitale gjithëpërfshirëse e të centralizuar për fushën e arsimit; (ii) përgatitjen dhe prodhimin e materialeve mësimore digjitale shumëdimensionale e cilësore për nivele, klasë, lëndë e lloje të ndryshme; (iii) furnizimin e IEAA-ve (Institucionet Edukative Arsimore dhe Aftësuese) dhe IAL-ve (Institucionet e Arsimit të lartë) me rrjete të internetit cilësor dhe me pajisje teknologjike të nevojshme; (iv) kultivimin e kompetencës digjitale te të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit te të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve; dhe (v) krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

Objektivi Strategjik 5 pritet të arrihet përmes zbatimit të këtyre objektivave specifikë:

- Objektivi specifik 5.1.: Digjitalizimi dhe integrimi i të dhënave dhe proceseve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së vendimmarrjes së mirëinformuar, transparencës dhe llogaridhënies në fushën e arsimit.
- Objektivi Specifik 5.2.: Zhvillimi dhe përdorimi i materialeve mësimore digjitale në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit.
- Objektivi Specifik 5.3.: Ofrimi i mundësive për shfrytëzim efektiv të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në IEAA dhe IAL.
- Objektivi Specifik 5.4.: Zhvillimi i kompetencës digjitale te të gjitha palët në funksion të transformimit të suksesshëm digjital të arsimit dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror.

**Niveli i zbatueshmërisë së veprimeve sipas matricës së vlerësimit**

Për shkak të mungesës së një trupi monitorues për zbatueshmërinë e veprimeve të parapara në këtë OS, mungon raportimi mbi zbatueshmërinë e këtij OS, që paraqet një sfidë të madhe në vetvete meqenëse nuk dihet se deri në çfarë niveli janë zbatuar apo kanë filluar zbatimin masat e parapara.

Nga gjithsej 44 veprime të parapara në Planin e Veprimit për këtë objektiv strategjik, gjatë periudhës 2022-2023, u raportua për zbatimin e vetëm 7 prej tyre, duke përbërë vetëm 16% të veprimeve të raportuara. Nga veprimet e raportuara, 2 veprime (apo 5%) nuk kanë shënuar fare progres, 2 të tjera janë në përparim e sipër, dhe 3 veprime (apo 7%) janë përmbushur.

**Grafiku 6. Zbatueshmëria e veprimeve të Objektivit Strategjik 5 (sipas kornizës së vlerësimit)**




Në nivelin përshkrues, veprimet e raportuara për këtë objektivë strategjike janë të përmbledhura si në vijim:

- Veprimi 5.3.1.: 52 shkolla janë të lidhura me rrjetin/internet të dedikuar (minimum 100mbps). Në proces janë edhe 49 shkolla (momentalisht). Ndërsa në proces prokurimi janë edhe 114 të tjera. Rrjeti është i garantuar për periudhë 5 vjeçare.
- Veprimi 5.3.8.: Mbështetja në themelimin dhe funksionalizimin e Klubeve të Mediave/Klubeve Digjitale në 20 shkolla të mesme të ulëta/13 komuna të ndryshme (GIZ) .
- Veprimi 5.3.11.: Është lidhur kontrata me Microsoft dhe referuar kërkesës së MASHTI janë furnizuar me 6119 (për vit) (nga gjithsej 12000 të planifikuara, vërejtje e autorit) licenca për kompjuterë shkollorë/përdorues për personelin dhe zyrtarët arsimorë.
- Veprimi 5.3.12.: Është realizuar ky aktivitet, gjë që në kuadër të kësaj kontrate janë siguruar pa pagesë licencat për nxënës, sipas raportit 1:40, ku në 1 licencë për mësimdhënës dhe administratë të IEAA-së përfitohen 40 licenca për nxënës.
- Veprimi 5.4.3.: Projekti GIZ/Fit for Jobs mbështeti përkthimin e tre kornizave evropiane për kompetencën dixhitale - DigiComp, DigiCompEdu dhe DigCompOrg - në gjuhën shqipe. Gjithashtu, janë hartuar udhëzime praktike për përshtatjen dhe zbatimin e këtyre kornizave në kontekstin e Kosovës. Për më tepër, Korniza Evropiane për Kompetencat Dixhitale është integruar

në kuadrin e Kurrikulës Kombëtare të AFP-së. 20 shkolla të mesme të ulëta janë pajisur me Tabela të mençura për të realizuar mësimin në formë digjitale (GIZ).

- Veprimi 5.4.7.: Me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar, është përpiluar një planprogram trajnimi për mësuesit e shkollave të mesme të ulëta dhe një program i përshtatur për shkollat e AAP-së. Një trajnim i programit të trajnerëve u përfundua me sukses në pranverë 2023 dhe u pasua nga sesionet e trajnimit të mësuesve që do të përfundonin në nëntor 2023, me rreth 500 mësues. Trajnimi është në proces akreditimi nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve MESTI.
- Veprimi 5.4.8.: Dy konsulentë vendas kanë përpiluar një manual për Kompetencat Dixhitale të Edukatorit në maj 2023. Mësuesit kanë fituar kompetenca dixhitale përmes masave të ndryshme: trajnime për ngritjen e kapaciteteve të cilat përmes mësimdhënies në mënyrë indirekte do t'i ndihmojnë studentët të përmirësojnë aftësitë e tyre dixhitale. Përafërsisht 2000 nxënës të shkollave të mesme të ulëta po trajnohen për të rritur kompetencat dixhitale përmes mekanizmave të bazuar në shkollë (aktivitete që zbatohen me mentorim në klubet dixhitale dhe/ose mediatike të shkollës.

Seksioni i rekomandimeve për këtë objektivë strategjike nuk është plotësuar pasi që në burimin e të dhënave (pyetësorin amë) nuk janë shënuar të dhëna të mjaftueshme që të mund të ofrohen rekomandime për ballafaqimin me sfidat e evidentuara.

## SHTOJCA I – MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITET 2022-2023

***MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË SA 2022-2026: OBJEKTIVI STRATEGJIK 1***

**OS 1: RRITJE E PËRFSHIRJES DHE QASJE E BARABARTË NË EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME**

DRAFT

| 1. Objektivi strategjik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme** | **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në EFH (grup-mosha 0-5), e ndarë në baza gjinore** | **19.6 % (2021)** | **25%** | **Të dhënat nga SMIA/MASHTI** |
| **1.1. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
| **Krijimi i mjediseve të shëndetshme me kushte adekuate për EFH dhe sigurimi i resurseve njerëzore** | **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 0-4, e ndarë në baza gjinore** | **7%** | **10%** | **Të dhënat nga SMIA/MASHTI** |
| | **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parafillor, e ndarë në baza gjinore** | **88%** | **100%** | **Të dhënat nga SMIA** |
| | **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 3-5, e ndarë në baza gjinore** | **36%** | **45%** | |
| | **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 0-2, e ndarë në baza gjinore** | **4%** | **8%** | |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 1.1.1. Hartimi i analizës së situatës për adaptimit të hapësirave ekzistuese të shkollave në kopshte dhe ndërtimin e objekteve të reja për shërbime të EFH, si dhe hartimi i planit kombëtar për investime kapitale | TM3-TM4/2022 | - | - | Donatorët | MASHTI<br>Donatorët | Raporti i analizës së situatës për adaptimin e hapësirave ekzistuese të shkollave dhe ndërtimin e objekteve të reja për shërbime të EFH<br>Plani kombëtar për investime kapitale në EFH | Raporti i aprovuar dhe i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Plani kombëtar për investime i miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **80-100 %**<br>Janë hartuar 2 analiza të nevojave për ndërtim të çerdheve, një nga MASHTI dhe një nga UNICEF-i. Analiza e hartuar nga UNICEF-i "Analizë e situatës së ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme në Kosovë", e cila u publikua në shtator 2023. |
| 1.1.2. Monitorimi i zbatimit të politikave që përcaktojnë normat dhe standardet e hapësirave të institucioneve të EFH | TM3/2021-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit | Numri i institucioneve që zbatojnë normat dhe standardet e hapësirave për EFH | Raportimet e inspektorëve | **40-59 %**<br>Është monitoruar hartimi i projekt-dizajnëve sipas normave dhe standardeve dhe monitorohet në vazhdimësi përmbajtja e implementimit përmes një kontrate për mbikëqyrje. Është proces në vazhdimësi. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.3. Analizimi për koston e formave të shërbimeve aktuale të EFH në Kosovë (përfshirë ato publike, private, QBK, QM, partneritet publiko-privat) | TM1/2022-TM1/2023 | 19,600 | 6,800 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Donatorët | Dokumenti i vlerësimit së formave të shërbimeve aktuale të EFH i hartuar | Raporti i analizës për koston e shërbimeve aktuale për EFH, i aprovuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **80-100 %** Është hartuar analiza për nxjerrjen e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private, të partneritetit publiko-private për edukimin parashkollor në Republikën e Kosovës". Analiza është realizuar nga ekspertë të angazhuar nga Banka Botërore në bashkëpunim me Divizionin për Edukim Parashkollor. |
| 1.1.4. Hartimi i dokumentit për standardizimin e kostos për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve që ofrojnë shërbimet e EFH | TM4/2022-TM2/2023 | 7,500 | - | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Dokumenti i vlerësimit për specifikat e ndërtimit dhe adaptimit për objektet e EFH i hartuar | Raporti i analizës për kostimin e shërbimeve aktuale për EFH, i aprovuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **60-79 %** Analiza e hartuar nga UNICEF-i "Analizë e situatës së ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme në Kosovë", e cila u publikua në shtator 2023 shërben edhe standardizimin e kostos për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve që ofrojnë shërbimet e EFH. |
| 1.1.5. Ndërtimi i objekteve të reja për shërbimet e EFH | TM3/2022-TM4/2026 | 12,952,460 | 2,487,632 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Numri i institucioneve parashkollore të reja të ndërtuara. Numri i të punësuarve. Numri i fëmijëve përfitues | Raportet vjetore të MASHTI për ndërtimet e reja dhe numri i të punësuarve sipas SMIA | **20-39 %** Janë ndërtuar 4 çerdhe në vitet 2022-2023 dhe vazhdon ndërtimi i 19 çerdheve tjera të kontraktuara. Sfidë është sigurimi I lokacioneve me dokumentacionin përkatës, projekt-dizajneve si dhe sigurimi i lejeve të ndërtimit. Nevojitet dhe rekomandohet një angazhim i shtuar i komunave për sigurimin e lokacioneve dhe lejeve të ndërtimit. Në Dragash janë në proces të licencimit të objektit të parë të Institucionit parashkollor. Janë ndarë mjete për renovimin dhe përshtatjen e një objekti ekzistues por që nuk ka leje ndërtimi dhe janë në proces të legalizimit të objektit. Në Podujevë është ndërtuar një çerdhe e re në vitin 2022 dhe janë 10 veta dhe vijojnë edukimin rreth 65 fëmijë. Në Komunën e Prishtinës për vitin 2022-2023, janë planifikuar të përfundojnë dy institucione parashkollore, por ende nuk janë finalizuar. Institucioni Parashkollor në lagjen "Dardania" dhe rindërtimi i kopshtit "Xixëllonja" në Pejton me kapacitet më të madh të pranimit të fëmijëve. Në ndërtimin e dy kopshteve do të përfitojnë rreth 200 fëmijë, si dhe janë planifikuar për të dy kopshtet të punësohen 14 edukatore. Në Shtime vazhdon ndërtimi i një çerdheje në fshatin Godanc por ende nuk është përfunduar dhe është siguruar dokumentacioni i nevojshëm për çerdhen e re në Petrovë. Ne Vushtrri ka filluar punën çerdhja e tretë në qytet. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.6. Adaptimi i hapësirave në shkolla për shërbime në EFH | TM1/2023-TM4/2026 | 22,500 | 843,109 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Numri i adaptimeve të hapësirave në shkolla për EFH Numri i të punësuarve Numri i fëmijëve përfitues | Raportet vjetore të MASHTI për adaptimet dhe numri i të punësuarve sipas SMIA | **20-39 %** Janë adaptuar 3 shkolla në çerdhe për fëmijë në vitin 2023 dhe vazhdon adaptimi i 7 shkollave në çerdhe të kontraktuara. Sfidë është sigurimi i projekt-dizajnëve dhe përshkrimeve i punës me paramasë dhe parallogari nga komunat përkatëse. Në Podujevë janë adaptuar edhe dy objekte (njëra shkollë e vjetër dhe tjetra AMF) në çerdhe për fëmijë. Në këto institucione vijojnë edukimin rreth 90 fëmijë ku janë të punësuara 12 veta. Gjithashtu janë identifikuar mundësitë në disa shkolla për adaptimin e hapësirave të shkollave për të ofruar shërbime për EFH. Ne Prishtinë nuk ka pasur adaptime të hapësirave në shërbime të EFH se ka pasur mungesë të iniciativave Ndërsa në Shtime nuk është adaptuar asnjë hapësirë shkollore për çerdhe por është adaptuar një objekt në fshatin Muzeqinë që më parë ishte i destinuar për Zyre të Gjendjes Civile. Ky objekt është në fazën përfundimtare dhe së shpejti pritet të përurohet. |
| 1.1.7. Rishikimi dhe rregullimi i procesit të licencimit të IP private | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Udhëzuesi i lehtësimit të licencimit të IP-ve private i rishikuar Numri i IP-ve private të reja të cilat kanë përfituar nga licencimi dhe forma tjera lehtësuese | Plani i publikuar Të dhënat nga SMIA/MASHTI<br><br>Udhëzuesi i publikuar Të dhënat nga SMIA/MASHTI | **60-79 %** Pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, në vitin 2023, janë formuar grupet punuese për hartimin e udhëzimeve administrative dhe njëri nga ta UA për licencimin e institucioneve parashkollore private. Në vitin 2022 janë licencuar për herë të parë rreth 55 IEAPP dhe gjithsej nr. i fëmijëve në bazë të hapësirave të përcaktuara në m/2 është rreth 2495 fëmijë. Kurse në vitin 2023 janë licencuar për herë të parë rreth 26 IEAPP, gjithsej nr. i fëmijëve në bazë të hapësirave të përcaktuara në m/2 është rreth 1500 fëmijë. Sfidë është mungesa e resurseve njerëzore në zyrën e sektorit privat, dhe nivelimi i tyre në politik bërje. |
| 1.1.9. Krijimi i mjediseve të përshtatshme dhe sigurimi i pajisjeve për fëmijë me aftësi të kufizuara | TM1/2023-TM4/2026 | - | 20,000 | Buxheti i Kosovës | DKA Inspektorati i Arsimit | Numri i institucioneve në të cilat janë krijuar mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta | Numri i institucioneve në të cilat janë krijuar mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta | **60-79 %** Në Junik janë ndërtuar pjerrina për fëmijë me nevoja të veçanta por sfidë është mirëmbajtja, menaxhimi i hapësirave të përshtatshme dhe shërbimeve si dhe sigurimi i buxhetit, për furnizim me mjetet e nevojshme për punë dhe nevojave tjera. Në Dragash është ndërtuar një klasë burimore në SHFMU'' Fetah Sylejmani'' dhe është pajisur me pajisje teknologjike të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, janë dërguar pajisje teknologjike mësimore për persona me aftësi të kufizuara në SHFMU ''ilmi Bahtjari'' në Blaç Në Podujevë janë krijuar mundësitë për qasje në tërë hapësirën e objekteve nga fëmijët me nevoja të veçanta dhe janë pajisur me lodra të përshtatshme. Sfidë është kompletimi i stafit në Institucionet Parashkollore dhe kërkohet punësimi i asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta, i pedagogëve, psikologëve, administratorëve. Në Prishtinë është investuar ne vazhdimësi në të gjitha institucionet edukativo-arsimore për të krijuar kushte dhe mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta. Janë ndërtuar 10 pjerrina në institucionet edukative arsimore parauniversitare. Kërkohet të krijohen hapësira edhe brenda institucionit |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | shkollor për fëmijët me nevoja të veçanta. |

| 1.2. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe ofrimi i shërbimeve cilësore në EFH | Infrastruktura ligjore e plotësuar (Ligji për EFH, aktet nënligjore, kurrikula për EFH) | Janë në proces të rishikimit | Aprovohet legjislacioni primar dhe sekondar si dhe kurrikula për EFH | Faqja zyrtare e MASHTI |
| | Dokumenti i Kornizës për vlerësim, me dokumentacionin përcjellës I hartuar dhe i miratuar | Nuk ekziston | Zhvillohet sistemi i vlerësimit të EFH | Raportimet nga Inspektoratet e Arsimit |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 1.2.1. Miratimi i Ligjit për EFH dhe hartimi i akteve nënligjore që burojnë nga Ligji për EFH | TM3/2022-TM4/2023 | 2,900 | 45,200 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Ligji i miratuar nga Qeveria Numri i UA-ve të hartuara<br><br>Numri i standardeve të hartuara | | **40-59 %**<br>Është miratuar Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, në vitin 2023. Pas miratimit, është formuar grupi punues për hartimin e udhëzimeve administrative që dalin nga ky ligj dhe ka filluar koordinimi i punës me donatorët dhe me një grup të ngushtë punues (ku përfshihet divizioni përkatës dhe divizioni ligjor), të cilët kanë punuar drejt fuzionimit të 15 UA në një numër më të vogël. Janë mbajtur 3 punëtori dhe si rezultat grupi ka fuzionuar nga 15 UA sa dalin nga Ligji, në 5 UA për hartim. Njëkohësisht bashkë me UNICEF-in janë angazhuar edhe një ekspertë ndërkombëtare që do ta ndihmojnë grupin punues gjatë këtij procesi. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.2. Hartimi i Kurrikulës për EFH (0-5) | TM3/2022-TM2/2023 | 53,260 | 27,300 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Dokumenti i kurrikulës për EFH i miratuar Dokumenti i kurrikulës bërthamë i rishikuar Dokumentacioni pedagogjik i IP i plotësuar Numri i udhëzuesve të përgatitur | Dokumenti i botuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Dokumenti i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Udhëzuesit e publikuar në faqen zyrtare të MASHT | **80-100 %**<br>Është hartuar dokumenti i kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme. Gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti, janë konsultuar edhe palët e interesit si: edukatoret, drejtorët e institucioneve parashkollore, inspektorët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe OJQ-ve dhe po ashtu edhe zyrtarët e departamenteve tjera në MASHTI-i që ndërlidhen me veprimtarinë e edukimit të hershëm. Më pastaj është realizuar diskutimi publik me palët e interesit, grupi i ngushtë punues ka inkorporuar komentet e dala nga diskutimi publik, ka finalizuar dokumentin e kurrikulës dhe e ka përgatitur për fazën pilotuese. Janë përzgjedhur dhe janë trajnuar 11 trajner për trajnimi e edukatorëve për pilotim te kurrikulës. Janë trajnuar edukatoret, drejtorët e IP-ve, psikologë e pedagogë të IP-ve, zyrtarë të komunave dhe koordinatorë të cilësisë. Ky proces do të shtrihet në 10 komuna, në 12 institucione parashkollore dhe në 20 klasa parafillore. Në pilotim janë përfshirë të gjitha format e organizimit tëe IP-ve. Janë trajnuar edhe të gjithë inspektoret e arsimit për qasjen e kurrikulës së re të EFH -se. Janë hartuar 3 dokumente: Dokumenti bazë i kurrikulës, Udhëzuesi praktik për zbatimin e kurrikulës dhe Udhëzuesi mbi teoritë e të nxënit. |
| 1.2.3. Zhvillimi i standardeve për libra dhe materiale edukative, lodra dhe pajisje të cilat ofrohen për moshën e fëmijëve prej lindjes deri në 6 vjeç në EFH, përfshirë rishikimin nga perspektiva gjinore | TM2/2023 | - | 27,120 | Buxheti i Kosovës | MASHTI ABGJ | Dokumenti i standardeve i miratuar | Dokumenti i standardeve i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **0-19 %**<br>Ky aktivitet është shtyrë për realizim në vitin 2024. |
| 1.2.4. Pajisja e objekteve të EFH me inventar dhe pajisje tjera | TM2/2022-TM4/2026 | 265,000 | 205,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Numri i objekteve të pajisura me inventar dhe pajisje tjera | Raportet e DKA të publikuara | **20-39 %**<br>Është lidhur kontrata me operatorë Ekonomik për furnizim të çerdheve të reja dhe është në fazën e përzgjedhjes së mostrave dhe furnizimit të IP-ve. Sfidë janë procedurat e tej zgjatura për kontraktime dhe sigurimi i artikujve përmes importit.<br>Në Dragash janë pajisur me inventar të nevojshëm. Në Podujevë të tri objektet e ndërtuara gjatë kësaj periudhe janë pajisur me inventar të ri dhe komuna e Prishtinës ka pajisur me inventar institucionet në vazhdimësi në bazë të kërkesave. Tetë (8) institucione parashkollore publike janë furnizuar me tavolina druri, karrika, dollape për garderopë, dyshek, shpuza për dyshek, kënde e qendra për fusha të ndryshme në dhoma si dhe kuzhina improvizuese nëpër dhoma dhe furnizimi me tepih për të gjitha IP, varësisht nga kërkesat e tyre. Është bërë furnizimi me enë kuzhine, uniforma për të gjithë të stafin e IP. Në vazhdimësi furnizohen me mjete higjienike dhe didaktike. Në Vushtrri është inventarizuar një çerdhe. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.5. Rritja e numrit të bashkëpunëtorëve profesional (pedagog, psikolog) për edukimin parashkollor | TM1/2023-TM4/2026 | - | 56,949 | Buxheti i Kosovës | DKA | Numri i bashkëpunëtorëve profesional (pedagog dhe psikolog) të punësuar në nivel komunal | Raportet e DKA të publikuara Raportet nga SMIA/MASHTI | **20-39 %**<br>Ka filluar rishikimi i UA për funksionalizimin e shërbimeve pedagogjiko-psikologjike në shkolla. Janë paraparë 520 pozita në grandin specifik dhe në vazhdimësi nga DKA. Deri me tani janë punësuar 223 dhe gjatë viteve 2022-2023 janë punësuar 76 pedagogë/psikologë.<br>Vetëm në Prishtinë janë punësuar 25 psikologë për të gjithë institucionet edukativo-arsimore. Numri i kufizuar i të punësuarve mbetet sfidë kryesore për punësimin e stafit mbështetës dhe profesional si pedagogë, psikologë, etj. Kërkohet mbështetje e komunave që kanë rritje të popullsisë siç është Prishtina, Fushë Kosova, në rritjen e numrit të pranimit të stafit arsimor, në mënyrë që të ketë hapësirë ligjore për punësim të stafit profesional. Ndërkaq qytetet me numër të vogël të nxënësve në shkolla kane sfidë për shkak se numri i vogël e pamundëson rritjen e bashkëpunëtorëve profesional, bazuar në formulën financiare. |
| 1.2.8. Aftësimi i trajnerëve për pilotimin e Kurrikulës së re për EFH përmes programit të miratuar si dhe pilotimi i kurrikulës në IP dhe vlerësimi i saj | TM1/2023-TM2/2024 | - | 19,500 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i trajnerëve të trajnuar dhe certifikuar Numri i IP që pilotojnë kurrikulën e re<br><br>Raportet mbi vlerësimin e pilotimit të kurrikulës së re | Lista e publikuar e trajnerëve Raportet e MASHTI | **60-79 %**<br>Janë aftësuar 11 trajnerë për kurrikulën e re për edukimin në fëmijërinë e hershme, të cilët janë përzgjedhur pas një testimi nga ana e ekspertit ndërkombëtar të angazhuar për këtë proces. 12 Institucione parashkollore pilotojnë kurrikulën e re për EFH dhe 17 klasa parafillore. Ka sfidë në organizimin e trajnimeve për shkak të angazhimeve të trajnerëve në punën e tyre parësore gjatë ditëve të javës si dhe kurrikula e re dhe qasja e saj që është një sfide në vete për edukatoret dhe nevojitet mbështetja e institucioneve parashkollore me material didaktike për pilotim dhe zbatim të kurrikulës së re për EFH. |
| 1.2.9. Aftësimi i edukatoreve për zbatimin e kurrikulës për EFH | TM2/2024-TM4/2026 | - | - | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i edukatorëve të trajnuar për zbatimin e kurrikulës së se | Raportet e MASHTI | **80-100 %**<br>Janë përzgjedhur 12 institucionet parashkollore dhe 20 klasë parafillore nga zonat urbane dhe rurale në 10 komunat e përzgjedhura në Kosovë që do të jenë pjesë e pilotimit të Kurrikulës së re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Janë trajnuar 133 edukatore nga institucionet parashkollore dhe 16 edukatore të klasave parafillore, 12 drejtor të IP-ve, 13 staf profesional (pedagog, psikolog, logoped dhe asistent të fëmijëve me NVA). Gjatë kësaj periudhe pjesë e trajnimit për pilotimin e kurrikuës së re për EFH, kanë qenë edhe të gjithë inspektorët e arsimit në nivel vendi. Në total 184 pjesëmarrës. Sfidë në këtë proces është bashkëpunimi me komunat gjatë trajnimit të edukatoreve, konkretisht zëvendësimi i edukatoreve në ditë pune dhe delegimi i disa edukatoreve në gjendje jo të mirë shëndetësore. |
| 1.2.12. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit edukativ për çështje të ndryshme që kanë në pah mirëqenien e fëmijëve | TM3/2022-TM2/2025 | 10,880 | 4,975 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Numri i personelit edukativ që ka përfituar nga trajnimet për arsimin gjithëpërfshirës<br>Numri i sesioneve informuese<br>Numri i pjesëmarrësve në sesionet informuese Numri i personelit të trajnuar për të ushqyerit e shëndetshëm | Raportet nga MASHTI, DKA dhe IP | **40-59 %**<br>Në bashkëpunim me UNICEF-in, janë ngritur kapacitetet e 200 edukatoreve në rajonin e Mitrovicës, 16 në komunën e Dragashit, etj, për të ofruar edukim kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në grupet vulnerabël. Të ushqyerit e shëndetshëm, si aktivitet është trajtuar në kurrikulën e re dhe ky aktivitet është zhvendosur për realizim në vitin 2024, mbështetur në kurrikulën e re. Është një sfidë që lidhet me iniciativa në disa komuna për ti shndërruar |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | kuzhinat e institucioneve parashkollore në kuzhina qendrore të cilat nuk mund të ndërlidhen pastaj me kurrikulën e re dhe procesin e edukimit. |
| 1.2.13. Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe trajnimi i edukatoreve si dhe ekipeve vlerësuese komunale në KNF për përdorim të instrumenteve për vlerësim pedagogjik | TM3/2022-TM4/2024 | 11,900 | 21,700 | Donatorët | MASHTI DKA | Instrumentet për vlerësim pedagogjik të miratuara Numri i fëmijëve të vlerësuar | Raportet nga ekipet vlerësuese | **40-59 %** Është formuar komisioni për instrumente për Vlerësim Pedagogjik. Janë trajnuar ekipet vlerësuese në disa komuna për përdorimin e klasifikimit ndërkombëtar të funksionalitetit. P.sh. në Dragash është formuar ekipi dhe i njëjti është trajnuar nga KDF i financuar nga UNICEF. Sfidë është mos pranimi i prindërve me problematikat e fëmijëve të tyre si dhe vështirësia në identifikimin e tyre. |
| 1.2.14. Hartimi i udhëzuesit për mbrojtjen e fëmijëve sipas detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për mbrojtjen e fëmijës | TM2/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Raportet nga DKA dhe IP për përdorimin dhe zbatimin e udhëzuesit për mbrojtjen e fëmijëve | Raportet nga IP, DKA, MASHTI | **40-59 %** Ne disa komuna janë krijuar ekipet për mbrojtjen e për të drejtat e fëmijëve, si ne Dragash Junik, Vushtrrri, Deçan, etj. Në Prishtinë, Drejtoria e Arsimit ka përgatitur planin e veprimit për siguri në shkolla për vitin 2023-2026, që promovon përmirësimin e klimës në shkollë dhe rritjen e sigurisë nga dhe deri në shkollë. |
| 1.2.15. Sigurimi i vazhdueshëm i librave me ilustrime me tema edukative dhe materialeve didaktike | TM2/2022-TM4/2026 | 15,000 | 10,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | DKA | Numri i ekzemplarëve - librave me ilustrime dhe tema edukative - të siguruara dhe në përdorim nga IP-të | Raportet nga IP dhe DKA | **0-19 %** Me vendim nga Kabineti i Ministrisë, nuk ka vazhduar botimi i librave/paketave didaktike për edukim parashkollor. Ndërsa sigurimi i librave me ilustrime, do të realizohen pas miratimit të kurrikulës për EFH. |
| 1.2.16. Hartimi i statutit dhe zbatimi i planit të punës të Kolegjiumit të Drejtorëve | TM2/2023 | - | 7,380 | | MASHTI | Statuti i Kolegjiumit të Drejtorëve i hartuar Plani i punës në implementim | Publikimi i statutit në faqen zyrtare të MASHTI | **60-79 %** Është miratuar vendimi për themelimin e kolegjiumit të drejtorëve të institucioneve parashkollore. Por ende nuk është miratuar kërkesa për mbajtjen e takimit. |
| 1.2.17. Avancimi i Platformës "Edukimi në Distancë - Kujdesi dhe Zhvillimi në EFH" përdoret nga edukatoret, prindërit dhe kujdestarët ligjor si burim për materiale edukative | TM2/2022-TM4/2026 | 35,000 | 25,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Numri i përdoruesve të platformës "Edukimi në Distancë - Kujdesi dhe Zhvillimi në EFH" Numri i shkarkimeve nga platforma "Edukimi në Distancë - Kujdesi dhe Zhvillimi në EFH" | Raportet nga MASHTI | **60-79 %** Është punuar në hartimin e përmbajtjes së platformës, janë hartuar temat mujore/javore dhe ditore. Janë hartuar 1075 aktivitete ditore për fëmijët 0-6 vjeç, të cilat lehtësisht mund të realizohen në ambientet e familjes, janë realizuar 20 video të cilat trajtojnë çështje me rëndësi të zhvillimit të fëmijëve në moshën e hershme, janë trajnuar 1600 edukator për përdorim të platformës dhe janë hartuar 1749 raporte digjitale nga ana e edukatoreve. Platforma prezantohet në gjuhët Shqipe, Turke, Serbe dhe Rome. Platforma ka pasur 2724122 vizitorë që nga lansimi. |

| 1.3. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Ofrimi i mundësive të zhvillimit dhe arritjes së potencialit të plotë të fëmijëve, përmes shërbime të integruara ndër-** | **Mekanizmat ndër- sektorial për EFH në nivel qendror dhe lokal janë funksionale** | **Nuk ekzistojnë** | | |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **sektoriale** | **Funksionalizimi i mekanizmave raportues në SMIA** | | **Nuk ekziston** | | | | | |
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim 2022-2023** |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 1.3.1. Themelimi i grupeve ndërsektoriale për EFH në nivelin qendror dhe lokal dhe hartimi dhe monitorimi i planit të veprimit (MASHTI, MSH, MFPT, AKK) | TM2/2023-TM4/2026 | - | 6,280 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI MSH MFTP AK | Numri i grupeve ndërsektoriale për EFH të themeluara dhe funksionale<br>Plani i veprimit ndërsektorial i hartuar Numri i vizitave nga MASHTI lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve ndërministrore dhe komunale<br>Raportet nga vizitat monitoruese dhe vlerësuese | Raportet nga MASHTI dhe sektorët tjerë<br>Plani i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **0-19 %**<br>Ka filluar punën grupi punues për hartimin e udhëzimeve administrative, pjesë e së cilëve është edhe UA për koordinimin ndërsektorial. Me hartimin e UA për koordinimin ndërsektorial për zhvillimin e EFH do të rregullohet bashkëpunimi ndërsektorial dhe mandej pasojnë aktivitet tjera të parapara. Por aktiviteti në këtë UA është planifikuar për vitin 2024. |
| 1.3.3. Zhvillimi dhe njohja reciproke e programeve trajnuese të ofruara nga Ministritë përkatëse | 0 | - | - | / | MASHTI MSH MFTP | UA për njohjen e trajnimeve i miratuar<br>Numri i programeve të trajnimit të njohura nga ministritë përkatëse<br>Numri i pjesëmarrësve në trajnimet e organizuara nga ministritë përkatëse | Faqja zyrtare e MASHTI Raportet nga MASHTI, MSH, MFTP | **0-19 %**<br>Ka filluar punën grupi punues për hartimin e udhëzimeve administrative, pjesë e së cilëve është edhe UA për koordinimin ndërsektorial. Me hartimin e UA për koordinimin ndërsektorial për zhvillimin e EFH do të rregullohet bashkëpunimi ndërsektorial dhe mandej pasojnë aktivitet tjera të parapara. Por aktiviteti në këtë UA është planifikuar për vitin 2024. |
| 1.3.5. Fuqizimi dhe inkurajimi i rrjetëzimeve të edukatoreve, institucioneve publike dhe private, si dhe formave tjera alternative të EFH, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira | TM2/2023-TM4/2026 | - | 5,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Numri i rrjetëzimeve të themeluara dhe funksionale<br>Numri i aktiviteteve të përbashkëta të organizuara<br>Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e përbashkëta | | **20-39 %**<br>Është punuar në draftimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Caritasit Zviceran dhe MASHTIT për projektin e radhës "TAKE", pjesë e kësaj marrëveshje është edhe rrjetëzimi i edukatoreve, aktivitete këto që pritet të realizohen në vitin 2024/25. Por marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Caritasit Zviceran dhe MASHTIT ende nuk është nënshkruar. |
| **1.4. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | | **Vlera Bazë** | | **Synimi i Përkohshëm 2024** | | **Burimi** | |
| **Ngritja e vetëdijes shoqërore për zhvillimin në fëmijërinë e hershme** | **Mekanizmi për përfshirjen e palëve me interes në aktivitete vetëdijësuese për EFH është funksional** | | **Nuk ekziston** | | **Krijohet mekanizmi i mbledhjes së raporteve të bashkëpunimeve ndërministrore dhe komunale** | | **Raportet nga MASHTI** | |
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim 2022-2023** |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.1. Zhvillimi dhe zbatimi i programe për vetëdijesimin e prindërve dhe komunitetit lidhur me rëndësinë e fëmijërisë së hershme dhe inkurajimin për pjesëmarrje aktive (përfshirë specifikisht sesione dhe aktivitete për baballarët, trajnimet, broshurat, emisione në media, etj.) | TM3/2023-TM4/2026 | - | 85,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI ABGJ Donatorët | Numri i aktiviteteve të zhvilluara për prindërit Numri i prindërve dhe komunitetit që kanë përfituar përmes aktiviteteve vetëdijesuese (të segregohet (veçohet) sipas: gjinisë, përkatësinë etnike) Numri i broshurave të shpërndara Numri i emisioneve në media Numri i sesioneve informuese të organizuara për komunitetin | Raportet nga MASHTI | **80-100%** Në bashkëpunim me UNICEF-in është dizajnuar dhe implementuar aplikacioni mobil për prindërit, të quajtur "Foleja", të cilin prindërit lehtësisht mund ta përdorin për zhvillimin e fëmijëve 0-6 vjeç në fushën e shëndetit, mirëqenies dhe edukimit. Aplikacioni Foleja është prezantuar publikisht nga presidentja e Kosovës dhe është prezantuar në 2 trajnime 5 ditore me personelin shëndetësor. Aplikacioni Foleja është prezantuar në mbi 20 sesione informuese me prindërit, të organizuara në 13 komuna, pjesë e të cilave kanë qenë mbi 200 prindër. Ne 11 trajnimet në të cilat është prezantuar aplikacioni Foleja, janë arritur 15.4K deri ne dhjetor 2023, mbi 15.000 prindër/kujdestarë ligjor (22% meshkuj) të mbështetur përmes këtij aplikacioni. |
| 1.4.2. Organizimi i ngjarjeve në nivel qendror dhe lokal për vetëdijesimin rreth rëndësisë së EFH (konferenca, diskutime) | TM4/2022-TM4/2026 | 15,100 | 15,100 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA Donatorët | Numri I ngjarjeve/aktiviteteve/eventeve të organizuara në nivel qendror dhe lokal | Raportet nga MASHTI dhe DKA | **60-79%** Me mbështetje të UNICEF, është organizuar ngjarja, me ç'rast është prezentuar Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme. Të pranishëm në këtë ngjarje kanë qenë rreth 100 pjesëmarrës dhe po ashtu është përgatitur një video që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe prezantimin e Ligjit. Videoja është prezantuar në këtë ngjarje dhe si e tillë do të prezantohet edhe para opinionit të gjerë.<br>Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Bankën Botërore, është organizua tryeza e diskutimit me temën "Financimi dhe modelet alternative për të zgjeruar disponueshmërinë e shërbimeve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme për të gjithë fëmijët", duke u fokusuar në temën e financimit dhe diversifikimin e modeleve të ofrimit të shërbimeve për EFH, me qëllim zgjerimin e qasjes dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Banka Botërore ka përgatitur dhe ka prezantuar në këtë tryeze edhe analizën mbi kostimin e formave alternative të EFH -së dhe po ashtu nga UNICEF-i është përgatitur raporti i studimit mbi diversifikimin e modeleve të ofrimit të shërbimeve për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme |
| 1.4.3. Zhvillimi i pakove për edukim të fëmijës në ambient të shtëpisë dhe shpërndarja e tyre në familje | TM1/2023-TM4/2025 | - | 80,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Hartimi dhe botimi i pakove për kujdes, edukim dhe lojë Numri i pakove të shpërndara në familje (të segreguara (veçuara) sipas zonës rurale, urban, etnia, statusi i mbështetjes sociale..) | Raportet nga MASHTI dhe DKA | **0-19%** Ky aktivitet është shtyrë për realizim në vitin 2024 në projektin e IPA-III në të cilin është aplikuar, dhe po ashtu në projektin e huamarrjes me Bankën Botërore për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme për kapitalin njerëzor. |
| 1.4.4. Organizimi i sesioneve informuese me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për UA në fuqi i cili ofron mundësi dhe lehtësime për përfshirjen edhe të fëmijëve nga këto komunitete në shërbimet e EFH | TM3/2023-TM4/2026 | 11,250 | 11,250 | Buxheti i Kosovës Donatorët | DKA | Numri i sesioneve informuese të organizuara për komunitetet rom, ashkali, egjiptian Numri i fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian të përfshirë dhe përfitues të shërbimeve të EFH, i ndarë në baza gjinore | Raportet e MASHTI dhe raporti nga SMIA | **40-59%** Janë mbajtur sesione informuese në 5 komuna, të cilat janë organizuar ne kuadër të qendrave mësimore. |
| 1.4.5. Zhvillimi i fushatave kombëtare për rëndësinë e karrierës në EFH, sidomos për fuqizimin e edukatorëve meshkuj | TM3/2022-TM3/2026 | 2,825 | 2,825 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Numri i ngjarjeve të organizuara në fushata kombëtare Numri i studentëve meshkuj në drejtimet e EFH Numri i edukatorëve meshkuj të punësuar | Raportet e MASHTI, SMIA dhe raportet nga Universitet | **0-19%** Ky aktivitet do të realizohet gjatë vitit 2024 , për shkak të shtyrjes së aprovimit të Ligjit dhe po ashtu të Kurrikulës për EFH |

DRAFT

DRAFT

***MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË SA 2022-2026: OBJEKTIVI STRATEGJIK 2***

**OS 2: NGRITJA E CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËRMES KONSOLIDIMIT TË MEKANIZMAVE PËR SIGURIM TË CILËSISË DHE OFRIMIT TË MËSIMDHËNIES CILËSORE**

| 2. Objektivi strategjik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore | Shpenzimet publike në arsimin parauniversitar si përqindje e BPV-së (%) | 3.50% | 3.60% | Raportet statistikore nga ASK<br>Të dhënat statistikore të MASHTI |
| | Përqindja e Institucioneve arsimore (IEAA, DKA, IA, MASHTI) që e përmbushin rolin e tyre për sigurimin e cilësisë | NA | 40% | Raportet nga Inspektorati i Arsimit<br>Të dhënat statistikore të MASHTI |
| | Rezultatet e nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca në teste ndërkombëtare (PISA), të ndara në baza gjinore | PISA 2018<br>Lexim: 353,1<br>Matematikë: 365,9<br>Shkencë: 364,9 | 2%<br>Lexim: 361<br>Matematikë: 373<br>Shkencë: 372 | Raportet dhe analizat nga testet kombëtare dhe ndërkombëtare (PISA) |
| **2.1. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
| Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës dhe llogaridhënies | Zhvillohet, rishikohet dhe zbatohet legjislacioni primar dhe sekondar | Në proces të zhvillimit, rishikimit dhe zbatimit | Zhvillohet dhe rishikohet legjislacioni primar dhe sekondar sipas planit të MASHTI-t | Gazeta zyrtare dhe faqja zyrtare e MASHTI-t dhe publikime |
| | Përqindja e realizimit të planit për riorganizim të rrjetit të shkollave | NA | 40% | Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të DKA-ve<br>Të dhënat statistikore të MASHTI |
| | Përqindja e drejtuesve në institucionet edukativo-arsimore që përzgjidhen dhe performojnë në bazë të standarteve profesionale | NA | 40% | Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të DKA-ve |
| | Përqindja e shkollave që kanë kodin buxhetor dhe menaxhojnë buxhetin e tyre | NA | 40% | Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të DKA-ve<br>Të dhënat statistikore të MASHTI |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.1.1** Ngritja e kapaciteteve të DKA-ve në funksion të përmbushjes së rolit të tyre mbikëqyrës | TM1/2023-TM4/2024 | - | 960 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>DKA | Është përgatitur udhëzuesi për rolin mbikëqyrës të DKA-ve<br><br>Numri i DKA-ve me staf të trajnuar për përmbushjen e rolit të tyre mbikëqyrës | UA e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Lista e zyrtarëve të trajnuar në DKA nga databaza përkatëse | **20-39%**<br>Është hartuar një udhëzues për rolin mbikëqyrës të DKA-ve dhe gjithashtu është përgatitur edhe një modul i veçantë për DKA për mënyrën e monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijëve (parandalim të dhunës, braktisjes dhe përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme). E nevojshme ngritja e kapaciteteve për komunat për të përdorur materialet mbështetëse për ushtrimin e rolit të tyre si mbikëqyrës. |
| 2.1.2 Zhvillimi dhe fuqizimi i mekanizmave për komunikim dhe koordinim efektiv midis palëve të interesit të niveleve të ndryshme në sistem përmes raportimit dhe proceseve koordinuese | TM1/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI<br>DKA | Raportimet e evidentuara të komunikimit dhe koordinimit mes palëve të interesit të niveleve të ndryshme në sistem | Raportet nga takimet | **40-59 %**<br>Mbahen takime të rregullta mujore me DKA-të dhe Kabinetin e Ministres. Për këto takime mbahen procesverbalet nga stafi i Kabinetit të Ministres. Qëllimi i këtyre takimeve është informimi me politika të reja dhe implementimi i tyre në komuna dhe shkolla. Sfidë është pjesëmarrja e vogël e përfaqësuesve nga DKA-të. |
| 2.1.3 Rekrutimi i personelit mësimor dhe drejtues në institucionet edukativo- arsimore në bazë të standardeve profesionale dhe Ligjit për Barazi Gjinore | TM3/2022-TM4/2024 | 4,920 | 9,120 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>DKA | Rishikimi i UA-së për standarde profesionale për drejtorë/zv. drejtorë<br><br>Anëtarët e komisionit për rekrutim të trajnuar<br><br>Numri i grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve në pozita udhëheqëse në institucionet edukativo-arsimore | UA e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Raportet dhe listat e pjesëmarrësve<br><br>Të dhënat statistikore nga MASHTI | **40-59 %**<br>Është hartuar Rregullorja për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve, zv.drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe personelit të shërbimeve të përbashkëta në institucionet publike edukative-arsimore dhe aftësuese të arsimit para universitar dhe është në proces të finalizimit. Në mbështetje të legjislacionit në fuqi sa i përket rekrutimit, MASHTI u ka dërguar DKA-ve letër rekomanduese për respektimin e Ligjit për barazi gjinore në procedurat e punësimit të stafit të institucioneve edukative dhe arsimore. |
| 2.1.4. Forcimi i kapaciteteve menaxheriale të shkollave përmes zhvillimit të programeve të avancuara të trajnimit për drejtor/zv.drejtor të shkollës | TM3/2022-TM4/2026 | 7,920 | 36,240 | Donatorët | MASHTI | Janë zhvilluar, miratuar dhe zbatuar programe të avancuara të trajnimit për drejtor/zv.drejtor të shkollës | Katalogu i programeve të aprovuara për udhëheqës të arsimit.<br><br>Lista e drejtorëve/zv.drejtorëve të trajnuar nga databaza përkatëse | **20-39%**<br>Janë aprovuar 6 programe për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës dhe janë trajnuar rreth 900 staf të shkollës (drejtor, zv. drejtorë dhe mësimdhënës)<br>Mungojnë programet e avancuara të cilët duhet të hartohen dhe duhet të angazhohen ekspertë për hartimin e programeve të avancuara. |
| 2.1.5. Hartimi i Udhëzimit administrativ për ristrukturimin e brendshëm të shkollës | TM3/2022 | - | - | / | MASHTI | Udhëzimi administrativ për ristrukturimin e brendshëm të shkollës i hartuar dhe i zbatuar | UA e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **20-39%**<br>Kanë përfunduar procedurat e diskutimit paraprak dhe publik për UA për ristrukturimin e brendshëm të shkollës dhe është proceduar për procedura të mëtutjeshme në Kabinetin e Ministres. Sfidë është ligji i pagave dhe rregulloret për shtesa të cilat i kanë përcaktuar pozitat e punës në sektorin publik dhe nuk kanë paraparë pozitat të cilat janë në këtë UA. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.6. Fuqizimi i menaxhmentit të mesëm (aktiveve, Këshillat drejtues, Këshillat e prindërve, etj.) | TM1/2023-TM4/2026 | - | 6,600 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>DKA | Raportet nga vlerësimi i funksionalizimit të këshillave drejtues të shkollave dhe këshillave të prindërve në të gjitha nivelet | Raportet e vlerësimit | **20-39%**<br>Është realizuar një pyetësor në 4 komuna me 31 shkolla lidhur me nevojat e fuqizimit të KDSH dhe KP-ve. Vërehet mungesa e pjesëmarrjes së prindërve në takime dhe në aktivitetet e shkollës në përgjithësi. Duhet të përkrahën KDSH-të dhe KO-të, në procesin e hartimi të rregulloreve dhe aktiviteteve jashtëshkollore, duke u përqendruar në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të PZHSH-së (Plani Zhvillimor i Shkollës), menaxhimit financiar të shkollës, etj. dhe të mbështetën për të kuptuar se si vendimet e tyre (KDSH, KP, AKTIVEVE) ndikojnë në performancën dhe rezultatet e nxënësve. |
| 2.1.7. Krijimi i kolegjiumeve të drejtorëve të shkollave nëpër komuna | TM3/2022-TM4/2023 | 3,000 | 2,792 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>DKA | Udhëzuesi për funksionimin e kolegjiumit i hartuar dhe miratuar<br><br>Trajnime me përfaqësues në komuna për funksionim të kolegjiumit | Udhëzuesi i publikuar<br><br>Listat e pjesëmarrësve nga trajnimet | **20-39%**<br>Është krijuar kolegjiumi për drejtorë për çerdhe dhe për shkollat e arsimit profesional. Mbahen kontakte dhe koordinime me drejtorë të IEA me qëllim të zbatimit të politikave. Por po ka vështirësi në koordinimin e DKA-ve për krijimin e kolegjiumeve të shkollave fillore dhe te mesme. Por, megjithatë, disa komuna i kanë krijuar kolegjiumet. |
| 2.1.8. Rritja dhe menaxhimi i rrjetëzimit të shkollave (komunitetet e të mësuarit së bashku) | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI<br>DKA | Numri i rrjeteve të shkollave (komunitetet e të mësuarit së bashku) | Raportet vjetore të DKA-ve | **20-39%**<br>Janë disa aktivitete jashtëkurrikulare që shkollat i organizojnë së bashku, p.sh. organizimi i garave. |
| 2.1.9. Hartimi i UA-së për zbatimin e formulës së financimit | TM1-TM4/ 2023 | - | 8,740 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Udhëzimi administrativ për zbatimin e formulës së financimit i hartuar dhe i zbatuar<br><br>Përqindja e shkollave që kanë kodin buxhetor dhe menaxhojnë buxhetin e tyre | UA e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Vendimi për kodin buxhetor<br><br>Raportet e DKA-ve | **20-39%**<br>Është hartuar një draft i UA-së për zbatimin e formulës së financimit cili është përcjellë në Kabinetin e Ministres. |
| 2.1.10 . Zhvillimi i kapaciteteve në shkollë dhe në DKA për menaxhim financiar | TM1-TM4/ 2023 | - | 3,840 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>DKA | Numri i DKA-ve dhe shkollave me staf të trajnuar për menaxhim financiar | Lista e zyrtarëve të trajnuar në DKA dhe shkolla nga databaza përkatëse | **0-19%**<br>Ndërlidhet me aktivitetin paraprak kështu që nuk ka progres deri sa të miratohet UA për zbatimin e formulës së financimit. |
| 2.1.11. Riorganizimi i rrjetit të shkollave | TM1-TM4/ 2023 | - | 18,320 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>DKA | Hartimi i UA-së për riorganizim të shkollave<br><br>Numri i komunave me rrjet të riorganizuar të shkollave | UA e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Raportet nga DKA | **40-59 %**<br>Është hartuar analiza e gjendjes, janë identifikuar shkollat me numër të vogël të nxënësve, janë hartuar prioritetet 1,2 dhe 3 për trajtim, është plotësuar pyetësori nga komunat, janë mbajtur takime me DKA. Po ashtu, është hartuar UA-10/2023 që rregullon themelimin dhe procedurat e pushimit të veprimtarisë së IEAAP. Sfidë mbetet zbatimi i dispozitave të UA 10/2023 për kriteret dhe procedurat për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së shkollës. Si dhe ka hezitim nga DKA-të për inicimin e procedurave për pushim të veprimtarisë. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.12. Hartimi i raporteve nga SMIA në funksion të sistemit arsimor dhe raportimit ndërkombëtar (ISCED 11 dhe ISCED 13-F) dhe shpërndarja dhe shfrytëzimi i tyre nga sektorët përkatës për politikëbërje dhe vendimmarrje (debate, seminare, konferenca të ndryshme) | TM1/2022-TM4/2026 | 15,000 | 3,900 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>DKA | Numri i raporteve nga SMIA dhe numri i debateve, seminareve e konferencave të mbajtura për diskutim të raporteve<br><br>Raporte nga vlerësimi dhe fuqizimi i sistemit të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuar, e fokusuar në SMIA | Raportet vjetore nga SMIA/MASHTI<br><br>Raportet nga organizimi i debateve, seminareve dhe konferencave | **80-100 %**<br>MASHTI, konkretisht Divizioni për grumbullimin dhe analizën e të dhënave ka përgatitur, botuar dhe publikuar: "Statistika e Arsimit në Kosovë 2021-2022", "Statistika e Arsimit në Kosovë 2022-2023", "Raport vjetor statistikor me tregues arsimor 2021-2022" dhe "Raport vjetor statistikor me tregues arsimor 2022-2023", "Shënime statistikore 2021-2022" dhe Shënime statistikore 2022-2023" . Gjithashtu, janë përgatitur të dhëna dhe raporte të ndryshme statistikore për dokumente të ndryshme në nivel të MASHTI-t, në nivel të qeverisë dhe për organizata vendore dhe ndërkombëtare. Sfide mbetet mungesa e stafit (stafi i tanishëm është i angazhuar edhe në punë dhe detyra të divizioneve tjera). Po ashtu, mos raportimi i të dhënave në sistem nga ana e shkollave me mësim në gjuhën serbe. Sistemi I Menaxhimit të Informatave në Arsim është zhvilluar në vitin 2010 dhe ka nevojë për avancim dhe ridizajnim. |

| 2.2. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë** | **Numri i inspektorëve të rinj të angazhuar dhe trajnuar, i ndarë në bazë gjinore** | **33** | **70** | **Raportet nga Inspektorati i Arsimit<br>Të dhënat statistikore të MASHTI** |
| | **Numri i drejtorëve/zv. drejtorëve të vlerësuar, i ndarë në bazë gjinore** | **7%** | **40%** | **Raportet nga Inspektorati i Arsimit<br>Të dhënat statistikore të MASHTI** |
| | **Numri i shkollave që i nënshtrohen VB dhe VJ të performancës** | **7%** | **40%** | **Raportet nga Inspektorati i Arsimit<br>Të dhënat statistikore të MASHTI** |
| | **Numri i komunave që i kanë hartuar planet zhvillimore komunale të integruara** | **13** | **23** | **Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të DKA-ve<br>Të dhënat statistikore të MASHTI** |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 2.2.1. Shtimi i numrit të inspektorëve të arsimit përfshirë punësimin e inspektoreve femra si edhe nga komunitetet jo shumicë | TM3/2022-TM4/2024 | 55,465 | 275,723 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit | Numri i inspektorëve të rekrutuar përfshirë edhe nga komunitetet jo shumicë<br><br>Numri i inspektoreve të rekrutuara gra | Vendimet për angazhimin e stafit | **0-19 %**<br>Është shpallur konkursi për rekrutimin e 20 inspektoreve të rinj për 7 rajonet, është kryer vlerësimi i kandidatëve nga ana e komisionit të përbashkët MASHTI - MPB, si dhe janë publikuar në ëebfaqe rezultatet e vlerësimit. Por në fazën e shqyrtimit të ankesave konkursi është anuluar. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i inspektorëve të arsimit | TM1/2023-TM4/2025 | - | 5,280 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit | Numri i inspektorëve të trajnuar përfshirë edhe nga komunitetet jo shumicë | Evidencat e trajnimit të inspektorëve. | **20-39 %**<br>Trajnimi i 20 inspektorëve në projektin "Ndërtimi i kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës – INCLUDE" (viti 2022). Numri i pamjaftueshëm i inspektorëve ka ndikuar në mos përfshirjen e të gjithëve në procese të vlerësimit të performancës. E nevojshme trajnim i vazhdueshëm i inspektorëve të arsimit, me theks të veçantë për vlerësim të performancës së shkollës, drejtorëve/zëvendës drejtorëve dhe mësimdhënësve. |
| 2.2.3. Krijimi dhe trajnimi i ekipeve profesionale për vlerësim (VB dhe VJ i performancës) dhe mbështetje të shkollave, mësimdhënësve dhe drejtorëve/zv.drejtorëve (në nivel komunal dhe qendror | TM3/2022-TM4/2024 | 4,920 | 4,800 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit<br>IPK | Rishikimi i Kornizës për VPSH, udhëzuesve dhe instrumenteve për VBSH dhe VJSH<br><br>Numri i komunave që kanë krijuar ekipe profesionale për ofrim të mbështetjes shkollave, mësimdhënësve dhe drejtorëve/zv. drejtorëve (në nivel komunal dhe qendror) | Instrumentet e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI<br><br>Raportet nga DKA për ekipet profesionale të krijuara<br><br>Raportet e trajnimeve<br><br>Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve | **20-39 %**<br>Është kryer vlerësimi i performancës së 68 drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave (54 drejtorë dhe 14 zëvendësdrejtorë). Po ashtu, është kryer edhe vlerësimi i jashtëm i performancës së 28 shkollave (VJPSh).<br>Krahas kornizës përtej VPSH, VBSH dhe VJSH, MASHTI ka hartuar modul të veçantë për inspektorë për mënyrën e monitorimit të politikës së mbrojtjes së fëmijës (parandalim të dhunës, braktisjes dhe përfshirjes së fëmijëve në punë të detyrueshme. Sfidë mbetet numri i vogël i inspektorëve dhe nevoja për ngritje të kapaciteteve të inspektorëve për të përdorur materialet mbështetëse për ushtrimin e rolit të tyre mbikëqyrës për sa I përket politikave të mbrojtjes së fëmijëve. |
| 2.2.4. Realizimi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës | TM1/2023-TM4/2026 | - | 40,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i shkollave që i nënshtrohen VB dhe VJ të performancës së shkollës dhe raportet nga vlerësimet | Raportet nga Inspektorati për VB dhe VJ<br>Lista e shkollave të vlerësuara me VB dhe VJ | **40-59 %**<br>Është kryer vlerësimi i jashtëm i performancës së 28 shkollave, si dhe është kryer vlerësimi i performancës së 143 drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Sfidë mbetet numri i vogël i shkollave (drejtorëve, koordinatorëve, etj.) të trajnuar për procesin e vlerësimit të brendshëm e po ashtu edhe numri i vogël i inspektorëve në përgjithësi dhe në veçanti i atyre të trajnuar për procesin e vlerësimit të jashtëm. |
| 2.2.5. Hartimi i planeve zhvillimore nga shkollat dhe komunat në përputhje me legjislacionin në fuqi | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit<br>DKA | Komunat dhe shkollat hartojnë plane zhvillimore të arsimit që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (sipas fushave të cilësisë dhe të harmonizuara)<br><br>Numri i komunave që monitorojnë me rregull planet zhvillimore të shkollave dhe ofrojnë mbështetje për zbatimin e tyre | Raportet nga DKA për monitorim | **20-39 %**<br>Planet zhvillimore të shkollave janë kontrolluar gjatë vlerësimit të jashtëm të performancës së 28 shkollave, si dhe gjatë vlerësimit të 143 drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave. Struktura e planeve zhvillimore të shkollave ka qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, mirëpo ka pasur raste kur hartimi i tyre nuk është i bazuar në gjetjet nga VB, përkatësisht në fushat përkatëse të cilësisë. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.6. Fuqizimi i rolit të koordinatorëve të cilësisë (KC) në shkolla, komuna dhe MASHTI që janë funksional në përmbushjen e rolit të tyre | TM3/2022-TM4/2026 | 3,000 | 14,640 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit<br>IPK<br>DKA | Analizë e funksionimit të KC në shkolla që do të pasojë me trajnime<br><br>Numri i komunave dhe shkollave që kanë KC që janë funksional në përmbushjen e rolit të tyre<br><br>Përcaktohet KC në MASHTI | Raporti nga analiza Raportet e trajnimeve<br><br>Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve<br><br>Vendimi për emërim | **40-59 %**<br>Është kontrolluar funksionimi i Koordinatorëve të Cilësisë në 28 shkolla të cilat iu kanë nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës, gjatë vlerësimit të 143 drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, si dhe në 21 komuna në të cilat janë realizuar këto vlerësime. Sfide janë rastet kur KC nuk e kanë mbështetjen e mjaftueshme të shkollës dhe/apo të DKA-së përkatëse, si dhe rastet kur KC nuk i njohin mjaftueshëm detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë. Prandaj, nevojiten trajnime adekuate për KC, si dhe takime informative me DKA-të dhe shkollat për fuqizimin e rolit të KC në procesin e sigurimit të cilësisë. |
| 2.2.7. Informim i profesionistëve, politikëbërësve, prindërve dhe publikut të gjerë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar (debate, seminare, konferenca, etj.) | TM3/2022-TM4/2026 | 3,000 | 3,000 | Donatorët | MASHTI<br>Inspektorati i Arsimit<br>IPK<br>DKA | Profesionistët, politikbërësit dhe publiku i gjerë shfrytëzojnë burime të ndryshme informacioni për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar<br><br>Të dhënat nga monitorimi i arsimit u raportohen shkollave dhe komunave | Raportet nga organizimi i ngjarjeve të ndryshme për sigurim të cilësisë<br><br>Raportet nga takimet me shkolla dhe komuna. | **60-79 %**<br>Janë bërë raportimet e rregullta të ministres për të arriturat që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në Arsimin para universitar<br>Është mbajtur konferencë për rezultatet nga vlerësimet ndërkombëtare. P.sh. PISA, TIMSS, etj.<br>Janë ndarë raportet e PISA, TIMSS, etj. |
| 2.2.8. Shpërndarja dhe shfrytëzimi i Kartës Raportuese të Shkollës që mundëson të dhëna me cilësi më të lartë dhe monitorimin e progresit më transparent dhe efektiv në të gjitha shkollat | TM3-TM4/2023 | - | 6,000 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>DKA | Moduli i krijuar për KRSH<br><br>Karta raportuese e shkollës përdoret nga të gjitha shkollat | Raportet për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e KRSH | **0-19 %**<br>Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak të mos krijimit të softverit gjatë projektit të Bankës Botërore dhe ende kjo nuk është bërë. |

| 2.3. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e margjinalizuara përmes krijimit të klimës nxitëse dhe përkrahëse** | **Përqindja e braktisjes në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë** | **Arsimi i obligueshëm: 0.1%<br>Arsimi i mesëm i lartë: 1.2%** | **Arsimi i obligueshëm: të mbetet nën 0.1%<br>Arsimi i mesëm i lartë: 1%** | **Të dhënat periodike statistikore nga ASK dhe MASHTI, të ndara me bazë gjinore, etnike, moshe, pozite gjeografike, apo baze tjetër** |
| | **Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollim të obligueshëm dhe të mesëm të lartë** | **Arsim i obligueshëm: 44%<br>Arsim i mesëm i lartë: 25%** | **Arsim i obligueshëm: 55%<br>Arsim i mesëm i lartë: 30%** | **Të dhënat periodike statistikore nga ASK dhe MASHTI, të ndara me bazë gjinore, etnike, moshe, pozite gjeografike, apo baze tjetër** |
| | **Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë** | **Arsim i obligueshëm: 75%<br>Arsim i mesëm i lartë: 31%** | **Arsim i obligueshëm: 80%<br>Arsim i mesëm i lartë: 40%** | **Të dhënat periodike statistikore nga ASK dhe MASHTI, të ndara me bazë gjinore, etnike, moshe, pozite gjeografike, apo baze tjetër** |
| | **Numri i fëmijëve me talente të veçanta të identifikuar në kuadër të sistemit** | **284/vit** | **300/vit** | **Raportet nga MASHTI/Organizatat mbështetëse** |

DRAFT

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 2.3.1. Rritja e kapaciteteve dhe funksionalizimi i shërbimeve pedagogjike-psikologjike në institucione edukativo-arsimore në të gjitha nivelet | TM3/2022-TM4/2026 | 141,757 | 695,432 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Përqindja e shkollave që kanë shërbime pedagogjike-psikologjike | Vendimet e stafit të angazhuar<br><br>Raportet nga DKA | **60-79 %**<br>Bazuar në të dhënat që i posedojmë në sistemin SMIA, deri më tani janë punësuar 223 dhe gjatë viteve 2022-2023 janë punësuar 76 pedagogë dhe psikologë në institucionet edukativo-arsimore parauniversitare. Gjithashtu, është themeluar grupi punues për rishikimin e UA Nr.34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla. Janë paraparë 520 pozita në grandin specifik dhe në vazhdimësi nga DKA. Sfidë mbetet rekrutimi i tyre në institucione nga ana e komunave. |
| 2.3.2. Zhvillimi profesional i personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës | TM3/2022-TM4/2024 | 19,365 | 30,665 | Donatorët | MASHTI | Numri i personelit arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës | Lista e mësimdhënësve të trajnuar nga databaza përkatëse. Raportet e trajnimeve | **60-79 %**<br>Janë trajnuar 450 mësimdhënës për arsim gjithëpërfshirës. Sfidë mbetet zbatimi i mësimeve të marra nga trajnimet për arsimin gjithëpërfshirës në shkolla. |
| 2.3.3. Funksionalizimi i ekipeve vlerësuese pedagogjike për nxënësit me aftësi të kufizuara | TM1/2022-TM4/2024 | 16,390 | 7,690 | Donatorët | MASHTI | UA për vlerësim pedagogjik i rishikuar<br><br>Trajnimi i ekipeve vlerësuese për përdorimin e instrumenteve vlerësuese | Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve | **60-79 %**<br>Janë trajnuar ekipet vlerësuese në disa komuna për përdorimin e klasifikimit ndërkombëtar te funksionalitetit. Por sfidë mbetet sigurimi i qëndrueshmërisë se ekipeve vlerësuese. |
| 2.3.4. Rritja e numrit të asistentëve të punësuar dhe aftësimi i tyre për mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara në qendra burimore dhe arsim gjithëpërfshirës | TM3/2022-TM4/2026 | 134,562 | 1,076,494 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Numri i asistentëve të punësuar për të përkrahur nxënësit me aftësi të kufizuara | Vendimet e stafit të angazhuar | **40-59 %**<br>Është në proces rekrutimi i asistentëve të rinj që do të punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta. Bazuar në të dhënat që i posedojmë në sistemin SMIA, deri tani janë punësuar gjithsej 190 asistentë për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta gjatë viteve 2022-2023. |
| 2.3.5. Mbështetje pedagogjike për nxënësit që nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënit për fushat (gjuhë, shkenca dhe matematikë) | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Numri i nxënësve që kanë arritur rezultatet e të nxënit për fushat gjuhë, shkenca dhe matematikë (mësim plotësues dhe shtues dhe përmes mësimdhënësve të rinj) | Raportet nga DKA | **20-39 %**<br>Shkollat ofrojnë mbështetje pedagogjike por mungojnë të dhënat se sa shkolla dhe si ofrohet mbështetja. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.6. Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj braktisjes dhe punës së detyruar dhe të rrezikshme të fëmijëve | TM3/2022-TM4/2026 | 11,250 | 15,500 | Donatorët | MASHTI DKA | Raportet nga ekipet e EPRBM të shkollave dhe nga komunat.<br>Përqindja e braktisjes në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët mbetet nën 0.1% apo 1%?<br>Zvogëlohet përqindja e vajzave që e braktisin shkollën<br>Zvogëlohet përqindja e përfshirjes së fëmijëve në punë të detyruar dhe të rrezikshme | Raportet nga EPRBM dhe shkollat në SMIA | **60-79 %**<br>Janë themeluar ekipet edhe ne SHML dhe janë mbështetur 15 komuna për hartimin e planeve komunale të veprimit. Janë plotësuar dy indikatorë (largësia e udhëtimit dhe angazhimi në punë) në modulin e paralajmërimit të hershëm në SMIA. Janë rishikuar doracaket për funksionimin e ekipeve shkollore dhe komunale, si dhe janë mbajtur seanca në 20 komuna për mënyrën e funksionimit të ekipeve dhe zbatimit të politikave kundër braktisjes. Janë mbajtur sanca informuese në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, dhe në vazhdimësi bëhet koordinimi me komunat për zhvillimin dhe finalizimin e planeve të veprimit për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes.<br>Në kuadër të moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës është zhvilluar moduli për parandalimin e martesave të hershme, por edhe modulet për parandalimin e diskriminimit dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes, module këto që kanë ndikim në favorizimin e grupeve të cënueshme (përfshirë edhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian). Gjithashtu, Ligji për mbrojtjen e fëmijës është përgatitur në versionin miqësor në 4 gjuhë: shqipe, serbe, turke dhe rome.<br>Është aprovuar dhe lansuar pakoja e moduleve tematike, përfshirë modulin për parandalimin e martesave të hershme dhe modulin për parandalimin e punës së rrezikshme. Gjithashtu është mbajtur edhe sesion diskutimi me prindër të nxënësve të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas lidhur me parandalimin e martesave të hershme.<br>Problemet e shumta sociale dhe familjare që vështirësojnë procesin e vijimit të rregullt të shkollimit, që sfidon funksionimin e punës së ekipeve. Sipas raportimeve në SMIA, në vitin 202/23 i kemi 191 (0.09%) nxënës braktisës në arsimin 1-9, prej tyre 102 djem dhe 89 vajza. Ndërkaq, ose 1005 (2.33%)nxënës braktisës në arsimin 10-12, prej tyre 792 djem dhe 213 vajza. Në Gjysmëvjetorin e parë të vitit 2023/24 i kemi 723 nxënës braktisës ( 108 në Kl. 1-9 dhe 615 Kl. 10-12) |
| 2.3.7. Mbështetje e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në arsimin e obligueshëm | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Rritet numri i fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në arsimin e obligueshëm përmes formave të ndryshme të mbështetjes (bursa, transport, etj.)<br><br>Numri i fëmijëve që përfitojnë me forma alternative të mësimit, i ndarë në baza gjinore | Raportet nga DKA | **40-59 %**<br>Janë siguruar tekstet dhe materialet mësimore falas nga MASHTI. Është ndarë buxhetit për DKA për sigurimin e transportit për nxënësit sipas legjislacionit në fuqi . Është bere organizimi i mësimit për të rritur për nivelin e arsimit të obligueshëm ku përfitojnë kategori të cenueshme të cilët nuk kanë pasur shkëputje nga sistemi arsimor për arsyeje te ndryshme. Është ofruar mbështetje vjetore financiare e OJQ qe mbështesin fëmijët e komiteteve rom, ashkali dhe egjiptian. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.8. Regjistrimi dhe mbështetja financiare e qendrave mësimore (përkrahja e organizatave/projekteve që drejtojnë qendrat mësimore) | TM3/2022-TM4/2026 | 300,000 | 300,000 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI DKA | Përfshirja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor, në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë është rritur.<br><br>Numri i qendrave mësimore të regjistruara dhe të mbështetura (përkrahja e organizatave/projekteve që drejtojnë qendrat mësimore). | Lista e publikuar nga MASHTI për qendrat mësimore të regjistruara dhe mbështetura<br><br>Raportet nga MASHTI për përfshirje të | **80-100 %**<br>Numri i qendrave mësimore të regjistruara është 52. Përkrahja e organizatave jo qeveritare që drejtojnë qendra mësimore në vitin 2022 janë 5 OJQ përfituese nga thirrja publike dhe shuma e planifikuar dhe e shpenzuar është 200.000.00 euro ndërsa në vitin 2023 kanë përfituar 7 OJQ me gjithsej 21 qendra mësimore shuma e planifikuar dhe e shpenzuar është 200,000.00 euro<br>Gjatë vitit 2023 në kuadër të projektit të përbashkët MAShTI -KiE "INCLUDE" janë organizuar trajnime për stafin e qendrave mësimore gjithashtu janë mbajtur punëtori për hartimin e një kornize të përgjithshme të planprogrameve për qendrat mësimore. Korniza është hartuar dhe është finalizuar.<br>janë themeluar, riformatuar ekipet për paradalim në 15 komuna të përfshira në projektin e UNICEF (Kamenicë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Shtime, Ferizaj, Dragash, Prizren, Gjakovë, Pejë, F.Kosovë, Obiliq, Lipjan dhe Suharekë. Në 15 komuna janë realizuar seancat fillimisht me EPRBM të shkollave të mesme të larta rreth funksionimit të ekipeve sipas UA 8/2018. Është hartuar drafti fillestar i Planit komunal të veprimit për ta plotësuar tutje sipas konteksteve dhe specifikave të komunave. Modeli i Planit Komunal të veprimit është zhvilluar në tërësi dhe iu është shpërndarë 15 komunave që ta finalizojnë sipas specifikave te komunave. Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes në bashkëveprim me ECMI Kosova po i asistojnë komunat ne finalizimin e planeve te tyre, te cilat miratohen ne kuvendet komunale përkatëse. Janë mbajtur dy punëtori për finalizimin e planeve komunale të veprimit. Planet pritet të aprovohen në kuvendet përkatëse komunale. Në këtë periudhë u shënua edhe "Java kundër braktisjes" përmes organizimit të aktiviteteve sensibilizuese e në komuna, si: seanca me Këshillin e nxënësve dhe konferenca në nivel nacional, me ç`rast edhe janë shpërblyer shkollat për raportimet cilësore. |
| 2.3.9. Ofrimi i mbështetjes financiare për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin e arsimit të mesëm të lartë | TM3/2022-TM4/2024 | 150,000 | 150,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Numri i përfituesve të bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, i ndarë në baza gjinore<br><br>Numri i vajzave nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian që përfitojnë bursa, në kuadër të masave afirmative | Thirrjet e publikuara Listat e përfituesve Raportet vjetore | **80-100 %**<br>MAShTI sikurse çdo vit shkollor, edhe në vitin shkollor 2022/2023 ka ndarë bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. MAShTI ka planifikuar 500 bursa – 150.000 Euro, dhe Numri I bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian dhe për vitin shkollor2022/2023 është 498 të cilët kanë përmbushur kriteret. Pagesa e bursave për vit mësimor bëhet në vlerë prej 300 Eurosh për nxënës për periudhën shtator – qershor.<br>Numri i përfitueseve të bursave sipas gjinisë është: Për vitin shkollor 2022/2023 - 243 vajza dhe 255 djem ndërsa për vitin shkollor 2023/2024 është 244 vajza dhe 223 djem. Është shpallë konkursi për vitin shkollor 2023-2024 për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian. Komisioni i ka shqyrtuar aplikacionet dhe përfitues të bursave janë 467 nxënës të cilët i kanë përmbushur kriteret (244 femra dhe 223 meshkuj) në vlerë prej 140 300 Eurove. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| 2.3.10. Identifikimi dhe përkrahja e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta. | TM3/2022-TM4/2026 | 200,000 | 200,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Numri/Përqindja e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta të identifikuar dhe përkrahur, i ndarë në baza gjinore | Raportet nga MASHTI | **80-100 %**<br>Gjatë viteve 2022-2023 MASHTI ka ndarë subvencione në vlerë prej 170 000 Euro për çdo vit për OJQ për identifikimin e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente, Sipas të dhënave të institutit ATOMI, nxënës të identifikuar me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti në vitin 2022 janë: 54 atomiste (14 femra dhe 40 meshkuj). Për vitin 2023-2024 janë duke vazhduar me identifikim deri në muajin qershor por në këtë periudhë kane identifikuar 15 atomist ( 7 femra dhe 8 meshkuj). |
| 2.3.11. Organizimi i formave të mbështetjes, garave në nivele dhe fusha të ndryshme, dhe shpërblimi i nxënësve që fitojnë medalje në gara vendore dhe ndërkombëtare. | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Janë organizuar garat në nivele të ndryshme dhe janë ndarë shpërblime për fituesit | Raportet nga organizimi i garave | **80-100 %**<br>Gjatë viteve 2022-2023 MASHTI ka ndarë subvencione në vlerë prej 170 000 Euro për çdo vit për OJQ për organizimin dhe mbarëvajtjen e garave në nivel vendi dhe pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre garave në vitin 2022 janë shpërblyer 45 nxënës, ndërsa ne vitin 2023 janë shpërblyer 88 nxënës. |
| 2.3.12. Fuqizimi i mekanizmave për sistemimin e nxënësve të riatdhesuar dhe të huaj | TM3/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Përfshihen të gjithë nxënësit e riatdhesuar dhe të huaj në sistemin arsimor<br>Janë ofruar programe për mësim të përshpejtuar të gjuhës shqipe.<br>Raporte mbi aktivitetet për nxënësit e riatdhesuar dhe të huaj (aktivitete mësimore (shtuese dhe plotësuese) | Raportet nga MASHTI/DKA-të për përfshirjen e nxënësve.<br><br>Raportet mbi aktivitetet e organizuara | **80-100 %**<br>Janë sistemuar të gjithë nxënësit e riatdhesuar në sistem, është organizuar mësimi plotësues në 9 komuna me 31 nxënës, janë furnizuar me material didaktik dhe tekste mësimore që janë të dedikuara për nxënësit e riatdhesuar. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.13. Përkrahja e sistemit për organizmin dhe mbarëvajtjen e mësimit në diasporë | TM3/2022-TM4/2026 | 181,100 | 181,100 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Konferenca vjetore me mësimdhënësit në diasporë (Kosovë/Shqipëri) 100x3 ditë/akomodim<br>Raporte mbi organizmin dhe mbarëvajtjen e mësimit në diasporë | Raportet nga organizimi i konferencave<br><br>Raportet nga MASHTI mbi aktivitetet | **40-59 %**<br>janë hartuar tekstet shkollore për nxënësit e mësimit plotësues në diasporë: Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare për nivelet 1 dhe 2. Është organizuar seminari XVI mbarëkombëtar për mësuesit e mësimit plotësues në diasporë (Vlorë, Shqipëri, në gusht 2023). Procesi i hartimit të tekstit shkollor për nxënësit e mësimit plotësues në diasporë vazhdon për nivelin e 3-të. Sfidë mbetet mungesa e stafit - zyrtarit përgjegjës për Diasporë. |

| 2.4. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Sigurimi i mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas normave dhe standardeve, që mundësojnë mësim cilësor** | **Numri i shkollave të ndërtuara dhe renovuara** | **NA** | **Të ndërtuara: 20<br>Të renovuara: 40** | **Të dhënat statistikore të MASHTI** |
| | **Numri i IEAA që plotësojnë kushtet higjienike-sanitare** | **NA** | **50%** | **Raportet e inspektoratit sanitar<br>Të dhënat statistikore të MASHTI** |
| | **Përqindja e rasteve të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla** | **NA** | **40%** | **Raportet e monitorimit dhe vlerësimit Të dhënat statistikore të MASHTI** |

| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | **Progresi në zbatim 2022-2023** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 2.4.1. Ndërtimi i objekteve të reja shkollore bazuar në raportet e analizës së gjendjes | TM3/2022-TM4/2026 | 12,107,485 | 10,350,485 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Raporte nga monitorimet e projekteve për ndërtim të objekteve shkollore sipas normave dhe standardeve:<br>-Sigurimi i lokacioneve<br>- Punimi i projekteve<br>- Lidhja e kontratave<br>- Numri i shkollave të ndërtuara | Raportet vjetore për infrastrukturë/ MASHTI | **60-79 %**<br>Në vitin 2022 janë ndërtuar 4 shkolla të reja fillore dhe të mesme të ulëta Në vitin 2023 janë ndërtuar 6 shkolla të reja fillore dhe të mesme të ulëta. Grantet janë ndarë në të gjitha komunat. Sfidë është sigurimi i projekt-dizajneve dhe lejeve të ndërtimit nga komunat që parashtrojnë kërkesa si dhe analizat për stabilitetin e ndërtesave ekzistuese (pse duhet të zëvendësohet) te rastet kur kërkesa është për shkak të amortizimit. Si dhe sigurimi i lokacioneve dhe të gjitha dokumentacioneve të nevojshme si dhe lejet e ndërtimit nga komunat. |
| 2.4.2. Renovimi i objekteve ekzistuese shkollore bazuar në raportet e analizës së gjendjes | TM3/2022-TM4/2026 | 1,020,000 | 5,700,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Raporte për numrin e shkollave të vlerësuara për renovim:<br>- Punimi i projekteve<br>- Lidhja e kontratave<br>- Numri i shkollave të renovuara | Raportet vjetore për infrastrukturë/ MASHTI | **60-79 %**<br>Në vitin 2022 janë renovuar tualetet në 20 shkolla. Në vitin 2023 janë renovuar tualetet në 3 shkolla Sfidë është sigurimi i projekt-dizajneve dhe përshkrimeve të punë- paramasave dhe parallogarive nga komunat që parashtrojnë kërkesa. Poashtu në proces të ndërtimit janë 14 pjerrina në shkolla. |
| 2.4.4. Krijimi i hapësirave shkollore për punë në laborator dhe në kabinete (pajisja e tyre me pako laboratorike dhe mjete dhe materiale mësimore), inventarizim, kënde pushuese si dhe pajisje dhe pasurimi i | TM1/2022-TM4/2026 | 1,615,000 | 2,170,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i shkollave të funksionalizuara me kabinete, laboratorë dhe pako laboratorike si dhe me bibliotekë të pasuruar<br><br>Së paku 10% e shkollave pajisen me kënde pushuese për nxënës | Lista e shkollave të pajisura me pako laboratorike dhe mjete mësimore, kënde pushuese dhe biblioteka | **40-59 %**<br>Furnizimi me pajisje laboratorike i 16 shkollave në vitin 2022. Furnizimi me pajisje laboratorike i 15 shkollave në vitin 2023 dhe poashtu janë furnizuar 17 shkolla të reja si dhe 11 shkolla ekzistuese me inventar dhe 17 shkolla me inventar për biblioteka. Sfidë është përsëritja e procedurave të kontraktimit. Për këndet pushuese nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe pamundësi kontraktimi si dhe mungojnë të dhënat se sa shkolla kanë kënde pushuese. Është e nevojshme |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| bibliotekave | | | | | | | | të bëhet një analizë e nevojave dhe rritja e buxhetit. |
| 2.4.5. Krijimi i hapësirave të përshtatshme për personelin mësimor (kënde të punës, materiale konkretizuese, pajisje për punë, etj. | TM1/2022-TM4/2026 | 400,000 | 950,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i shkollave të funksionalizuara me hapësira të përshtatshme për personelin mësimor (kënde të punës, materiale konkretizuese, pajisje për punë, etj. | Raportimet e inspektoratit | **0-19 %**<br>Janë identifikuar shkollat me hapësira për biblioteka për arsimtar dhe është në proces përgaditja për furnizime të bibliotekave me inventar dhe literaturë pas lidhjes së kontratës nga AQP. Sfidë lloji i inventarit me kontrata të AQP-së për furnizim të shkollave me inventar nuk është i duhur për mësimdhënës. Përdorimi i llojit të inventarit nga kontrata e furnizimit me inventar administrativ. |
| 2.4.6. Ndërtimi i sallave të edukatës fizike për zhvillim fizik dhe shëndetësor të nxënësve, si dhe pajisja e tyre me pako sportive | TM1/2022-TM4/2026 | 2,273,000 | 730,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Numri i sallave të edukatës fizike të ndërtuara dhe të pajisura me pako sportive | Raportet vjetore për infrastrukturë/MAS HTI | **60-79 %**<br>Në vitin 2022 janë ndërtuar 4 salla të sportit në shkolla. Në vitin 2023 janë ndërtuar 3 salla të sportit në shkolla dhe vazhdon ndërtimi i 11 sallave tjera të sportit. Janë furnizuar me pako sportive 17 salla të sportit në shkolla. Sfidë sigurimi i projekt-dizajneve dhe lejeve të ndërtimit nga komunat që parashtrojnë kërkesa. |
| 2.4.7. Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe sanitarisë në shkolla. | TM1/2022-TM4/2026 | 10,000 | 10,000 | / | MASHTI | Numri i shkollave në të cilat është bërë përmirësimi i cilësisë së ujit dhe sanitarisë në shkolla | Raportet nga inspektorati për sanitari | **20-39 %**<br>Nga IKSHPK raportojnë se qendra e ujit ka raport vjetor për cilësinë e ujit nga sistemet qendrore të furnizimit në nivel vendi ku si pika të mostrimit janë edhe shkollat e kyçura në sisteme qendrore, ndërsa nuk hartohen raporte të posaçme për shkolla.<br>IKSHPK ne vitin 2020 ka hartuar studimin "Kushtet mikroklimatike në ambientet shkollore dhe ndikimi në shëndetin e nxënësve dhe cilësia e ujit të pijshëm në komunën e Prishtinës , Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Në vitin 2022 është bërë hulumtimi "Uji, Sanitacioni dhe Higjiena në shkollat e Kosovës". Ky studim ka dhënë 8 rekomandimeve (https://niph-rks.org/ëp-content/uploads/2021/03/Kushtet-mikroklimatike-ne-ambientet-shkollore-2.pdf) |
| 2.4.9. Hartimi dhe zbatimi i planit ndërsektorial për shkollat promovuese të shëndetit | TM1-TM4/ 2023 | - | 6,320 | / | MASHTI DKA | Plani i veprimit ndër-sektorial për promovim të shëndetit i zhvilluar dhe i zbatuar<br><br>Grupet e themeluara në nivel të komunës dhe shkollës për promovim të shëndetit, dhe raporte nga takimet dhe aktivitetet e mbajtura. | Plani i miratuar<br><br>Raportet nga takimet dhe aktivitetet e mbajtura | **40-59 %**<br>Është draftuar plani i veprimit për shkollat e shëndetshme, janë mbajtur tre punëtori me aktorët multisektorialë. Sfidë akoma mbetet funksionalizimi i grupeve multisektoriale në mungesë të bazës ligjore apo ndonjë udhëzimi administrativ për funksionalizimin e tyre. Gjithashtu, finalizimi i planit multisektorial dhe mundësia e hartimit të udhëzimit administrativ për formimin e mekanizmave koordinues në nivel komune. |
| 2.4.10. Sigurimi i shujtave falas për të gjithë nxënësit e klasave 1-5 | TM3/2022-TM4/2026 | 5,207,000 | 11,500,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | Raporte nga organizimi i shujtave falas për nxënësit e klasave 1-5 | Raportet mbi organizimin e shujtave | **20-39 %**<br>Granti është ndarë me komuna, por vetëm pak komuna (2-3) e implementojnë. Buxheti i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.11. Zbatimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit | TM1/2022-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI DKA | Numri i rasteve të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla<br><br>Monitorimi i zbatimit të sistemit për identifikimin dhe parandalimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit dhe reagimit ndaj këtyre në shkolla | Raportet vjetore të institucioneve arsimore | **60-79 %**<br>Në përpjekje për të rritur përkushtimin në zbatimin e politikave për mbrojtje të fëmijës dhe parandalimin e dhunës në shkolla (protokollin, materialet didaktike, raportimin etj.). U zhvilluan infografet për zbatimin e protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla. U zhvilluan doracakë për DKA dhe Inspektorë, në lidhje me zbatimin e politikave për mbrojtje të fëmijës. U prezantuan politikat kundër dhunës në forume diskutimi në nivel komunash e shkollash (6 tryeza në komunat: Klinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë). U bë marrëveshje bashkëpunimi me Departamentin e Psikologjisë dhe Institutin e Psikologjisë në UP për të ndihmuar forcimin e shërbimeve përkrahëse dhe aktiviteteve që i bëjnë shkollat më të sigurta e më nxitëse për mirëqenie.<br>U zhvillua dhe u finalizua pakoja me module tematike për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në rolin e sektorit arsimor në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës. Janë finalizuar informatorët për shkolla (për parandalim të trafikimit dhe për zbatimin e Konventës së Stambollit), si dhe janë realizuar aktivitete sensibilizuese dhe mbështetëse për komuna dhe shkolla. U realizuan 9 seanca me koordinatorë të cilësisë nëpër komuna, ashtu që të rritet fokusi në parandalim të dhunës nëpërmjet edukimit cilësor dhe aktiviteteve shtesë në kontekst të institucioneve tona parauniversitare.<br>U themelua dhe funksionon Forumi Nacional Këshilldhënës dhe Mobilizues për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijës, përfshirë përcjelljen e situatës së sigurisë, parandalimit të dhunës, rritjes së mirëqenies dhe zhvillimit të shëndetshëm në institucionet arsimore dhe aftësuese parauniversitare.<br>Sfidat lidhen me rrethanat e përgjithshme, prezencën e problemeve ekonomike e sociale, qasjen e lehtë në narkotikë dhe me pamjaftueshmërinë e mbikëqyrjes prindore/familjare, përfshirë mbikëqyrjen dhe llogaridhënien institucionale dhe shërbimet e integruara.<br>Në modulin e incidenteve në SMIA janë raportuar 39 raste në vitin shkollor 2021/22 dhe 45 raste në vitin shkollor 2022/23. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.12. Ndërgjegjësimi i të gjithë akterëve për parandalim dhe referim të të gjitha formave të dhunës dhe dukurive negative të identifikuara nga shkolla | TM1/2023-TM4/2026 | - | 20,000 | Donatorët | MASHTI DKA | Organizimi i ngjarjeve promovuese dhe informuese për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijës, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore | Raporte nga fushatat promovuese/ | **80-100 %**<br>MASHTI zhvilloi dhe realizoi fushatën njëmujore kundër dhunës në shkolla me moton "Së bashku për shkollën miqësore". Gjatë kësaj fushate, sipas programit të fushatës, u lansua videoja promovuese, u realizuan emisione televizive dhe u mbajtën 9 seanca me koordinatorë të cilësisë nëpër komuna për të rritur fokusin në parandalimin e dhunës nëpërmjet edukimit cilësor dhe aktiviteteve shtesë në kontekst të institucioneve tona parauniversitare. U mbajtën gjithashtu ligjërata nga UP (Katedra e Psikologjisë dhe Fakulteti i Edukimit), seanca diskutimi me nxënës nga stafi i MASHTI dhe u kërkua koordinimi dhe bashkëveprimi me komunitetin e prindërve në të mirë të mirëqenies së nxënësve dhe arritjeve mësimore të tyre.<br>MASHTI realizoi fushatën kundër trafikimit me njerëz në 2022 dhe 2023 me aktivitete të shumta shkollore, sipas sugjerimeve nga MASHTI. Gjithashtu, realizoi sesione informuese në Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Gjakovë, Deçan, Kamenicë dhe Gjilan, si dhe aktivitete në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje. Në vitin 2022, MASHTI dhe MD realizuan aktivitete në shkolla të Gjilanit, Kamenicës dhe Fushë Kosovës.<br>MASHTI përkrahu 15 komuna për të zbatuar politikat për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes, dhe po zhvillon dokumentin për politikën e mbrojtjes së fëmijës që t'u përcillet pastaj çdo shkolle. U zhvillua dhe u finalizua pakoja me module tematike për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në rolin e sektorit arsimor në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, ku adresohen edhe aspekte gjinore. U finalizua informatori për zbatim të Konventës së Stambollit dhe versioni në tri gjuhë është vendosur në ëeb-faqe. Gjithashtu, u zhvillua dhe u finalizua doracaku për parandalim të trafikimit me njerëz. MASHTI hartoi, aprovoi dhe lansoi pakon e moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës. U finalizua dhe u promovua Udhëzuesi mësimdhënës lidhur me parandalimin e trafikimit me njerëz. Përfaqësues nga MASHTI kanë marrë pjesë aktive në punëtoritë e organizuara nga ZKM - ZQM lidhur me zbatimin e Konventës për të drejtat e fëmijës dhe në vazhdimësi janë përgatitur informacionet e detajuara sipas kërkesave.<br>Në këtë periudhë janë realizuar punëtoritë për finalizimin e Politikës për mbrojtjen e fëmijës në institucionet e arsimit parauniversitar. Politika u lansua dhe u përkthye në gjuhët serbe, boshnjake, turke dhe angleze. Dokumenti i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës përmban zotimin dhe përkushtimin e institucionit për mbrojtjen e fëmijës sipas Konventës për të drejtat e Fëmijës, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijës. U realizua Konferenca e Forumit nacional për shkolla miqësore, ku MASHTI promovoi të gjitha dokumentet e zhvilluara në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Ishim pjesë e takimeve në komuna në kuadër të fushatës nacionale për promovimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës. U realizuan 8 aktivitete me shkolla në komunat: |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Prizren, në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj gruas dhe asaj me bazë gjinore. U realizuan seanca ndërgjegjësuese me nxënës në kuadër të fushatës kundër trafikimit me njerëz (Prizren, Gjilan, Ferizaj) dhe seanca për parandalimin e martesave të hershme, me ç'rast u promovua pakoja e moduleve tematike dhe moduli për parandalimin e martesave të hershme. |

| 2.5. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Rritje e besueshmërisë së rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për politikëbërje, krahas rezultateve të testeve ndërkombëtare** | **Shkalla e zbatimit të masave të ndërmarra për të siguruar besueshmërinë e rezultateve të vlerësimeve kombëtare (kl.9 dhe 12)** | **NA** | **60%** | **Raportet e monitorimit dhe vlerësimit** |
| | **Rezultatet nga vlerësimi ndërkombëtar PISA** | **PISA 2018<br>Lexim: 353,1<br>Matematikë: 365,9<br>Shkencë: 364,9** | **2%<br>Lexim: 361<br>Matematikë: 373<br>Shkencë: 372** | **Raportet e analizave të vlerësimeve ndërkombëtare (PISA)** |
| | **Përqindja e kërkesave në vlerësimet kombëtare të bazuara në kompetenca** | **20%** | **50%** | **Raportet nga MASHTI/Divizioni për Vlerësim dhe Standarde** |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 2.5.1. Krijimi i Qendrës për Vlerësim dhe Standarde | TM1/2023-TM4/2026 | - | 29,972 | / | MASHTI | Qendra për Vlerësim dhe Standarde është themeluar dhe është funksionale<br><br>Ngritja e kapaciteteve të stafit të Qendrës për Vlerësim dhe Standarde | Vendimet e themelimit<br><br>Vendimet për angazhimin e stafit | **0-19 %**<br>Qendra nuk është themeluar ende. Është paraparë një organogram i ri i cili është në proces të miratimit. Sidoqoftë, ka vonesa në miratimin e organogramit të ri të MASHTI-t. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.5.2. Avancimi i udhëzuesve për administrim të provim të maturës dhe testit të arritshmërisë | TM1/2023-TM4/2026 | - | - | / | MASHTI | Raportet e monitorimit të administrimit të provimit të maturës dhe testit të arritshmërisë | Raportet nga monitorimi i vlerësimeve | **40-59 %** Në vitin 2023 janë rishikuar dhe avancuar udhëzuesit për administrimin e provimit të maturës. Gjithashtu, është finalizuar Ligji i ri i maturës shtetërore dhe është dërguar në Qeveri për miratim. |
| 2.5.3. Krijimi i bankës së kërkesave (pyetjeve dhe detyrave) të bazuara në kurrikulë | TM1-TM4/ 2023 | - | 29,280 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Numri i kërkesave (pyetjeve dhe detyrave) të bazuara në kurrikulë të vendosura në bankën e pyetjeve | Banka e kërkesave | **0-19 %** Edhe pse është rritur përqindja e kërkesave të bazuara në kompetenca, mungon një bankë e mirëfilltë e kërkesave. Gjithashtu, mungon aplikacioni. |
| 2.5.4. Pjesëmarrja e Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare PISA (fëmijët 15 vjeçarë), TIMSS dhe PIRLS (klasa IV), ICILS (klasa VIII) | TM3/2022-TM4/2026 | 191,167 | 204,667 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Raportet nga vlerësimet ndërkombëtare PISA, TIMSS, PIRLS dhe ICILS | Raportet e publikuara nga vlerësimet ndërkombëtare: PISA, TIMSS, PIRLS dhe ICILS | **60-79 %** Janë mbajtur testi ndërkombëtar ICILS (në të cilin kanë marrë pjesë 3800 nxënës) dhe testi ndërkombëtar TIMMS (në të cilin kanë marrë pjesë 4500 nxënës). Tani jemi në fazën e futjes së të dhënave në International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA). Të dhënat lidhur me testet ICILS (vlerësimi i nxënësve të klasës 8 për përdorim të TIK) dhe TIMMS janë futur në databazën e International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA) dhe tani është në proces kodimi i pyetjeve të këtyre testeve. Ka përfunduar kodimi i pyetjeve për testet ICILS dhe TIMMS dhe tani jemi në fazën e verifikimit të të dhënave për nxënës. Gjithashtu, janë publikuar rezultatet e testit ndërkombëtar PISA 2022. Sfida mbetet shfrytëzimi i rezultateve për përmirësimin e cilësisë në arsim dhe furnizimi i shkollave me kompjuterë, pajisje digjitale dhe internet. |
| 2.5.5. Analiza e rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim të krijimit të evidencës për vendimmarrje (debate, punëtori, konferenca, etj.) | TM3/2023-TM4/2026 | - | 18,770 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Raportet dhe analizat nga testet kombëtare dhe ndërkombëtare merren parasysh për vendimmarrje (punëtori, konferenca ku diskutohen rezultatet dhe jepen rekomandime) | Raportet nga organizimi i eventeve | **40-59 %** Janë mbajtur takime dhe punëtori me palët e interesit për testin PISA. Gjithashtu, janë hartuar raporte për vlerësimin PIRLS dhe PISA. Senzibilizimi i aktorëve relevantë për vlerësimet ndërkombëtare është rritur. Rekomandohet organizimi i takimeve me drejtorë shkollash dhe me mësimdhënës, ku do të diskutoheshin faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e këtyre testeve. |

| 2.6. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Zbatimi efektiv i të gjitha elementeve të kurrikulës së arsimit parauniversitar** | **Përqindja e komunave që kanë angazhuar 3-4 mësimdhënës në pozitat zyrtarë për kurrikula/ këshilltarë** | **NA** | **40%** | **Lista e zyrtarëve për kurrikula/këshilltarë pedagogjik në DKA nga databaza përkatëse** |
| | **Përqindja e kurrikulave lëndore për klasë të rishikuara bazuar në vendimet për rishikim** | **NA** | **50%** | **Vendimet për rishikim të kurrikulave. Raportet nga MASHTI/ Divizioni për kurrikula** |
| | **Numri i mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, zyrtarëve arsimore në komuna dhe MASHTI, të përfshirë në trajnime shtesë dhe forma tjera të mbështetjes për zbatimin e reformës së kurrikulës** | **NA** | **Pjesëmarrja në trajnime shtesë dhe forma tjera të mbështetjes për zbatimin e reformës së kurrikulës:**<br>**Mësimdhënës/udhëheqës të AP - 40%**<br>**Drejtorë/zv. drejtorë të shkollave -50%**<br>**Zyrtarë arsimor në DKA -50%**<br>**Zyrtarë arsimor në MASHTI -80%** | **Të dhënat nga MASHTI/ Divizioni për kurrikula, Divizioni për ZHPM dhe nga Drejtoritë Komunale të Arsimit** |

DRAFT

| | Raportet e monitorimit të zbatimit të kurrikulës pasqyrojnë trend pozitiv të zbatimit të të gjitha elementeve të kurrikulës së bazuar në kompetenca. | | NA | | 50% | | Raportet vjetore të MASHTI-it dhe DKA-ve për monitorimin e zbatimit të kurrikulës. | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | **Progresi në zbatim 2022-2023** |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 2.6.1. Rishikimi dhe plotësimi i infrastrukturës ligjore për të mundësuar zbatimin efektiv të kurrikulës | TM3-TM4/2022 TM1-TM2/2023 | 1,920 | 2,320 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë UA, vendime për të mundësuar zbatimin efektiv të kurrikulës | UA dhe vendimet e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI | **20-39 %**<br>Është hartuar dhe miratuar Udhëzimi Administrativ për mësimin me zgjedhje. Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të vitit 2011, Divizioni për planprogramet dhe tekste shkollore duhet të kthehet në Agjenci për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim; megjithatë, kjo ende nuk është bërë. |
| 2.6.2. Forcimi i kapaciteteve njerëzore në nivel të DKA-ve për mbështetjen e shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës zyrtarë/këshilltarë pedagogjik në lëndët prioritare - Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat, sipas numrit të nxënësve | TM3/2022-TM1/2023<br>TM3/ 2023 - TM4 2026 | 5,920 | 42,160 | Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA | 80% e komunave kanë angazhuar 3-4 zyrtarë për kurrikula në DKA/këshilltarë pedagogjik nga stafi mësimdhënës. | Lista e zyrtarëve për kurrikula në DKA nga databaza përkatëse | **20-39 %**<br>Janë mbajtur disa takime të grupit punues për hartimin e dokumenteve për ngritjen e kapaciteteve në komuna. Sfida është mungesa e bazës ligjore për zyrtarizimin e një pozite të tillë. Në disa komuna janë angazhuar zyrtarë të arsimit si koordinatorë për zbatimin e kurrikulës së re. |
| 2.6.3. Rishikimi i kurrikulave bazuar në analizën e gjendjes së zbatimit të tyre dhe kahet e zhvillimit në fushat përkatëse (si p.sh. zhvillimet e shpejta në fushën kurrikulare Jeta dhe puna, përkatësisht kurrikulën lëndore të TIK-ut) | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 40,880 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Kurrikulat/programet lëndore për klasë të rishikuara dhe të aprovuara nga MASHTI, bazuar në analizën e gjendjes së zbatimit të tyre dhe vendimet për rishikim. | Kurrikulat/program et lëndore për klasë të publikuara nga MASHTI | **0-19 %**<br>Është bërë rishikimi i teksteve shkollore nga KOSED (janë angazhuar ekspertët nga Instituti Pedagogjik i Kosovës) për klasat 1-9 për fushat: gjuhë dhe komunikim, matematikë dhe shkenca të natyrës. Është bërë shpërndarja e pyetësorëve për të marrë rekomandimet nga mësimdhënësit për të gjitha tekstet shkollore për klasat 1-12. Mos përfshirja e Divizionit të Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore në procesin e rishikimit nga OJQ dhe Këshilli i Evropës është një sfidë. Përgjegjësia për rishikimin e teksteve shkollore duhet të bartet tek divizioni përkatës. Janë marrë idetë dhe sugjerimet nga shkollat për rishikimin e kurrikulës për fushën "Jeta dhe puna" dhe tani jemi në fazën e përpunimit të tyre. Janë përpunuar të dhënat e marra nga shkollat për rishikimin e kurrikulës për fushën "Jeta dhe puna" dhe jemi në pritje të vendimit për sigurimin e pagesës së ekspertëve të jashtëm që parashihen të angazhohen për hartimin e këtij programi (profesorë universiteti dhe mësimdhënës). Kjo nuk është realizuar për shkak të mungesës së bazës ligjore për angazhimin e ekspertëve të jashtëm me pagesë. |
| 2.6.4. Organizimi i konferencave, festivaleve me mësimdhënës për çështje të arsimit, reformës dhe zbatimit | TM3/ 2022 - TM4 TM4 2026 | 30,000 | 40,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Janë organizuar së paku pesë takime me mësimdhënës për çështje të arsimit, reformës dhe zbatimit të kurrikulës. | Raportet nga organizimi i tryezave, konferencave, | **40-59 %**<br>Janë organizuar debate dhe një konferencë për raportin mbi rishikimin e teksteve. Nuk është realizuar për shkak të mungesës së bazës ligjore për angazhimin e ekspertëve të jashtëm me pagesë. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| të kurrikulës | | | | | | | | |
| 2.6.5. Mbështetje e vazhdueshme për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave për zbatimin e kurrikulës (me theks të veçantë në aspektet e mësimdhënies së avancuar dhe në fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat dhe çështjet ndërkurrikulare dhe lëndore) | TM2/ 2023 - TM2/ 2026 | - | 40,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA IPK | Ekzistojnë udhëzues praktik të rishikuar/hartuar për zbatimin e kurrikulës, për secilin nivel të APU, të qasshëm për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave. Ekzistojnë programe të trajnimit, mentorimit dhe forma të tjera të mbështetjes për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave, të zhvilluara, miratuara dhe që ofrohen në vazhdimësi. Numri i mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave të përfshirë në trajnime dhe forma të mbështetjes për zbatimin e kurrikulës. | Udhëzuesit e publikuar. Katalogu i programeve të trajnimit. Raportet vjetore për trajnimet dhe format tjera të mbështetjes për zbatimin e kurrikulës. | **40-59 %** 600 mësimdhënës të rinj janë trajnuar për kurrikulën nga trajnerët në DKA. Gjatë vitit 2024, thirrja për programe trajnimi u vonua deri në dhjetor, dhe si rezultat, numri i trajnimeve të akredituara në terren ishte i vogël. |
| 2.6.6. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të kurrikulës, në nivel institucioni arsimor, në nivel lokal dhe qendror, si dhe realizimit i studimit ndërkombëtar me qëllim vlerësimin e zbatimit të gjitha elementeve të kurrikulës. | TM3/2022 - TM4/ 2026<br><br>Studimi ndërkombëtar në vitin 2023 | - | - | Buxheti i Kosovës | MASHTI Inspektorati i Arsimit DKA | Ekzistojnë raportet vjetore të monitorimeve për zbatimin e kurrikulës - në nivel të institucionit arsimor, në nivel lokal dhe qendror.<br><br>Ekziston raporti nga studimi ndërkombëtar. | Raportet vjetore për monitorimin e zbatimit të kurrikulës të publikuara në faqet zyrtare të komunave/DKA | **40-59 %** Janë hartuar raporte për vlerësimin e jashtëm të performancës së 28 shkollave, si dhe për vlerësimin e performancës së 143 drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Këto raporte u janë dërguar shkollave dhe DKA-ve përkatëse. Sfidë mbetet mungesa e trajnimit adekuat për zbatimin e kurrikulës për mësimdhënësit e angazhuar në procesin mësimor nga viti 2020 e tutje, si dhe njohja e pamjaftueshme e kurrikulës nga grupe të margjinalizuara mësimdhënësish. |
| 2.6.7. Definimi i vlerësimit të kompetencave për shkallë kurrikulare | TM1- TM2/2023 | - | 11,994 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Dokumenti i aprovuar për vlerësimin e kompetencave për shkallë kurrikulare | Dokumenti i aprovuar për vlerësimin e kompetencave për shkallë kurrikulare i publikuar në faqen e MASHTI | **0-19 %** Nuk ka pasur progres për shkak të mungesës së bazës ligjore për angazhimin e ekspertëve me pagesë. |
| 2.6.8. Aftësimi i mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve me bazë kompetencat dhe përdorimin e rezultateve në aktivitete përkrahëse për nxënës | TM1 - TM3 2023<br><br>TM3 - 2023 deri në TM4 - 2026 | - | 36,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Programi i trajnimit dhe udhëzuesi për mësimdhënës lidhur me vlerësimin e nxënësve me bazë kompetencat dhe përdorimin e rezultateve në aktivitete përkrahëse për nxënës.<br><br>Rreth 2000 mësimdhënës janë përfshirë në trajnime dhe forma tjera të përkrahjes për përmirësimin e praktikave të vlerësimit të nxënësve | Katalogu i programeve të aprovuara për ZHPM dhe udhëheqësve të arsimit.<br><br>Lista e mësimdhënësve të trajnuar nga databaza përkatëse. | **20-39 %** Janë akredituar 6 programe për vlerësim të nxënësve dhe janë trajnuar 140 mësimdhënës. Ekziston një udhëzues i vjetër i GIZ, por nuk është bërë ndonjë rishikim. Kërkesat dhe vendimet për angazhimin e ekspertëve ende nuk janë aprovuar. MASHTI ka aprovuar programin e trajnimit për vlerësimin e nxënësve, por nuk është realizuar trajnimi për aftësimin e mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve, bazuar në kompetencat dhe rezultatet e lëndës, për shkak të mungesës së fondeve (projekteve mbështetëse). |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.6.9. Zhvillimi dhe ofrimi i programeve dhe formave plotësuese për mbështetjen e nxënësve që nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënit ( me theks të veçantë në: Gjuhë shqipe/amtare, Matematikë, Shkenca) | TM3 2022 - TM4 2026 | 7,650 | 48,600 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Programi i trajnimit dhe udhëzuesi për shkollat lidhur me mbështetjen e nxënësve me qëllim kompensimin e humbjeve në mësime të shkaktuara nga pandemia.<br><br>Rreth 800 mësimdhënës janë përfshirë në trajnime për mbështetjen e nxënësve me qëllim kompensimin e humbjeve në mësime të shkaktuara nga pandemia. | Katalogu i programeve të aprovuara për ZHPM dhe udhëheqësve të arsimit<br><br>Lista e mësimdhënësve të trajnuar | **0-19 %**<br>Nuk është realizuar për shkak të mungesës së bazës ligjore për angazhimin e ekspertëve të jashtëm me pagesë |
| 2.6.10. Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të veçanta obligative për përmirësimin e aftësive të<br>nxënësve në lexim-shkrim. | TM/3-TM4/ - 2022 | 6,500 | 30,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston udhëzuesi mbështetës për shkollat lidhur me ofrimin në nivel shkolle të programeve për përmirësimin e aftësive të nxënësve në lexim-shkrim | Udhëzuesi i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **0-19 %**<br>Nuk është realizuar për shkak të mungesës së bazës ligjore për angazhimin e ekspertëve të jashtëm me pagesë |
| 2.6.11. Zhvillimi dhe ofrimi i udhëzuesve dhe programeve ndihmëse për prindër në përmbushjen e rolit të tyre për përkrahjen e fëmijëve në arritjen e rezultateve të të nxënit. | TM1 - TM2 2023<br><br>TM1 2022 - TM4 2026 | - | 18,760 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë udhëzues dhe programe ndihmëse për prindër lidhur me përkrahjen e fëmijëve në mësime.<br><br>Të paktën dy takime online me prindër janë mbajtur në secilën komunë rajonale, për qëllime të ndarjes së udhëzimeve lidhur me përkrahjen e fëmijëve në mësim. | Udhëzuesit dhe materialet informative për prindër të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI<br>Raportet nga takimet online me prindër | **20-39 %**<br>Eshte aprovuar 1 program trajnimi për bashkëpunimin me prindër. |
| 2.6.12. Mbështetja e zbatimit të praktikave të mira për edukim, këshillim dhe orientim në karrierë. | TM1 -TM2/ 2023<br><br>TM2 - 2023 - TM4 2026 | - | 19,220 | Donatorët | MASHTI | Ekzistojnë udhëzues për këshillim dhe orientim në karrierë .<br><br>1,200 mësimdhënës të shkollave të aftësuar për këshillim dhe orientim në karrierë. | Udhëzuesit e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI- it.<br><br>Lista e mësimdhënësve të trajnuar | **80-100 %**<br>Është hartuar Udhëzimi Administrativ për këshilltarë të karrierës. Janë ndarë 59 pozita në grantin specifik për këshilltarë të karrierës për nivelin e arsimit të mesëm të ulët. Janë organizuar dhe realizuar aktivitete për orientimin në karrierë të nxënësve të klasave të IX-ta (Javën e dyerve të hapura). Ky aktivitet është zhvilluar në bashkëpunim me DKA, në të gjitha shkollat e mesme të ulëta. Është organizuar "Java e informimit në gjimnaze për orientim në karrierë" - Java është realizuar në të gjitha gjimnazet e Republikës së Kosovës. MASHTI ka përgatitur postera dhe i ka shpërndarë nëpër shkolla, ku nxënësit u informuan për mundësitë ekzistuese për orientim në arsimin e lartë. |

| **2.7. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
|---|---|---|---|---|
| **Sigurimi i teksteve shkollore cilësore, burimeve, mjeteve e materialeve mësimore në harmoni me kurrikulën dhe** | **Hartohen dhe zbatohen dokumentet e planifikuara për rregullimin ligjor në bazë të Ligjit të ri për tekstet shkollore, burimet, materialet dhe mjetet mësimore.** | **Legjislacioni primar në proces të rishikimit** | **Aprovohet legjislacioni sekondar dhe të gjitha dokumentet e planifikuara për rregullimin ligjor në bazë të Ligjit të ri për tekstet shkollore, burimet, materialet dhe mjetet mësimore** | **Të dhënat nga faqja zyrtare MASHTI / Dokumente dhe publikime/ Raportet periodike** |

DRAFT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **standardet përkatëse** | **Tekstet shkollore dhe materialet mësimore të zhvilluara, rishikuara apo adaptuara në bazë të legjislacionit të ri, janë në harmoni me kurikulën dhe janë të rishikuara përfshirë aspektin e eliminimit të stereotipeve gjinore** | **NA** | **70%** | **Raportet periodike për cilësinë e teksteve dhe materialeve mësimore sipas niveleve të APU.** | |
| | **Përqindja e plotësimit të nevojave me tekste shkollore dhe materiale ndihmëse për kategoritë e ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për lëndët e gjuhëve të huaja.** | **NA** | **50%** | **Katalogu për tekste shkollore dhe materialeve mësimore i publikuar - sipas viteve shkollore.** | |
| | **Mbi 60% e shkollave janë të pajisura me pakon e mjeteve dhe materialeve mësimore sipas fushave kurrikulare.** | **NA** | **30%** | **Raportet vjetore për pajisjen e shkollave me pakon e mjeteve dhe materialeve mësimore sipas fushave kurrikulare**<br>**Lista e shkollave përfituese** | |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 2.7.1. Kompletimi i kuadrit institucional dhe ligjor për tekstet shkollore, burimet, materialet dhe mjetet mësimore | TM3-TM4/2022<br>TM1-TM4/2023 | 11,320 | 11,320 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Kuadri institucional dhe ligjor i kompletuar sipas dispozitave të Ligjit për tekstet shkollore, burimet, materialet dhe mjetet mësimore | UA dhe vendimet e miratuara dhe publikuara në faqen zyrtare të MASHTI | **20-39 %**<br>Është hartuar Ligji për tekste mesimore dhe ndodhet në Qeveri për miratim. |
| 2.7.2. Hartimi dhe rishikimi i teksteve shkollore, prodhimi i materialeve mësimore (fizike dhe digjitale), në harmoni me kërkesat e kurrikulës dhe me standardet përkatëse, përfshirë nga perspektiva gjinore | TM3/ 2022 - TM4 2026 | 70,000 | 70,000 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI | Konkurset e përgatitura sipas planit dinamik për hartimin/rishikimin e teksteve shkollore dhe të publikuar në faqen zyrtare të MASHTI.<br><br>Ekzistojnë tekstet shkollore dhe materialet mësimore për të gjitha klasat dhe kurrikulat lëndore, në harmoni me kërkesat e kurrikulës dhe me standardet përkatëse | Konkurset e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI.<br><br>Katalogu për tekste shkollore dhe materialeve mësimore të miratuara sipas viteve shkollore.<br><br>Lista e teksteve shkollore të botuara | **40-59 %**<br>Është bërë rishikimi i teksteve shkollore nga KOSED (janë angazhuar ekspertët nga Instituti Pedagogjik i Kosovës) për klasat 1-9 në fushat: gjuhë dhe komunikim, matematikë dhe shkencat e natyrës. Është bërë shpërndarja e pyetësoreve për të marrë rekomandimet nga mësimdhënësit për të gjitha tekstet shkollore për klasat 1-12. Sfida është mos përfshirja e Divizionit të Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore në procesin e rishikimit nga OJQ dhe Këshilli i Evropës. Duhet që përgjegjësia për rishikimin e teksteve shkollore të bartet tek divizioni përkatës. |
| 2.7.3. Hartimi, rishikimi, përkthimi, përshtatja e teksteve shkollore si dhe prodhimi i materialeve mësimore (fizike dhe digjitale) për kategoritë e ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta, nxënës të diasporës dhe për lëndët e gjuhëve të huaja (në harmoni me kërkesat e kurrikulës dhe me standardet përkatëse.) | TM3/ 2022 - TM4 2026 | 20,000 | 20,000 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI | Konkurset e përgatitura sipas planit dinamik të MASHTI.<br><br>Ekzistojnë tekstet shkollore dhe materialet mësimore për kategoritë e ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për lëndët e gjuhëve të huaja | Konkurset e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI.<br><br>Katalogu për tekste shkollore dhe materialeve mësimore të miratuara sipas viteve shkollore. | **40-59 %**<br>Janë shpërndarë falas të gjitha tekstet e reja në shkolla për klasat 1-9. Janë vlerësuar përshtatshmëritë e teksteve të gjuhës angleze për klasat 1-12 dhe për parafillorë si tekste alternative nga ana e komisionit të caktuar me vendim të ministres.<br><br>Është bërë botimi dhe shpërndarja e teksteve për nxënësit e diasporës për gjuhën dhe kulturën shqiptare për nivelin e parë. Nuk është zhvilluar konkurs për nxënës me nevoja të veçanta. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.7.4. Sigurimi i materialeve profesionale dhe didaktike për mësimdhënës, përfshirë materialet për mësimdhënës të gjuhëve të huaja dhe që punojnë me nxënës me nevoja të veçanta dhe nxënës të diasporës, aftësimi i mësimdhënësve për përdorimin e tyre dhe për zhvillimin e materialeve mësimore (fizike dhe digjitale), | TM1 -TM3/ 2023<br><br>TM3 - 2023 - TM4 2026 | 10,000 | 35,120 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Ekzistojnë materiale profesionale dhe didaktike për mësimdhënës sipas niveleve të arsimit, nxënësve me nevoja të veçanta dhe gjuhëve të huaja, të zhvilluara nën koordinimin e Divizionit për kurrikula në MASHTI.<br><br>Rreth 900 mësimdhënës nga shkolla të ndryshme janë aftësuar për zhvillimin dhe përdorimin e materialeve mësimore. | Materialet profesionale dhe didaktike për mësimdhënës të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI- it.<br><br>Lista e mësimdhënësve të trajnuar | **0-19 %**<br>Në mungesë të bazës ligjore për pagesë të ekspertëve të jashtëm, nuk ka pasur mundësi të zhvillohet aktiviteti. |
| 2.7.5. Organizimi i debateve në nivel të gjerë shoqëror e akademik për llojin e teksteve dhe materialeve mësimore në frymën e kurrikulës së bazuar në kompetenca. | TM3/ 2022 - TM3/2023 | 3,000 | 6,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Janë organizuar së paku dy-tri tryeza, debate, simpoziume me pjesëmarrje nga komuniteti arsimor dhe akademik për llojin e teksteve dhe materialeve mësimore. | Raportet nga organizimi i ngjarjeve të ndryshme për llojin e teksteve she materialeve mësimore. | **20-39 %**<br>Jane organizuar takime dhe një konferencë për studimin që është bërë për rishikimin e tekstve mësimore. |
| 2.7.6. Promovimi i ngjarjeve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, me prodhues te materialeve mësimore fizike e digjitale dhe sigurimi i buxhetit për blerjen e produkteve dhe trajnimin e mësimdhënësve për përdorimin e tyre. | TM 1/2023 - TM4/2026 | 1,500 | 1,500 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Ekzistojnë materiale promovuese/informuese për ngjarjet me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, me prodhues te materialeve mësimore fizike e digjitale.<br><br>Rreth 10% e shkollave përfitojnë produkte të materialeve mësimore dhe trajnime të mësimdhënësve nga aktivitetet e promovimit të ngjarjeve me prodhues të materialeve mësimore fizike e digjitale. | Materialet promovuese/inform uese të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI-t<br><br>Lista e shkollave përfituese | **N/A**<br>Ekzistojnë iniciativa për zgjerim të bashkëpunimit me fakultetet tjera të edukimit nga rajoni dhe bota, përderisa është identifikuar mungesa e mbështetjes financiare dhe aftësitë në gjuhë angleze. |
| 2.7.7. Përcaktimi i përmbajtjes minimale të pakos me mjete dhe materiale mësimore për zbatimin e kurrikulës | TM1-TM3/2023 | 7,650 | - | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Standardi i përmbajtjes së pakos me mjete dhe materiale mësimore sipas fushave kurrikulare i aprovuar në formë të UA. | UA i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **0-19 %**<br>Ekzistojnë udhëzues për 7 fusha kurrikulare, por ato nuk janë të mjaftueshme. |
| 2.7.8. Pajisja e shkollave me pako të mjeteve dhe materialeve mësimore për zbatimin e kurrikulës, udhëzues dhe trajnime për përdorimin e tyre. | TM/2-3 /2023 - TM2-3/ 2026 | 30,000 | 30,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Mbi 60% e shkollave që janë të pajisur me pakon e mjeteve dhe materialeve mësimore sipas fushave kurrikulare, janë mbështetur me udhëzues dhe trajnime për përdorimin e tyre. | Lista e shkollave të pajisura me pakon e mjeteve dhe materialeve mësimore sipas fushave kurrikulare. | **20-39 %**<br>MASHTI ka ndarë buxhet për mjete mësimore falas për nxënësit e klasave 6-9 (30 euro për nxënës). |

| 2.8. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Zbatimi i plotë i sistemit të licencimit të mësimdhënësve dhe shtimi i mundësive për zhvillim dhe avancim** | **Kuadri nënligjor i sistemit të licencimit i rishikuar dhe avancuar.** | **Ekziston kuadri nënligjor, por disa komponente të tij nuk zbatohen** | **Kuadri nënligjor i sistemit të licencimit i është kompletuar dhe ka filluar zbatimi i të gjitha komponentëve të tij.** | **Të dhënat nga faqja zyrtare MASHTI / Dokumente dhe publikime për sistemin e licencimit të mësimdhënësve** |

DRAFT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **profesional të mësimdhënësve bazuar në standardet e mësimdhënies** | **Përqindja e mësimdhënësve që marrin pjesë çdo vit në programe të zhvillimit profesional, e ndarë në baza gjinore** | **25 % (2019/2020)** | **35%** | **Raportet dhe statistikat periodike për ZHPM nga MASHTI dhe Komunat - Raportet nga baza e të dhënave të ZHPM** |
| | **Numri i mësimdhënësve që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm të performancës** | **755 mësimdhënës** | **1755 mësimdhënës** | **Raportet dhe statistikat periodike për VPM nga MASHTI/IA** |
| | **Përqindja e mësimdhënësve të vlerësuar që kanë plotësuar në nivel të lartë standardet/kompetencat për mësimdhënës dhe kanë përparuar në nivelet e avancimit në karrierë.** | **NA** | **20%** | **Raportet nga baza e të dhënave të sistemit të licencimit** |
| | **Përqindja e mësimdhënësve fillestar që i ofrohet mentorimi sipas programit hyrës në profesion, e ndarë në baza gjinore** | **NA** | **40%** | **Raportet nga baza e të dhënave të programit hyrës për mësimdhënës fillestar** |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 2.8.1. Realizimi i studimit të shpejtë për zbatimin e sistemit të licencimit dhe i koncept dokumentit për të ardhmen e tij të ndërlidhur me komponenten e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve | TM3-TM4/2022 | 3,600 | - | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Studimi i kryer lidhur me zbatimin e sistemit të licencimit dhe kahet e zhvillimit të sistemit.<br><br>Konceptdokumenti i përgatitur për zbatimin e sistemit të licencimit të ndërlidhur me komponenten e VPM. | Raporti i studimit. Konceptdokumenti i përgatitur dhe miratuar. | **20-39 %**<br>Eshte hartuar dhe miratuar Udhëzues Administrativ për licencimin e mesimdhenësve dhe ngritjen në karrierë në licencë të avancuar (Nr.14/2023, qershor 2023). Sfida është sigurimi i buxhetit për zbatimin e licencës së avancuar, si dhe procedurat për avancim – gradim. Pritet që 1000 mesimdhenës në nivel të Kosovës të gradohen përmes procedurave të parapara në UA. Gjithashtu, nuk është bërë angazhimi i ekspertëve dhe fillimi i punës në studim dhe koncept dokument. |
| 2.8.2. Rishikimi i akteve nënligjore të sistemit të licencimit dhe i kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve | TM3/ 2022 - TM2/2023 | 3,600 | 16,300 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Tri UA për sistemin e licencimit janë rishikuar dhe miratuar.<br>Korniza strategjike për ZHPM është përditësuar dhe miratuar. | Gazeta zyrtare Korniza strategjike për ZHPM e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI | **80-100 %**<br>Janë finalizuar dhe nënshkruar nga Ministrja Udhëzimin Administrativ për Kornizën Strategjike të Lëndëve të Mësimit, UA për Aprovimin e Programeve të Trajnimit, dhe UA për Sistemimin e Licencimit. Duhet të bëhet rishikimi i Kornizës Strategjike. Nevojitet përkatësisht perkrahje dhe bashkëpunim më i frytshëm me Drejtorinë e Këshillimit dhe Akreditimit dhe me ministrat e linjës. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.8.3. Hartimi i aktit nënligjor për financimin e ZHPM dhe ngritja e kapaciteteve për zbatimin e financimit të ZHPM nga komunat. | TM3-TM4/2022<br><br>TM1-TM3/2023 | 4,400 | 5,132 | Buxheti i Kosovës | MASHTI MFPT | Ekziston UA për financimin e ZHPM.<br><br>40 zyrtarë të DKA-ve të trajnuar për zbatimin e financimit të ZHPM. | Gazeta zyrtare.<br><br>Evidencat e trajnimit të zyrtarëve të DKA | **20-39 %**<br>Eshte hartuar dhe miratuar Udhëzues Administrativ për zhvillimin profesional të mesimdhenësve, brenda të cilit Udhëzuesi Administrativ parashihet edhe financimi i zhvillimit profesional të mesimdhenësve. Mirëpo, mungon ende hartimi i aktit nënligjor ose rregullore për financimin e Zhvillimit të Hulumtimeve, Përvojave, dhe Materialeve më Baza në të gjitha shkolla. Puna ka filluar por ka ngecur. Sfidat mbeten procedurat e komplikuara për realizimin e pagesave. |
| 2.8.4. Hartimi i aktit nënligjor për të lidhur sistemin e gradimit të mësimdhënësve me sistemin e pagave. | TM1 - TM2/2023 | - | 4,160 | Buxheti i Kosovës | MASHTI MFPT | Ekziston UA i cili rregullon lidhjen e sistemit të gradimit të mësimdhënësve me sistemin e pagave.<br><br>Licencimi i mësimdhënësve është i lidhur me sistemin e pagave. | Gazeta Zyrtare<br><br>Raportet e sistemit të pagave të mësimdhënësve. | **60-79 %**<br>Eshte hartuar dhe miratuar UA për licencimin e mesimdhenesve dhe ngritjen në karrierë në licencë të avancuar (Nr.14/2023, qershor 2023), i cili rregullon edhe gradimin e mesimdhenesve. Sfidë mbetet sigurimi i përkrahjes financiare për zbatimin e plotë të UA-së. |
| 2.8.5. Hartimi dhe ofrimi i programeve të trajnimit dhe udhëzuesve për mësimdhënës të bazuara në programet prioritare për ZHPM (si psh. programe për mësimdhënie me qasje të individualizuar, qasje të diferencuar; programe për zhvillimin e shkathtësive të buta të nxënësve, punë me fëmijë me aftësi të kufizuara, etj.), standardet për mësimdhënës dhe në harmoni me filozofinë e kurrikulës së bazuar në kompetenca. | TM1/ 2023 - TM2/2026<br><br>TM2 - 2023 deri në TM4 - 2026 | 60,500 | 222,800 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br>Partnerët ofrues të programeve për ZHPM | Së paku 10 programe prioritare për ZHPM janë hartuar, miratuar dhe ofrohen për mësimdhënës.<br><br>Mbi 8000 mësimdhënës janë trajnuar në programet prioritare për ZHPM. | Vendimet/ miratimet e KSHLM<br>Për programet e trajnimit.<br><br>Katalogu i trajnimeve i publikuar. Raportet për përfshirjen e mësimdhënësve në trajnime, në baza vjetore dhe sipas niveleve të arsimit, përfshirë AAP. | **80-100 %**<br>Gjatë viteve 2022-2023 janë miratuar 20 programe trajnimi nga ana e KSHLM. Çdo vit, katalogu i programeve të trajnimit për ZHPM përditësohet dhe publikohet në faqen e internetit të MASHTI-t. Janë trajnuar mbi 5000 mësimdhënës gjatë këtij periudhe kohore.<br><br>Gjatë këtij gjashtëmujori, 3 komuna kanë filluar zbatimin e trajnimeve me bazë në shkollë: Drenasi, Vitia dhe Istogu, dhe rreth 100 mësimdhënës janë përfshirë në këto trajnime. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, janë trajnuar 189 mësimdhënës në programin e aftësimit për zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Në këtë fazë, rreth 200 mësimdhënës janë përfshirë në programin e aftësimit për zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë.<br><br>Sfidat mbeten mungesa e ofrimit të programeve prioritare nga ana e ofertuesve dhe vonesa në hapjen e ofertave. Programet prioritare të trajnimit hartohen nga MASHTI, në bashkëpunim me ofertuesit dhe donatorët. |
| 2.8.6. Zbatimi i procedurave të brendshme dhe të jashtme për zhvillim profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë dhe mbështetja e shkollave për pjesëmarrje në projektet Erasmus + që lidhen me aftësimin e mësimdhënësve në shërbim. | TM 3/2022 - TM4/2026 | 7,880 | 164,840 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | IEAA DKA MASHTI | ZHPM me bazë në shkollë mbështetet në vazhdimësi nga DKA-të.<br><br>Mbi 700 mësimdhënës janë përfshirë në programin e aftësimit për zbatimin e ZHP me bazë në shkollë. | Raportet e monitorimeve të ZHPM me bazë në shkollë.<br><br>Evidencat e trajnimit të mësimdhënësve për ZHP me bazë në shkollë | **80-100 %**<br>Jane trajnuar 1200 mesimdhenes me baze ne shkolle. Gjate këtij gjashtëmujori, 3 komuna kanë filluar zbatimin e trajnimit me bazë në shkollë: Drenasi, Vitija dhe Istogu dhe në këto trajnime janë përfshirë rreth 100 mësimdhënës. Gjate kësaj periudhe kohore janë trajnuar 189 mësimdhënës (Rahovec - 59 mësimdhënës, Viti - 50 mësimdhënës, Prishtinë - 45 mësimdhënës, Istog - 35 mësimdhënës) në programin e aftësimit për zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Në këtë fazë, në programin e aftësimit për zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë janë përfshirë rreth 200 mësimdhënës. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.8.7. Krijimi dhe mbështetja e rrjeteve profesionale të mësimdhënësve dhe qendrave për ngritje profesionale në nivel komune (Komunitetet e mësimnxënies) , si dhe nxitja e mësimdhënësve për krijimin e shoqatave të mësimdhënësve për fusha lende te ndryshme mësimore. | TM1/TM2/ 2023<br><br>TM3/2023-TM4 2026 | - | 42,404 | Buxheti i Kosovës Donatorët | DKA MASHTI | Të paktën një qendër për ZHPM është funksionale në çdo komunë dhe të paktën 2-3 komunitete të mësimnxënies funksionojnë në çdo komunë.<br><br>Rregullorja për krijimin e shoqatave profesionale për mësimdhënës.<br><br>Janë ndarë së paku 28 grante/projekte te vogla mbështetëse për shoqatat profesionale të mësimdhënësve. | Raportet vjetore të DKA-ve për ZHPM. Lista e komuniteteve të mësimnxënies që funksionojnë.<br><br>Rregullorja e miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MASHTI.<br><br>Lista e publikuar nga MASHTI për shoqatat profesionale të mësimdhënësve | **20-39 %**<br>Jane mbështetur 10 komuna gjatë vitit 2023 me plotësimin e kushteve nga DKA dhe shkollat, dhe do të vazhdohet edhe gjatë vitit 2024, gjithashtu në 10 shkolla tjera apo qendra për trajnim të mësuesve. Sfida mbetet mungesa e hapësirave adekuate nëpër shkolla për krijimin e këtyre qendrave. |
| 2.8.8. Promovimi i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë. | TM 2/2023 - TM4/2026 | - | 2,900 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI | Organizimi i ngjarjeve promovuese dhe informuese për zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë. | Materialet promovuese dhe informuese dhe evidencat nga ngjarjet e organizuara. | **20-39 %**<br>Gjatë viteve 2022-2023 nuk është organizuar ndonjë ngjarje e tillë, por ka pasur informime të vazhdueshme nga MASHTI. Gjatë vitit 2024 do të promovohet licenca e avancuar në terren. |
| 2.8.10. Organizimi i provimit shtetëror për mësimdhënësit para punësimit sipas ligjit për profesionet e rregulluara | Nga fillimi i zbatimit të ligjit. | - | - | | MASHTI | Platforma për organizimin e provimit shtetëror për mësimdhënësit para punësimit, e zhvilluar dhe e vënë në zbatim. | Raportet e fillimit të organizimit të provimit shtetëror për mësimdhënësit para punësimit. | **0-19 %**<br>Nuk është organizuar provimi shtetëror. |
| 2.8.11. Zhvillimi dhe organizimi në mënyrë institucionale i programit hyrës për mësimdhënësit fillestarë. | TM1 - TM3 2023<br><br>TM3 - 2023 deri në TM4 - 2026 | - | 19,080 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI DKA | Programi hyrës për mësimdhënësit fillestarë në zbatim.<br><br>Rreth 320 mësimdhënës janë aftësuar për mentorë në programin hyrës për mësimdhënësit fillestarë. | Dokumentet e programit hyrës të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI.<br><br>Evidencat e trajnimit të mësimdhënësve për mentorë. | **0-19 %**<br>Nuk ka pasur nisma nga MASHTI pas MOU të nënshkruar ne 2023 për të jetësuar këto nisma. Mungesa e fondeve ka qenë një sfidë. |
| 2.8.12. Zhvillimi i kritereve bazë dhe udhëzuesve për ngritjen e kapaciteteve të vlerësuesve të performancës së mësimdhënësve (VPM) (inspektorëve, drejtuesve të shkollave dhe mësimdhënësve) | TM3 - TM4 2022 | 11,655 | - | Buxheti i Kosovës | MASHTI/IA | Dokumenti me kërkesat bazë për kualifikimin dhe kapacitetet për vlerësues VPM, i zhvilluar dhe miratuar në formatin e një udhëzuesi për vlerësues. | Udhëzuesi për vlerësues VPM, i publikuar në faqen zyrtare të MASHTI. | **0-19 %**<br>Nuk ka pasur progres. Në vitin 2023 është miratuar Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e mësuesve, por udhëzuesi që përmban kriteret bazë nuk është bërë. |
| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.11. Rritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i AKA-së. | TM3/2022-TM4/2023 | 30,426 | 96,503 | Buxheti i Kosovës | Agjencia e Kosovës për Akreditim | Numri i stafit të rinj administrativ të AKA-së të punësuar. | Vendimet e punësimit | **40-59 %**<br>Të aprovuara 32 pozita. Janë pranuar deri tani 17. Vonesa në aprovim të organogramit të AKA-së. |
| 4.1.12. Aplikimi për anëtarësim të AKA-së me të drejta të plota në ENQA dhe EQAR. | TM1-TM4/2023 | - | 34,070 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | Agjencia e Kosovës për Akreditim<br><br>MASHTI | Raporti për vlerësimin e rekomandimeve të ENQA dhe EQAR. | Raporti i vlerësimit | **60-79 %**<br>Në proces të adresimit të rekomandimeve nga ENQA dhe EQAR. Vonesa në aprovimin e Ligjit për Akreditim ka shkaktuar vonesa edhe në këtë proces. |

| 4.2. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes rishikimit të programeve të studimit, avancimit të infrastrukturës akademike, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të** | **Përqindja e IAL-ve me infrastrukturë dhe teknologji të avancuar për mësimdhënie dhe punë kërkimore** | **NA** | **60%** | **Raportet e investimeve Lista e inventarit Raportet financiare** |
| | **Përqindja e IAL-ve me mekanizma për sigurimin e cilësisë plotësisht funksional** | **NA** | **100%** | **Raportet e vetëvlerësimit Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të IAL-ve** |
| | **Përqindja e IAL-ve me mekanizma për zhvillimin profesional të stafit akademik plotësisht funksional.** | **NA** | **100%** | **Vendimet për themelimin e mekanizmave Raportet e monitorimit/ raportet vjetore të IAL-ve** |
| | **Shkalla e rritjes së numrit të publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik të IAL-ve** | **NA** | **20%** | **Raportet vjetore të IAL-ve për publikime shkencore të stafit akademik Të dhënat statistikore nga MASHTI** |
| | **Deri në vitin 2024 fillon zbatimi i metodologjisë së financimit të institucioneve të arsimit të lartë në bazë të performancës.** | **NA** | **100%** | **Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të marrëveshjeve të performancës Të dhënat statistikore të MASHTI** |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 4.2.1. Miratimi i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim | 0 | - | - | / | Agjencia e Kosovës për Akreditim<br><br>MASHTI | Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. | Gazeta zyrtare | **80-100 %**<br>Ligji për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, numër 08/L-110, është miratuar në Kuvend në qershor 2023. |
| 4.2.2. Rishikimi i Ligjit për Arsimin e Lartë | 0 | - | - | / | MASHTI | Ligji për Arsimin e Lartë. | Gazeta zyrtare | **60-79 %**<br>Ligji i Arsimit të Lartë është miratuar nga ana e Qeverisë dhe tani kërkohen dy të tretat e votave në Kuvend për tu miratuar, por për arsye të mosarritjes së numrit, ende nuk është miratuar në Kuvend. |
| 4.2.3. Rishikimi i Ligjit për Profesionet e Rregulluara | TM1-TM3/ 2023 | - | 12,640 | Donatorët | MASHTI | Ligji për Profesionet e Rregulluara. | Gazeta zyrtare | **0-19 %**<br>Është larguar nga Plani Legjislativ për plotësim ndryshim . Ky largim është parapare nga Kabineti i Ministres. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.4. Rishikimi dhe hartimi i akteve nënligjore në arsimin e lartë | TM2/2023-TM4/2025 | - | 53,800 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Numri i akteve nënligjore të miratuara në arsimin e lartë. | Aktet e nënshkruara | **40-59 %**<br>Udhëzimi Administrativ për mbështetje financiare për student është nënshkruar nga Ministrja, nr.20/2023. Është finalizuar dhe është nënshkruar Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (për shkak të vonesës me Ligjin për Akreditim, në 2022-2023 nuk ka filluar rishikimi). Udhëzimi Administrativ për Regjistrin e Institucioneve inovative shkencore ka kaluar fazën e diskutimit paraprak dhe atij publik dhe tani ndodhet në Divizionin Ligjor për procedim të mëtutjeshëm. UA 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e UA 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të AL në Kosovë nuk është filluar. |
| 4.2.5. Hartimi i rregulloreve për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqet e internetit (Open Data) | TM2-TM4/2023 | - | 11,040 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Rregulloret për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqet e internetit të miratuara në të gjitha IAL-të | Vendimet e miratimit të rregulloreve | **0-19 %**<br>Nuk ka ende rregullore në nivel të vendit. Rregullohet veçmas nga IAL-të. |
| 4.2.7. Hartimi i kodeve të etikës dhe integritetit akademik dhe funksionalizimi i Këshillave të Etikës në të gjitha IAL-të. | TM2-TM4/2023 | - | 11,320 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Akti nënligjor për standardet e përgjithshme të etikës dhe integritetit akademik.<br><br>Kodet e etikës dhe integritetit akademik të miratuara në të gjitha IAL-të.<br><br>Këshillat e Etikës të themeluara në të gjitha IAL- të.<br><br>Numri i anëtarëve të Këshillave të Etikës të IAL- ve, të trajnuar për aspekte të ndërlidhura me etikën dhe integritetin akademik. | Akti i nënshkruar<br><br>Vendimet e miratimit të kodeve<br><br>Vendimet për themelimin e KE<br><br>Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve | **60-79 %**<br>Supozohet se të gjitha IAL-të i kanë dokumentet por mungon raportimi nga IAL-të. |
| 4.2.8.Sigurimi i qasjes në programe antiplagjiaturë për IAL-të. | TM1/2023-TM4/2026 | - | 20,000 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Kontratat afatgjate të IAL-ve për pajisjen dhe shfrytëzimin e programeve antiplagjiaturë. | Kontratat e nënshkruara | **20-39 %**<br>AKA tashmë është anëtare me të drejta të plota në Rrjetin Global të Integritetit Akademik (GAIN). Anëtarësimi në këtë organizatë është bërë me rekomandimin e ENQA. Ne 2022, MASHTI ka nxjerre vendim me te cilin e autorizon AKA-ne per verifikimin e plagjiarizmit ne tema te doktorates. Mirepo, deri me tani, MASHTI nuk ka perfunduar blerjen e softëare-it i cili do te mundesonte ekzekutimin e ketij procesi. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.9. Zhvillimi i Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL) dhe Regjistrit të Hulumtuesve Shkencor. | TM2/2022-TM4/2023 | 17,840 | 204,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Softueri për SMIAL i zhvilluar.<br><br>Softueri për Regjistrin i zhvilluar. | Raportet e monitorimit dhe vlerësimit | **40-59 %**<br>Ne vitin 2023, MASHTI, permes kompanisë që ka zhvilluar këtë sistem, ka bërë përmirësimin e sistemit SMIAL (kanë siguruar qasjen për student për verifikim të të dhënave, lehtësim në gjenerim të raporteve, kufizim të transfereve vetëm brenda kuotës së lejuar me vendim të AKA, etj.). Sistemi ndodhet nen administrim të divizionit joperkates; mungesa e mirëmbajtjes së sistemit. Avancimi dhe ridizajnimi i sistemit; kthimi nen administrimin e Departamentit përkatës. Përmes Rregullores së brendshme të vitit 2018 është bartur në divizionin e statistikave, gjë që ka shkaktuar paqartësi dhe përzierje kompetencash mes departamenteve. |
| 4.2.10. Ngritja e kapaciteteve në nivel qendror dhe në nivel të IAL për shfrytëzimin e SMIAL dhe Regjistrit të Hulumtuesve Shkencor. | TM3/2023-TM4/2024 | - | 4,500 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Udhëzuesit e hartuar për trajnim për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.<br><br>Numri i zyrtarëve përgjegjës për SMIAL në nivel qendror dhe në nivel të IAL-ve të trajnuar për shfrytëzimin e SMIAL.<br><br>Publikimi i raporteve periodike me informata për arsimin e lartë dhe për hulumtuesit | Vendimet e miratimit të udhëzuesve<br><br>Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve<br><br>Raportet e publikuara | **40-59 %**<br>Rregullisht përgatiten raporte nga SMIAL pas përfundimit të çdo afati për regjistrim dhe transfer të studenteve të të gjitha niveleve. Sa i përket avancimit të SMIAL nuk ka pasur nevojë për trajnime shtesë, duke pasur parasysh që ky sistem për herë të parë është zhvilluar në vitin 2017. Mirëpo, sfidë është fakti që ky sistem është nën administrim të divizionit jo përkatës. Gjithashtu sfidë është mungesa e mirëmbajtjes së sistemit, avancimi dhe ridizajnimi i sistemit. Rekomandohet kthimi i sistemit nën administrimin e Departamentit përkatës. Përmes Rregullores së brendshme të vitit 2018 është bartur në divizionin e statistikave, gjë që ka shkaktuar paqartësi dhe përzierje kompetencash në mes departamenteve. |
| 4.2.11. Ngritja e kapaciteteve njerëzore të Departamentit për Arsim të Lartë dhe Qendrës për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC) në MASHTI. | TM3/2023-TM3/2026 | - | 7,280 | Donatorët | MASHTI NARIC | Numri i trajnimeve të ndjekura nga stafi i DALSH dhe Qendrës NARIC. | Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve | **40-59 %**<br>70% e stafit të NARIC mbulohen me kontrata përmes prokurimit. Ka mungesë stafi dhe nuk ka zgjidhje të qëndrueshme.<br>Bashkëpunimin dhe vizitat në Qendra të ENIC/NARIC në vende të tjera me qëllim të përfitimit të përvojave të reja. Plotësimi me zyrtar të rregullt. Digjitalizimi i shërbimeve. Zvogëlimi i barrierave administrative për verifikim të dokumentacionit shkollor. Aplikimi për nostrifikim bëhet online, mirëpo pjesa tjetër e procedurave është manuale. Aktualisht ofrohet mbështetja e projektit HE 25, I cili financohet nga ADA kryesisht pjesën e arkivës se NARIC-ut. |
| 4.2.12. Fuqizimi i Konferencës së Rektorëve. | TM3/2023-TM3/2026 | - | 4,890 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>Konferenca e Rektorëve | Numri i takimeve ndërkombëtare të ndjekura nga anëtarët e Konferencës së Rektorëve, të organizuara nga asociacionet ndërkombëtare të arsimit të lartë.<br><br>Numri i dokumenteve të politikave, rekomandimeve të ofruara nga anëtarët e Konferencës së Rektorëve. | Agjendat e takimeve ndërkombëtare/ Raportet nga takimet<br><br>Dokumentet e hartuara/ raportet e punës | **0-19 %**<br>MASHTI nuk është pjesë e konferencës dhe nuk raportohet. Sfidë është anashkalimi I MASHTI-t në këtë proces. Rekomandohet që MASHTI të jetë pjesë e konferencës së rektorëve, të paktën si monitorues. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.13. Zhvillimi i metodologjisë së financimit të IAL-ve dhe ngritja e kapaciteteve për zbatim. | TM3/2023-TM4/2025 | - | 10,500 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Akti nënligjor për metodologjinë e financimit të arsimit të lartë (përfshirë treguesit e ndjeshëm gjinor të performances në arsimin e lartë).<br><br>Numri i zyrtarëve në nivelin qendror dhe në nivel të IAL-ve të trajnuar për metodologjinë e financimit të IAL-ve. | Akti i nënshkruar<br><br>Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve | **40-59 %**<br>Është hartuar UA për financimin e universiteteve publike bazuar në performancë dhe ndodhet në fazën e diskutimit paraprak. |
| 4.2.14. Zhvillimi i mekanizimit për zbatimin e formulës së re të financimit për arsimin e lartë. | TM3/2023-TM4/2025 | - | 11,640 | Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Numri i marrëveshjeve të performances ndërmjet MASHTI-t dhe IAL-ve.<br><br>Korniza për monitorimin dhe vlerësimin e marrëveshjeve të performances. | Marrëveshjet e nënshkruara<br><br>Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të marrëveshjeve | **80-100 %**<br>Ky aktivitet ndërlidhet me atë paraprak, dmth pas miratimit të UA për financimin e universiteteve publike bazuar në performancë. Ky aktivitet është planifikuar për vitin 2024. |
| 4.2.15. Mbështetja e studentëve përmes ofrimit të bursave. | TM1/2022-TM4/2026 | 2,500,000 | 2,500,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI Institucionet e Arsimit të Lartë | Numri i bursave të ndara për studentët nga radhët e kategorive të cenueshme sociale dhe komunitetet e nën përfaqësuara.<br><br>Numri i bursave të ndara për studentët e dalluar.<br><br>Numri i bursave të ndara për studentët në studime të doktoratës.<br><br>Numri i bursave të ndara për studentët në drejtimet STEM dhe drejtimet deficitare.<br><br>Databaza e përfituesve të bursave në skema të ndryshme për arsimin e lartë. | Thirrjet e publikuara Listat e përfituesve Raportet vjetore | **80-100 %**<br>Në vitin 2022, afër 43 mijë studentë përfituan nga lirimi i pagesës. Mbi 1,968 bursa u ndanë për studentët e dalluar për studime brenda dhe jashtë vendit (viti akademik 2022/2023). Janë dhënë 22 bursa për studentët me nevoja të veçanta (viti akademik 2022/2023) dhe 106 bursa për nxitjen e vajzave për të ndjekur profile teknike dhe djemve për të ndjekur profile deficitare (vlera e bursës 500 euro në vit).<br>Afër 2,000 bursa u ndanë në fushat STEAM (viti akademik 2022/2023). Në vitin 2023, 1667 studentë të niveleve Ba dhe Ma (ku hyjnë edhe personat me aftësi të kufizuara) përfituan bursa elitare (1000 Euro për student). Gjithashtu, 55 studentë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përfituan bursa (1000 Euro për student).<br>Në skemën për mbështetje financiare për studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë, përfituan 43 aplikantë (8,500 Euro për person). Në skemën për mbështetje financiare për studentët e nivelit master që studiojnë në 150 universitetet më të mira të botës sipas listës Shanghai, u rekomanduan 17 përfitues.<br>Në vitin 2023, gjithsej aplikuan 116 kandidatë për bursa doktorature në 500 institucionet e arsimit të lartë sipas platformës Shanghai. Prej tyre, Këshilli i Shkencës vlerësoi që 43 doktorë që studiojnë jashtë Republikës së Kosovës plotësuan kushtet dhe kriteret, dhe secili përfitoi nga 8,500 Euro.<br>Për bursat Master jashtë Republikës së Kosovës në top 150 institucionet e arsimit të lartë sipas platformës Shanghai, aplikuan 96 studentë dhe prej tyre përfituan 13 studentë të nivelit Master (shuma për student ishte 7000 Euro).<br>Është publikuar thirrja publike për bursat elitare me notë mesatare 9 deri 10 sipas udhëzimit administrativ 20/2023. Aplikuan 2517 studentë dhe prej tyre fituan 1667 studentë. Thirrjes publike për mbështetje financiare për studentet vajza/gra në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM) iu përgjigjën 1882 studente që plotësuan kushtet dhe kriteret (shuma e bursës ishte 1000 Euro për student). |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Është shpallur konkursi publik për ndarjen e 100 bursave nga komuniteti REA për vitin akademik 2023-2024. Numri i përfituesve ishte 55 studentë që plotësuan kushtet dhe kriteret (1000 Euro për bursë).<br>Një shtesë e punës me skema të reja dhe staf minimal është e domosdoshme; mungon ndërveprimi i sistemeve me SEEMS. Për këtë politikë është hartuar dhe aprovuar udhëzimi administrativ 20/2023. Linku<br>Në kuadër të mbështetjes financiare të studentëve që studiojnë në fushat STEM, kanë përfituar 1882 studentë (shuma e bursës është 1000 Euro për student). |

| 4.3. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit, rritjes së mundësive për punë praktike të studentëve, bashkëpunimit me ndërmarrje dhe rritjes së programeve ndërdisiplinare të studimit | Përqindja e programeve të studimit që janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | NA | 80% | Raportet e hulumtimeve nga IAL-të Raportet e vetëvlerësimit të programeve |
| | Përqindja e IAL-ve me mekanizmat plotësisht funksional për zhvillim të karrierës | NA | 100% | Të dhënat statistikore të IAL Raportet vjetore të IAL-ve |
| | Numri i projekteve të përbashkëta të IAL-ve me ndërmarrje | NA | Së paku 2 në vit | Të dhënat statistikore të IAL Raportet vjetore të IAL-ve |
| | Shkalla e rritjes së numrit të studentëve që ndjekin programet e studimit në fushat e STEM | NA | 15% | Të dhënat statistikore të IAL Raportet vjetore të IAL-ve |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | Progresi në zbatim 2022-2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.3.1. Zhvillimi i programeve të reja profesionale të nivelit 5 në IAL publike. | TM1/2023-TM4/2026 | - | 80,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Numri i programeve të nivelit të 5 që ofrohen në IAL publike.<br><br>Numri i studentëve që ndjekin programe të nivelit të 5 në IAL publike. | Vendimet për akreditimin e programeve Raportet e vlerësimit Listat e studentëve të pranuar | **0-19 %**<br>Nuk ka programe të ofruara të nivelit V të IAL Publike të akredituara nga AKA. |
| 4.3.2. Realizimi i hulumtimeve të vazhdueshme nga IAL-të për programet të ofruara dhe nevojat e tregut të punës duke përfshirë ato të bazuara mbi nevojat e vajzave dhe grave në tregun e punës | TM1/2023-TM4/2026 | - | 11,920 | Donatorët | Institucionet e Arsimit të Lartë | Numri i hulumtimeve të IAL-ve për programet e ofruara dhe nevojat e tregut të punës. | Raportet e hulumtimeve | **20-39 %**<br>AKA obligon te gjitha IAL-të të ofrojnë analiza dhe statistika mbi nevojat e tregut të punës për programet e parapara. Megjithatë, këto statistika dhe analiza, nuk bazohen në nevojat e tregut të punës sipas gjinisë. Mungon një data bazë e centralizuar në nivel qeveritar e cila do te mundësonte saktësi dhe besueshmëri në të dhënat e prezantuara. |
| 4.3.3. Rishikimi dhe hartimi i programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës duke përfshirë rishikimin dhe hartimin e programeve të studimit në përputhje me nevojat e vajzave dhe grave, për të stimuluar rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. | TM1/2022-TM4/2026 | - | - | / | Institucionet e Arsimit të Lartë | Përqindja e programeve të studimit të IAL-ve, që dëshmojnë përputhje me kërkesat e tregut të punës.<br><br>Numri i programeve të hartuara dhe zbatuara, bazuar në nevojat e grave në tregun e punës. | Raportet e analizës/ monitorimit dhe vlerësimit | **20-39 %**<br>MASHTI përmes skemës së bursave në STEM ka stimuluar pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në programet STEM. Për informata shtesë të konsultohen IAL dhe AKA. Mungon një data bazë e centralizuar në nivel qeveritar e cila do të mundësonte saktësi dhe besueshmëri në të dhënat e prezantuara. Ky aktivitet është planifikuar për vitin 2025. |
| 4.3.4. Funksionalizimi i qendrave për zhvillim të karrierës në IAL-të publike dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të tyre. | TM1/2023-TM4/2024 | - | 52,452 | Buxheti i Kosovës | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Numri i stafit të rinj të punësuar në Qendrat për Zhvillim të Karrierës në IAL-të, i ndarë në baza gjinore.<br><br>Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve të ofruara nga Qendrat për Zhvillim të Karrierës të IAL-ve, i ndarë në baza gjinore. | Vendimet për punësim<br><br>Raportet e punës | **60-79 %**<br>Të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë themeluar qendra për zhvillim të karrierës. |
| 4.3.5. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe ndërmarrjeve. | TM1/2023-TM4/2026 | - | 30,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Numri i granteve të ofruara për mbështetjen e projekteve të përbashkëta të IAL-ve me ndërmarrje | Marrëveshjet e nënshkruara<br><br>Raportet e monitorimit | **40-59 %**<br>Projekti EDU TASK (GIZ / ITP) ka financuar 5 projekte në vlerë prej 50 000 për projekt për bashkëpunim akademi - industri. |
| 4.3.6. Zhvillimi i programeve ndërdisiplinore të studimit | TM1/2023-TM4/2026 | - | 40,000 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Numri i programeve ndërdisiplinore të studimit që ofrohen në IAL-të publike<br><br>Numri i studentëve që ndjekin programet ndërdisiplinore të studimit | Vendimet për akreditimin e programeve Raportet e vlerësimit Listat e studentëve të pranuar | **N/A** |

| 4.4. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, si dhe integrimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit** | **Numri i IAL-ve që ofrojnë programe të përbashkëta të studimit me universitete ndërkombëtare.** | **Mungojnë programet e përbashkëta me Universitete ndërkombëtare** | **Së paku 1** | **Raportet e vetëvlerësimit Raportet e vlerësimit të AKA/ Vendimet e akreditimit Raportet e monitorimit** | |
| | **Përqindja e IAL-ve me mekanizma plotësisht funksional për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve** | **NA** | **100%** | **Raportet e monitorimit Raportet vjetore të IAL-ve** | |

DRAFT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të Lartë | **Shkalla e rritjes së mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë.** | | **20%** | **Të dhënat statistikore të MASHTI/ IAL Raportet vjetore të IAL-ve** |
| | **Shkalla e rritjes së pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.** | | **20%** | **Të dhënat statistikore të MASHTI/ IAL Raportet vjetore të IAL-ve** |

| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | **Progresi në zbatim 2022-2023** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 4.4.1. Hartimi i strategjive të IAL-ve për ndërkombëtarizim. | TM1-TM4/2023 | - | 30,240 | Donatorët | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Strategjitë për ndërkombëtarizim të miratuara në të gjitha IAL-të | Vendimet për miratim | **80-100 %**<br>Nga 8 Institucione publike 6 prej tyre kanë aprovuar strategjitë e institucionit ose kanë integruar komponentin e ndërkombëtarizimit në strategjitë bazë. Dy të tjera janë hartuar dhe janë draftet në proces të miratimit. Strategjitë për Ndërkombëtarizim të IAL-ve janë hartuar në partneritet në kuadër të projektit ERASMUS + QUADIC / Quality Development of International Cooperation and Project Management. Po ashtu është hartuar Plani Kombëtar i Shkencës nga ana e Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe tani dokumenti ndodhet në Kuvend për miratim (është miratuar nga ana e Qeverisë). Ka vonesa në procesin e miratimit në Kuvend. |
| 4.4.2. Financimi i projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik, përfshirë programet e përbashkëta ndërdisiplinare të studimit me IAL-të ndërkombëtare | TM1/2023-TM4/2026 | - | 20,000 | Donatorët | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Numri i programeve të përbashkëta disiplinare të studimit me IAL-të ndërkombëtare që zhvillohen në gjuhën angleze | Vendimet për akreditimin e programeve Raportet e vlerësimit Listat e studentëve të pranuar | **60-79 %**<br>Programi ERASMUS+: për thirrjen e vitit 2023, në fushën e arsimit të lartë janë përzgjedhur për financim nga Komisioni Evropian gjithsej 13 projekte me 27 institucione përfituese nga Kosova, prej të cilave IAL-të nga Kosova janë bartës/koordinator në 4 projekte, përfshirë përfitimin në projektin strukturor në avancimin e edukimit të bazuar në vlera përmes zhvillimit të politikave dhe praktikave të reformave në mësimdhënie në Kosovë.<br>Gjatë vitit 2023, 7 institucione të arsimit të lartë nga Kosova e kanë fituar Erasmus Charter të Arsimit të Lartë ECHE. Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar programin Master ""Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore", programi studimor është ndërdisiplinor dhe ofrohet në gjuhën angleze. Universiteti i Prishtinës ka hapur programin e ri të doktoratës në Shkencat e Edukimit i cili është program i përbashkër me Universitetin e Lublanës. Diploma do të jetë e dyfishtë. Kolegji IBCM ka zhvilluar programin e studimit Master në menaxhim ndërkombëtar dhe lidership me Universitetin Sapienza. Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar programin e studimit në gjuhën angleze "Human Rights, International Criminal Laë, Transitional Justice". Programi zhvillohet në gjuhën angleze dhe rekruton edhe studentë ndërkombëtar. Gjatë vitit 2023 në total janë zhvilluar pesë programe studime në gjuhën angleze: një në nivel të doktoratës dhe 4 në nivelin master. Programi i Perbashket MA me emërtimin "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimit" me partnerët: Universiteti i Sarajevës, Universiteti i Bihaqit, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Haxhi Zeka në kuadër të projektit të ERASMUS + "BUGI". Programi i përbashkët MA "Bujqësia Urbane" me partnerët: Universiteti |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Sarajevës. UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës dhe Universiteti Haxhi Zeka në kuadër të projektit ERASMUS + "STEPS. Programet janë ofruar në gjuhën boshnjake dhe shqipe. Është në fazën finale shpallja e fituesve të projekteve me Shqipërinë. Kurse në kuadër të skemës për mësimdhënien e bazuar në hulumtim pritet të shpallet thirrja në fund të muajit shkurt 2024 (projektet me donator HEY 25).<br>Kryesisht tek programet e përbashkëta është sfiduese sepse ndërlidhet edhe procesi dhe legjislacioni vendor por edhe ai i huaj, proceset e akreditimit të cilat duhet të koordinohen me afatet e të gjithë partnerëve në projekt, financimi i programit të studimit përfshirë infrastrukturën, stafi i limituar për ligjërim në gjuhën angleze, etj. Rekomandohet të rritet përkrahja dhe financimi i programeve në gjuhën angleze duke qenë se shihet si një indikator i rëndësishëm në fuqizimin e ndërkombëtarizimit. Kjo mund të shërbejë gjithashtu për rritjen e mobilitetit nga vendet partnere drejt Kosovës. Gjithashtu, duhet të shfrytëzohet strategjikisht programi Erasmus+, në komponentën e Design Measures për qëllim të dizajnimit të programeve, posaçërisht atyre të doktoratës.<br><br>Është kryer intervistimi i kandidatëve për programin Fulbright Masters 2024-2025, dhe gjithsej janë nominuar 9 kandidatë, prej të cilëve 5 të nominuar kryesorë dhe 4 alternativë. Është bërë vlerësimi i aplikimeve për Fulbright Specialist Program 2023. Në total janë pranuar 22 aplikime, prej të cilëve 12 janë mbështetur. Është bërë shqyrtimi i aplikimeve në kuadër të skemës Fulbright US Student Researchers, ku janë mbështetur 4 aplikime, si dhe të English Teaching Assistant, ku janë mbështetur 9 aplikime. Në kuadër të skemës Fulbright Visiting Scholar Program 2023-2024, gjashtë hulumtues nga Kosova janë duke ndjekur studimet postdoktorale në SHBA, ndërsa përfituesit e këtij skeme për vitin 2022-2023 janë kthyer në Kosovë dhe po kontribuojnë në fushën e tyre të ekspertizës. Sa i përket programit US Fulbright Scholar, katër hulumtues nga SHBA do të vijnë për të bashkëpunuar me stafin akademik në Kosovë. Në skemën e bursave për doktoratë në top 500 universitetet më të mira në botë sipas listës Shanghai janë dhënë 43 bursa në vlerë prej 8500 Euro për student. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.4.3. Funksionalizimi i qendrave për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve në IAL dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të tyre | TM1/2023-TM4/2024 | - | 52,452 | Buxheti i Kosovës | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Qendrat për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve të themeluara në të gjitha IAL-të<br><br>Numri i pjesëtarëve të stafit akademik që mbështeten për zhvillimin e projekteve akademike dhe kërkimore, si dhe në ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare. | Vendimet e themelimit<br><br>Vendimet për angazhimin e stafit<br><br>Listat e punëtorive/agjenda t Listat e pjesëmarrësve në punëtori | **60-79 %**<br>4 Universitete kanë themeluar Qendrat për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve të themeluara në të gjitha IAL-të<br>Universiteti i Gjilanit- Qendër multidiciplinare, Universiteti i Prizrenit- Qendra për Kërkime Shkencore, IBCM-Qendra për Menaxhim të Projekteve, Universiteti i Prishtinës-ZMJ,ZKPS. Dy Universitete i kryejnë këto shërbime përmes zyrave për bashkëpunim ndërkombëtar, Universiteti i Pejës dhe Universiteti i Gjakovës. Dy Universitete nuk i kanë themeluar akoma këto qendra janë në proces të funksionalizimit, Universiteti i Mitrovicës dhe USHAF. Kryesisht tek programet e përbashkëta është sfiduese sepse ndërlidhen proceset dhe legjislacioni vendor, por edhe ai i huaj, proceset e akreditimit të cilat duhet të koordinohen me afatet e të gjithë partnerëve në projekt, financimi i programit të studimit përfshirë infrastrukturën, stafi i limituar për ligjërim në gjuhën angleze, etj. Rritja e kapaciteteve njerëzore (ekspertë, trajnerë, në fushat e shkrimit të projekteve dhe hulumtimit) është gjithashtu një nevojë.<br>Rekomandohet të rritet përkrahja dhe financimi i programeve në gjuhën angleze duke qenë se shihet si një indikator i rëndësishëm në fuqizimin e ndërkombëtarizimit. Kjo mund të shërbejë gjithashtu për rritjen e mobilitetit nga vendet partnere drejt Kosovës. Gjithashtu, duhet të shfrytëzohet strategjikisht programi Erasmus+, në komponentën e Design Measures për qëllim të dizajnimit të programeve, posaçërisht atyre të doktoratës. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.4.4. Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik | TM1/2022-TM4/2026 | 60,000 | 60,000 | Buxheti i Kosovës | Institucionet e Arsimit të Lartë<br><br>MASHTI | Numri i bursave të ofruara për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.<br><br>Numri i muajve të mobilitetit për stafin akademik të IAL-ve.<br><br>Numri i muajve të mobilitetit për studentët e IAL-ve. | Thirrjet e publikuara<br><br>Listat e përfituesve<br><br>Marrëveshjet e nënshkruara Raportet e mobilitetit | **60-79 %**<br>Sa i përket mobiliteve në kuadër të programit Erasmus+ ndër vite ka rritje të mobilitetit të stafit dhe studenteve nga Kosova në IAL-të në BE. Nga viti 2015 prej themelimit të Zyrës Erasmus+ në Kosovë, Kosova ka pasur një rritje të vazhdueshme të mobilitetit dhe projekteve, që në përqindje tregon rritje 20-30% nga viti në vit. (rezultatet e vitit 2023- Students and staff moving to Erasmus+ -1 266 total.113 mobilitete të realizuara me programin e shkëmbimit akademik CEEPUS.Mobilitete afatëshkurta të shkencëtarëve 2023 -skema nga programi kombëtar ui shkencës- Gjatë vitit 2023, shpallja e cila ka qenë e hapur pothuajse gjatë tërë vitit, ku KSH i MASHT ka përkrahur 43 hulumtues/profesorë dhe ka refuzuar 13 prej tyre. Të trajtohet dimensioni social në skemat e mobiliteteve sa i përket programit Erasmus + Gjatë këtij viti në kuadër të programit CEEPUS është realizuar edhe një rrjet i ri që koordinohet për herë nga Kosova-Fakulteti i Edukimit. Gjatë kësaj periudhe raportuese në kuadër të programit CEEPUS, janë aprovuar gjithsej 113 mobilitete prej të cilave: profesorë dhe studentë nga vendet partnere në Kosovë 52 (Incoming total: 52), dhe profesorë dhe studentë nga Kosova në vendet partnere. Në kuadër të mbështetjes financiare për mobilitet për studentëve dhe stafit akademik janë realizuar 113 mobilitete me programin e shkëmbimit akademik CEEPUS. Poashtu, ka pasur rritje të mobilitetit në kuadër të programit Erasmus +. Kështu, në kuadër të skemës Erasmus + për shkëmbime afatshkurtëra gjatë vitit 2023 janë realizuar në total 913 mobilitete të stafit akademik prej të cilëve 507 nga Kosova në vende të EU dhe 406 nga vendet e EU në Kosvë, si dhe 1058 shkëmbime të studentëve prej të cilëve 759 nga Kosova në vendet e EU dhe 299 nga vendet e EU në Kosovë. |
| 4.4.5. Rritja e pjesëmarrjes së IAL-ve në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor. | TM1/2023-TM4/2026 | - | 5,750 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MASHTI<br><br>Institucionet e Arsimit të Lartë | Numri i pjesëtarëve të stafit akademik që kanë ndjekur trajnime për aplikim në programet evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor.<br><br>Numri i granteve për mbështetjen e projektpropozimeve për aplikim në programet evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor (Horizon Europe). | Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrjes në trajnime/ vlerësimi i trajnimeve<br><br>Vendimet për dhënien e granteve<br><br>Raportet e monitorimit | **40-59 %**<br>Gjatë tërë vitit 2023 janë trajnuar pjesëmarrësit për programet si në vijim: Rreth 100 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në ëebinare dhe sesione informative për programin Erasmus +. Rreth 130 pjesëmarrës janë trajnuar për programin Horizon Europe. Takime të personalizuara për programin Asiociacioni COST (30 takime me hulumtues) dhe informim dhe komunikim i rrehullt me email me palët e interesuara. Në programin Horizon Europe janë realizuar gjithsej 20 projekt propozime ndërsa janë përfituar 5 projekte më vlerën prej 605.831,25. Në kuadër të programit COST gjatë vitit 2023 ka rritje substanciale të pjesëmarrjes. Hulumtuesit nga Kosova i janë anëtarësuar në 70 aksione (projekte) duke e ngritur numrin e pjesëmarrjes në 140 aksione. Kjo objektivë specifike ndërlidhet me objektivin 4.4.3. Sfidë janë kapacitetet e limituara mbështetëse për stafin akademik për koordinim të projekteve. Nga 11 12 projekte të përfituara në programin Horizon Europe, vetëm 2 projekte janë përfituar nga IAL-të (Universiteti i Prishtinës), ndërsa sa i përket programit Erasmus+ zhvillimet janë pozitive duke qenë se ka trende të rritjes pozitive nga viti në vit. Kjo tregon edhe rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të zyrave mbështetëse (zyra t për bashkëpunim ndërkombëtar në IAL ka një kohë që |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | janë zhvilluar dhe kanë krijuar traditë në fushëveprimtarinë e tyre). Ngjashëm edhe me programin COST. Veprimet janë individuale andaj edhe stafi akademik cdo ditë e më shumë po e rrit pjesëmarrjen. Investimi në zyrat /qendrat për zhvillim dhe koordinim të projekteve të trajtohet si investim strategjik nga IAL-të. Të planifikohen rekrutimi i resurseve humane. Njëherit, zhvillimi/koordinimi I projekteve ndërkombëtare, posaçërisht i projekteve shkencore të vlerësohet në performancën e stafit akademik.<br><br>Partneritet me UP në projektin Strukturor ERASMUS+, TIKEDIT që trajton temën e digjitalizimit në arsim. Projekti është lansuar me dt. 19 &20 qershor 2023 dhe do të zhvillohet për periudhën 3 vjeçare. Rritje e vazhdueshme e pjesëmarrjes në Programin COST (Cooperation in Science and Techology). Nga viti 2018 me dy hulumtues të anëtarësuar në COST, tani kemi 110 hulumtues pjesëmarrës në 95 aksione të COST (të dhënat deri në mars 2023). Në takimin qëndror të mbajtur në Bruksel për vendet fqinje të bashkëpunimit - NNC (Kosova mban këtë status në program) e kemi prezantuar si tregim suksesi. Në kuadër të programit HORIZON Europe kanë ndjekur trajnimet 2-javore 50 hulumtues të cilët janë certifikuar. Trajnimet janë realizuar në kuadër të projektit "Policy Ansëers", që është duke e implementuar Instituti Riinvest. Po ashtu rreth 40 pjesëmarrës kanë ndjekur trajnimin 2-ditor për komponentën e 3-të të programit që i dedikohet ndërmarrjeve inovative dhe bashkëpunimit akademi-industri. Ky trajnim është realizuar nga projekti EduTask në ICK. Trajnimi për rreth 20 pjesëmarrës është ofruar edhe për komponentën e "Widening Participation", përfshirë konsultime të personalizuara për 6 ekipe dhe trajnim për buxhetim të projekteve (LumSUM). Trajnimi është realizuar nga projekti Heras + në bashkëpunim me NCP. Në mbështetje të aplikimeve në programin Horizon Europe gjtihsej 5 grante (1500 euro për gant), aktivitet i përbashkët me projektin HERAS +. Takime informuese dhe te bashkëpunimit në kuadër të aplikimit në projektin Horizon - projekti ëidening Participation and ERA. MASHT ka aplikuar për fond për mbështetje të hulumtuesve për programin Horizon Europe dhe kemi marrë njoftimin se granti në vlerën prej 80 mijë euro është përfituar (projekti wideera.net). Ky projekt ende është në fazë të nënshkrimit të dokumenteve qe pritet të përfundohet në fund të Shtator apo Tetor 2023 sipas procedurës dhe pastaj fillon implementimi i aktiviteteve qe dalin ne kuadër te projektit. Është realizuar sesioni informativ në Universitetin e Prishtinës për komponentën e Horizon Europe Maria Curie Scodowska Actions, specifikisht për "Doctoral Network" . Pjesëmarrës në sesion ishin menaxhmenti i UP dhe dekantët për të parë se si mund të ngrisin cilësinë e studimeve të doktoratës përmes programit Horizon Europe. Sa i përket programit COST deri në këtë periudhë rapotuese hulumtuesit nga Kosova marrin pjesë në 111 COST aksione. Gjatë tërë vitit 2023 janë trajnuar pjesëmarrësit për programet si në vijim: Rreth 100 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në ëebinare dhe sesione informative për programin Erasmus +. Rreth 130 pjesëmarrës janë trajnuar për programin |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Horizon Europe. Poashtu, janë realizuar 30 takime të personalizuara me hulumtues për programin Asiociacioni COST. |

DRAFT

***MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË SA 2022-2026: OBJEKTIVI STRATEGJIK 5***

**OS 5: PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË DIGJITALE PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DHE TË CILËSISË NË ARSIM, NË PËRPUTHJE ME TRENDET E TRANSFORMIMIT DIGJITAL**

| 5. Objektivi strategjik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital | Disponueshmëria e të dhënave, shërbimeve dhe proceseve digjitale në fushën e arsimit që ofrohen në platformën gjithëpërfshirëse digjitale të arsimit. | Mungon platforma digjitale e arsimit. | Platforma digjitale e arsimit është në ndërtim e sipër. | Platforma gjithëpërfshirëse digjitale e arsimit për të gjitha nivelet dhe llojet e institucioneve arsimore. |
| | Numri i orëve mësimore për të cilat janë zhvilluar materiale mësimore digjitale. | 0 | 0 | Të dhënat nga platforma gjithëpërfshirëse digjitale e arsimit, ku janë publikuar materiallet mësimore digjitale. |
| | Numri i pajisjeve të reja teknologjike për qëllime arsimore të blera për IEAA dhe IAL. | NA | 6 000 kompjuterë,<br>4 500 Smart TV ose projektorë,<br>4 500 Pako elektronike për kodim,<br>500 tabela interaktive/smart,<br>500 printerë të rrjetës/fotokopjues. | Lista e furnizimeve nga MASHTI dhe DKA-të. |
| | Përqindja e mësimdhënësve, personelit udhëheqës e administrativ të institucioneve arsimore dhe nxënësve që dëshmojnë kompetencë digjitale themelore në fusha përkatëse që lidhen me rolin e tyre, e ndarë në baza gjinore. | NA | 40% e mësimdhënësve,<br>30% e personelit udhëheqës e administrativ, 30% e nxënësve. | Evidencat dhe raportet e vlerësimi, e ndarë në baza gjinore<br>. |
| | Numri i të punësuarve në nivele dhe lloje të ndryshme të institucioneve që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, i ndarë në baza gjinore. | 0% | 6 zyrtarë në MASHTI,<br>50 zyrtarë të IT-së në nivel komunal,<br>50 koordinatorë për teknologji dhe digjitalizim në nivel komunal. | Lista e të punësuarve në MASHTI dhe në DKA, e ndarë në baza gjinore |
| **5.1. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
| Digjitalizimi dhe integrimi i të dhënave dhe proceseve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së vendim-marrjes së mirë-informuar, transparencës dhe llogaridhënies në fushën e arsimit | Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit për digjitalizimin dhe dokumentacionin në formatin digjital. | Mungon rregullimi ligjor dhe nënligjor për digjitalizimin dhe dokumentacionin në formatin digjital. | Ekziston rregullimi ligjor dhe nën-ligjor për digjitalizimin dhe dokumentacionin në formatin digjital dhe zbatohet legjislacioni në fuqi. | Ligji dhe udhëzimet administrative që rregullojnë digjitalizimin dhe dokumentacionin në formatin digjital. |
| | Përqindja e popullimit të platformës digjitale të arsimit me të dhëna për të gjitha nivelet dhe llojet e institucioneve. | 0 | 0 | Platforma digjitale e arsimit e populluar 100% me të dhëna digjitale për të gjitha nivelet dhe llojet e institucioneve arsimore. |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Numri i shfrytëzuesve të platformës digjitale të arsimit sipas kategorive (nxënës/student, personel i IEAA-ve/IAL-ve, qytetarë, zyrtarë, etj.).** | | **0** | | **0** | | **Raportet dhe statistikat periodike të përdorimit të platformës digjitale të arsimit sipas kategorive të ndryshme të përdoruesve.** | |
| | **Numri i personelit kyç që dëshmon kompetencë për t'i kontribuuar digjitalizimit në fushën e arsimit, në proceset për të cilat kanë përgjegjësi institucionale.** | | **0** | | **0** | | **Evidencat e trajnimeve.** | |
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 5.1.1. Dokumentacioni pedagogjik digjital përfshihet dhe rregullohet me ligjin përkatës për tekste shkollore dhe dokumentacion pedagogjik. | Dokumentacioni pedagogjik digjital përfshihet dhe rregullohet me ligjin për tekste shkollore dhe dokumentacion pedagogjik. | TM3 2022 | - | - | NA | MASHTI | Gazeta Zyrtare. | N/A |
| 5.1.2. Hartimi i Udhëzimeve administrative nga MASHTI-i që i rregullojnë të gjitha çështjet që lidhen me digjitalizimin, automatizimin e proceseve, shërbimet digjitale, dokumentacionin digjital, etj.. | Çështjet që lidhen me digjitalizimin, automatizimin e proceseve, shërbimet digjitale dhe dokumentacionin digjital rregullohen me udhëzime administrative. | TM4 2022 - TM3 2023 | 2,000 | 11,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | UA-të e miratuara. | N/A |
| 5.1.3. Analiza e gjendjes dhe hartimi i termave të referencës për platformën digjitale në mënyrë të detajuar. Termat e referencës duhet të përfshijnë përshkrimin dhe specifikimin e çdo funksionaliteti për çdo modul. Ky përshkrim duhet të përfshijë edhe UX/Mockup për çdo funksion. Termat e Referencës duhet të përfshijnë edhe vlerësimin se kur duhet të vendoset prerja ("Dita Zero") dhe migrimi i të dhënave paraprake. | Analiza e Gjendjes dhe Termat e Referencës. | TM1 - TM4 2023 | - | 102,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI<br>ASHI | Dokumenti i Analizës së gjendjes dhe Termave të referencës. | N/A |
| 5.1.4. Shpallja e konkursit ndërkombëtar për platformën digjitale dhe përzgjedhja e entitetit zbatues. | Konkursi ndërkombëtar për platformën digjitale të arsimit. | TM4 2023 | - | - | NA | MASHTI | Dosja e konkursit/tenderit. | N/A |
| **5.2. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | | **Vlera Bazë** | | **Synimi i Përkohshëm 2024** | | **Burimi** | |

DRAFT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Zhvillimi dhe përdorimi i materialeve mësimore digjitale në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit** | **Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe standardeve për materiale mësimore digjitale.** | **Mungon rregullimi ligjor dhe nënligjor për materialet mësimore digjitale.** | **Ekziston rregullimi ligjor dhe nënligjor për materialet mësimore digjitale dhe zbatohet legjislacioni në fuqi.** | **Ligji dhe udhëzimet administrative që rregullojnë materialet mësimore digjitale.** |
| | **Klasat, nivelet, kategoritë, për të cilat janë prodhuar dhe miratuar materiale mësimore digjitale.** | **0** | **0** | **Të dhënat nga platforma gjithëpërfshirëse digjitale e arsimit, ku janë publikuar materialet mësimore digjitale.** |
| | **Numri i nxënësve që furnizohen nga MASHTI dhe DKA- të me pajisje teknologjike (laptopë) brenda vitit.** | **0** | **0** | **Listat e furnizimeve nga MASHTI dhe nga DKA-të.** |
| | **Numri i mësimdhënësve të aftësuar për përdorimin e materialeve mësimore digjitale në procesin mësimor.** | **0** | **0** | **Evidencat e trajnimeve.** |

| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 5.2.1. Materialet mësimore digjitale përfshihen dhe rregullohen me ligjin për tekste shkollore. | TM3 2022 | - | - | NA | MASHTI | Projektligji për tekste shkollore i plotësuar që përfshinë materialet mësimore digjitale. | Gazeta Zyrtare. | N/A |
| 5.2.2. Hartohet Udhëzimi administrativ nga MASHTI për standardet, formatin dhe cilësinë e materialeve mësimore digjitale. | TM4 2022 - TM2 2023 | 2,000 | 9,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston udhëzimi administrativ për standardet, formatin dhe cilësinë e materialeve mësimore digjitale. | UA i miratuar nga MASHTI. | N/A |
| 5.2.3. Hartohen dhe publikohen udhëzues për përgatitjen e materialeve mësimore digjitale. | TM1 - TM3 2023 | - | 22,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Për secilin nivel të arsimit janë hartuar udhëzues për përgatitjen e materialeve mësimore digjitale: udhëzuesi për parashkollor / grup moshat 3-6; udhëzuesi për klasat 1-5 dhe udhëzuesi për klasat 6-9. Për AAP dhe gjimnaze, janë hartuar udhëzues të veçantë. Udhëzuesit janë përkthyer në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve. | Udhëzuesit e publikuar. | N/A |
| 5.2.4. Përgatiten dhe publikohen modele të materialeve mësimore digjitale për nivele/klasë dhe fusha/lëndë të ndryshme. | TM3 2023 - TM2 2024 | - | 100,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë modele të materialeve mësimore digjitale për nivele dhe fusha/lëndë të ndryshme të përgatitura dhe publikuara. | Modelet e publikuara të materialeve mësimore digjitale. | N/A |

| **5.3. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
|---|---|---|---|---|
| **Ofrimi i mundësive për shfrytëzim efektiv të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në IEAA dhe IAL** | **Përqindja e IEAA-ve që kanë qasje në internet Broadband dhe që kanë shtrirje të rrjetit të internetit deri në nivel klase.** | **NA** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | |
| | **Raporti nxënës- kompjuter në arsimin parauniversitar.** | **1 kompjuter për rreth 35 nxënës.** | **50%** | |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Numri i licencave të paguara për vit për user/kompjuterë për qëllime arsimore.** | | **NA** | | **1 kompjuter për rreth 21 nxënës.** | | | |
| | **Numri i nxënësve dhe studentëve që përfitojnë licenca falas për vit për kompjuterë për qëllime arsimore.** | | **NA** | | **6000** | | | |
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **240000** | **240000** | **Burimi i verifikimit** | |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 5.3.1. Sigurimi i qasjes në internet me brez dhe rrjetë të dedikuar (të paktën 100 Mbps) për të gjitha IEAA-të. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 450,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>DKA-të | Të gjitha IEAA-të kanë qasje në Internet me brez të dedikuar. | Evidencat nga DKA- të. | N/A<br><br>52 shkolla janë të lidhura me rrjetin/internet të dedikuar (minimum 100mbps). Në proces janë edhe 49 shkolla (momentalisht). Ndërsa në proces prokurimi janë edhe 114 të tjera. Rrjeti është i garantuar për periudhë 5 vjeçare.<br><br>Dy shkolla në komunën e Junikut tashmë kanë qasje në rrjetin e internetit të ofruar nga Telekomi i Kosovës me shpejtësi deri në 100 Mbps. Sfidë mbetet mungesa e pajisjeve digjitale funksionale: Shumica e pajisjeve ekzistuese në kabinetet e informatikës të këtyre shkollave janë jashtë funksionit, çka pengon përdorimin efektiv të qasjes në internet. Pajisjet janë të vjetruara. Kabinetet e informatikës, edhe pse ekzistojnë, posedojnë pajisje që janë të vjetruara dhe jo në gjendje të mirë operacionale. Nevojitet investimi në riparimin ose zëvendësimin e pajisjeve të informatikës për të siguruar që studentët dhe mësimdhënësit të kenë mjetet e nevojshme për të përfituar nga qasja në internet. Gjithashtu, zhvillimi i një programi për përditësimin e vazhdueshëm të teknologjisë në shkolla për të mbajtur pajisjet në gjendje të mirë funksionale dhe për të përmirësuar procesin mësimor. Pavarësisht që kanë qasje në internet me shpejtësi të konsiderueshme, efektiviteti i përdorimit të kësaj teknologjie është i kufizuar për shkak të infrastrukturës së vjetruar dhe të pamjaftueshme të IT-së. Ky fakt tregon një nevojë urgjente për investime në përmirësimin e infrastrukturës digjitale në këto shkolla. Është e rëndësishme te ofrohet mbështetje e vazhdueshme teknike dhe trajnimeve për stafin arsimor për të maksimizuar përfitimin nga teknologjia e disponueshme."<br><br>Në Deçan janë 7 shkolla te instaluar me internet me projekt nga MEF, ndërsa në Podujevë rreth 50% e IEAA kanë qasje në internet dhe në Vushtrri nga 37 shkolla vetëm njëra nuk ka internet. |
| 5.3.2. Instalimi i rrjeteve të brendshme (LAN) me kabllo dhe/ose ëireless në IEAA. | TM3 - TM4 2022<br><br>TM1 2023 - TM4 2026 | 6,000 | 750,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>DKA-të | Të gjitha IEAA-të kanë rrjete të brendshme. | Evidencat nga DKA- të. | N/A<br><br>52 shkolla janë të lidhura me rrjetin/internet të dedikuar (minimum 100mbps). Në proces janë edhe 49 shkolla (momentalisht). Ndërsa në proces prokurimi janë edhe 114 të tjera. Rrjeti është i garantuar për periudhë 5 vjeçare.<br><br>Disa komuna kanë deklaruar se nuk është bërë asnjë përparim në instalimin e rrjeteve të brendshme (LAN) që lejojnë komunikimin dhe |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ndarjen e resurseve brenda institucioneve arsimore të lartë. Ka mungesë të rrjeteve të brendshme bën që institucionet të mos mund të ofrojnë një mjedis të integruar dhe të efektshëm digjital për nxënësve dhe stafin.<br>Rekomandohet sigurimi i fondeve dhe ekspertizës teknike për të realizuar instalimin e rrjeteve të LAN si një prioritet për përmirësimin e infrastrukturës arsimore. Një investim në rrjetet e brendshme do të ishte një hap kyç për të përmirësuar cilësinë e edukimit dhe për të lehtësuar hulumtimin dhe ndarjen e njohurive brenda dhe jashtë institucioneve arsimore"<br>Në Deçan janë 4 shkolla instalim të brendshëm me ndihmën e KFOR-it Italian. Në Vushtrri 5 shkolla janë kryer. Janë në proces të digjitalizimit të 5 shkollave tjera nga MASHTI dhe Ministria e Ekonomisë. |
| 5.3.3. Adoptimi i standardit për furnizimin e IEAA me pajisje të TIK- ut. | TM3 - TM4 2022 | 14,000 | - | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Standardi i aprovuar në formë të UA-së. | Standardet e miratuara nga MASHTI. | N/A |
| 5.3.4. Pajisja e IEAA dhe IAL me kompjuterë dhe aksesorë, tabela interaktive/Smart, TV Smart, projektorë, etj.. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 4,170,000 | Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>DKA-të | Çdo vit gjatë periudhës 4-vjeçare 2023-2026<br>IEAA-të pajisen me:<br>- 3000 kompjuterë.<br>- 2250 Smart TV ose projektorë.<br>- 2250 Pako elektronike për kodim.<br>- 250 Tabela interaktive/smart.<br>- 250 Printerë të rrjetës/fotokopjues. | Evidencat e furnizimit nga MASHTI dhe nga DKA-të. | N/A<br><br>20 shkolla të mesme të ulëta janë pajisur me Tabela të menqura për të realizuar mësimin në formë digjitale (GIZ) .<br><br>Në Junik, DKA-ja ka arritur të blejë vetëm 5 kompjuterë statikë gjatë vitit 2023, të cilët janë në shfrytëzim të nxënësve por nuk janë të mjaftueshëm. Mungesa e pajisjeve kyçe teknologjike siç janë Smart TV-të, projektorët, pakot elektronike për kodim, tabelat interaktive/smart dhe printerët e rrjetës/fotokopjues pengon implementimin e plotë të teknologjisë në procesin edukativ. Mungesa e pajisjeve të përshkruara mund të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe zhvilluar aftësi digjitale, që janë të rëndësishme për suksesin në tregun e punës sot. Nevoja për një vlerësim më të detajuar të përdorimit aktual dhe të mundshëm të teknologjisë në shkolla për të identifikuar prioritete specifike dhe për të lehtësuar blerjet e ardhshme. Në Deçan së paku 4 shkolla janë pajisur me pajisje nga donatoret dhe personat fizik. Në Podujevë shkollat janë pajisur me 40 Kompjuter; 60 llaptop; 80 TV smart, ndërsa ne Vushtrri janë pajisur me 213 llaptop dhe 72 kompjuterë. |
| 5.3.5. Hartohet UA për shfrytëzimin e pajisjeve personale të TIK-ut në IEAA nga mësimdhënësit dhe nxënësit. | TM1 - TM2 2023 | - | 4,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | UA për shfrytëzimin e pajisjeve personale në IEAA është i miratuar. | UA i miratuar nga MASHTI. | N/A |
| 5.3.6. Krijimi i politikës për kreditimin e blerjes së laptopëve personalë për mësimdhënës dhe studentë. | TM1 - TM2 2023 | - | 6,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>Partnerët tjerë/Përfaqësuesit e palëve të interesit | Ekziston marrëveshja mes palëve dhe dokumenti që e rregullon kreditimin e blerjes së laptopëve personalë. | Dokumenti i miratuar. | N/A |
| 5.3.7. Hartimi i udhëzimeve për mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut. | TM1 - TM2 2023 | - | 10,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Udhëzimet e hartuara dhe të aprovuara nga MASHTI. | Udhëzuesi i publikuar. | N/A |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.3.8. Krijimi i klubeve të nxënësve për mirëmbajtje bazike të pajisjeve të TIK-ut nëpër IEAA. | TM3 2023 - TM4 2026 | - | - | NA | IEAA-të<br><br>DKA-të | Rreth 80% e shkollave i krijojnë klubet e nxënësve. | Evidencat e IEAA-ve. | N/A<br><br>Mbështetja në themelimin dhe funksionalizimin e Klubeve të Mediave/Klubeve Digjitale në 20 shkolla të mesme të ulëta/13 komuna të ndryshme (GIZ) .<br><br>Në Junik të dyja institucionet e arsimit të lartë kanë arritur të krijojnë klubet e nxënësve për mirëmbajtje bazike të pajisjeve të TIK-ut, duke plotësuar një pjesë të rëndësishme të objektivave të Planit të Veprimit. Përfshirja e nxënësve në klube kontribuon jo vetëm në mirëmbajtjen e pajisjeve por edhe në zhvillimin e aftësive praktike dhe të mendimit kritik.<br>Klubet mund të shërbejnë si modele për shkollat e tjera në komunë dhe të inkurajojnë ndërtimin e një kulture të mirëmbajtjes dhe përgjegjshmërisë ndaj resurseve teknologjike. Mundësia e klubeve për të rritur ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së teknologjisë në edukim dhe për t'u bërë burim i ndihmës për shkollat në rritjen e aftësive digjitale të studentëve."<br>Ne Podujevë disa shkolla i kanë të formuara klubet e Robotikës. Në Prishtinë nxënësit nga mësuarit në mënyrë teorike ka mundësi përmes të teknologjisë të zhvillojnë punën praktike. |
| 5.3.9. Aftësimi i anëtarëve të klubeve për mirëmbajtjen bazike të pajisjeve të TIK-ut. | TM3 2023 - TM4 2026 | - | 40,250 | Donatorët Buxheti i Kosovës | DKA-të IEAA-të | Trajnohen rreth 3000 nxënës (750 nxënës në vit gjatë viteve 2023-2026). | Evidencat e trajnimeve. | N/A<br><br>Në Junik, krijimi i klubeve të nxënësve në institucionet e arsimit të lartë ka ndodhur, dhe ka një gatishmëri nga ana e nxënësve për të marrë pjesë në trajnime për mirëmbajtjen bazike të pajisjeve të TIK-ut. Rekomandohet bashkëpunimi me kompanitë e TIK-ut për të siguruar pajisje të përdorura ose të riparuar që mund të shërbejnë për qëllime trajnimi.<br>Zhvillimi i një programi të trajnimit teorik përkohësisht, derisa të sigurohen pajisjet, për të përgatitur nxënësit me njohuri bazë që do t'i ndihmojnë më vonë në praktikë. Nevoja për një plan kontingjenti që adreson këtë lloj situate ku gatishmëria për trajnim është e lartë, por mjetet mungojnë.<br>Në Podujeve shkollat që i kanë klubet e robotikës kanë mbajtur edhe trajnime për nxënës ndërsa në Prishtinë rreth 150 nxënës dhe 20 profesorë janë trajnuar me trajnimin Eko- Klubeve. |
| 5.3.10. Krijimi i njësive të mirëmbajtjes së pajisjeve teknologjike në nivelin komunal (për më shumë shih Objektivin specifik 5.5). | TM1 2023 - TM4 2026 | - | - | NA | DKA-të MASHTI | Ekzistojnë njësitë e mirëmbajtjes së pajisjeve teknologjike në nivel komunal. | Lista e zyrtarëve të IT-së të punësuar nga DKA-të. | N/A<br><br>Në Junik është punësuar një zyrtar për teknologji informative, i cili tashmë merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës teknologjike në të dy shkollat. Kjo është një hap pozitiv drejt krijimit të një strukture më të organizuar dhe të qëndrueshme për mirëmbajtjen teknologjike në nivelin komunal. Në Podujevë ekziston zyra e IT në administratën komunale dhe në Vushtrri është i punësuar një mirëmbajtës IT për shkolla nga viti 2012 dhe vazhdon të merret me këtë detyrë. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.3.11. Blerja e licencave për kompjuterë shkollorë/përdorues për personelin dhe zyrtarët arsimorë me çmime të volitshme. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 330,000 | Buxheti i Kosovës | ASHI MASHTI | Blihen 12 000 licenca për user/ kompjuterë shkollorë (në vitin 2023 dhe 2024: 6 000 licenca, në vitin 2025: 9 000 licenca dhe në vitin 2026 12 000 licenca). | Evidencat vjetore të ASHI-së për licencat e paguara. | 40-59%<br><br>Është lidhur kontrata me Microsoft dhe referuar kërkesës së MASHTI janë furnizuar me 6119 (për vit) licenca për kompjuterë shkollorë/përdorues për personelin dhe zyrtarët arsimorë. |
| 5.3.12. Sigurimi i licencave pa pagesë për nxënës dhe studentë. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | - | NA | ASHI MASHTI | Sigurohen licenca të kompjuterëve falas për të gjithë nxënësit dhe studentët. | Evidencat e ASHI-së dhe MASHTI-t. | 80-100%<br><br>Është realizuar ky aktivitet, gjë që në kuadër të kësaj kontrate janë siguruar pa pagesë licencat për nxënës, sipas raportit 1:40, ku në 1 licencë për mësimdhënës dhe administratë të IEAA-së përfitohen 40 licenca për nxënës. |
| 5.3.13. Promovimi i shfrytëzimit të<br>softuerit “open source”. | 0 | - | 10,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI DKA-të/ IEAA-të IAL-të | Ekzistojnë udhëzime dhe aktivitete që promovojnë shfrytëzimin e softuerit “open source". | Evidencat e fushatave dhe aktiviteteve promovuese. | N/A<br><br>Në Junik, zyrtari i IT-së është duke ndjekur trajnim për digjitalizim në platformën ""open source"" Moodle, të mundësuar nga rrjeti KREN. Kjo përfshin përgatitjen për zhvillimin e orëve interaktive duke përdorur mjetet teknologjike. Rekomandohet organizimi i sesioneve të rregullta ndjekëse dhe mbështetëse për mësimdhënësit pas trajnimit për të siguruar që ata janë të rehatshëm dhe efektivë në përdorimin e teknologjive të reja. Si dhe nxitja e një kulture inovative dhe eksperimentuese në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie për të inkurajuar përqafimin e zgjidhjeve ""open source"".<br>Në Prishtinë softeuerit "open source", shfrytëzohet nga disa mësimdhënës dhe kanë treguar rezultate në mësimdhënie dhe mësimnxënine. |

| **5.4. Objektivi Specifik** | **Treguesi** | **Vlera Bazë** | **Synimi i Përkohshëm 2024** | **Burimi** |
|---|---|---|---|---|
| **Zhvillimi i kompetencës digjitale te të gjitha palët në funksion të transformimit të suksesshëm digjital të arsimit dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror** | **Përqindja e mësimdhënësve/edukatorëve në shërbim dhe atyre të ardhshëm në arsimin parauniversitar që dëshmojnë nivel themelor të zotërimit të kompetencës digjitale për mësimdhënës (bazuar në DigCompEdu).** | **NA** | **40%** | **Evidencat dhe raportet e vlerësimit.** |
| | **Numri i personelit akademik në IAL të aftësuar/avancuar për përdorimin e teknologjisë digjitale për mësimdhënie e kërkime shkencore dhe për kultivimin e kompetencës digjitale te studentët.** | **NA** | **600** | **Evidencat e trajnimeve.** |
| | **Përqindja e nxënësve që dëshmojnë nivel themelor të zotërimit të kompetencës digjitale për qytetarë (bazuar në DigComp) me rastin e përfundimit të klasës së nëntë dhe nivel mesatar me rastin e përfundimit të klasës së dymbëdhjetë.** | **NA** | **30%** | **Evidencat dhe raportet e vlerësimit.<br><br>Rezultatet e Testit të Arritshmërisë dhe të Testit të Maturës.** |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Përqindja e institucioneve arsimore (IEAA, IAL, DKA, MASHTI, Agjencitë, Institutet) që i përmbushin kërkesat bazë të kompetencës digjitale për organizatat arsimore (bazuar në kornizën DigCompOrg).** | | **NA** | | **30%** | | **Evidencat dhe raportet e vlerësimit.** | |
| **Veprimi** | **Periudha e zbatimit** | **Buxheti** | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe** | **Produkti (Output)** | **Burimi i verifikimit** | |
| | | **2022** | **2023** | | | | | |
| 5.4.1. MASHTI e zyrtarizon përvetësimin/adaptimin e tri dokumenteve kryesore të BE-së për kompetencën digjitale, përkatësisht tri dokumentet në vijim:<br>- Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp).<br>- Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu).<br>- Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Organizatat Arsimore (DigCompOrg). | TM3 2022 | - | - | NA | MASHTI | Vendimi i Ministrisë së arsimit që e zyrtarizon përvetësimin/adaptimin nga Kosova të tri kornizave evropiane për kompetencën digjitale. | Vendimi i MASHTI-t. | N/A |
| 5.4.2. Përkthimi dhe përshtatja e tri kornizave evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg) në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve. | TM3 2022 | 9,000 | - | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë tri kornizat evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg) janë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve. | Kornizat evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg) të përkthyera. | N/A |
| 5.4.3. Hartimi i udhëzuesve praktikë për zbatimin e tri kornizave evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg) bazuar në rrethanat e Kosovës, përfshirë kategorizimin niveleve të ndryshme të zotërimit të kompetencave të ndryshme për secilën kategori. | TM3 - TM4 2022 | 18,000 | - | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë udhëzues praktikë për të tri kornizat evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg) për mënyrën e zbatimit të tyre në rrethanat e Kosovës. | Udhëzuesit praktikë për tri kornizat evropiane për kompetencën digjitale të publikuar | 80-100%<br>Projekti GIZ/Fit for Jobs mbështeti përkthimin e tre kornizave evropiane për kompetencën dixhitale - DigiComp, DigiCompEdu dhe DigCompOrg - në gjuhën shqipe. Gjithashtu, janë hartuar udhëzime praktike për përshtatjen dhe zbatimin e këtyre kornizave në kontekstin e Kosovës. Për më tepër, Korniza Evropiane për Kompetencat Dixhitale është integruar në kuadrin e Kurrikulës Kombëtare të AFP-së. |
| 5.4.4. Krijimi/adaptimi i instrumenteve për vlerësimin e kompetencës digjitale te kategori të ndryshme (nxënës/studentë, mësimdhënës, institucione, etj.) në përputhje me tri kornizat evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg). | TM3 - TM4 2022 | 18,000 | - | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë instrumente për vlerësimin e kompetencës digjitale te kategori të ndryshme (nxënës/studentë, mësimdhënës, personel arsimor, institucione, etj.) në përputhje me tri kornizat evropiane për kompetencën digjitale (DigComp, DigCompEdu dhe DigCompOrg). | Instrumente për vlerësimin e kompetencës digjitale te kategori të ndryshme të publikuara. | 0-19% |
| 5.4.5. Përcaktimi i kompetencave themelore digjitale për mësimdhënësit në shërbim dhe para shërbimit. | TM1 - TM2 2023 | - | 9,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston dokumenti i aprovuar për kompetencat digjitale themelore te mësimdhënësit në shërbim në Kosovë. | Dokumenti i miratuar nga MASHTI. | N/A |
| 5.4.6. Analiza e programeve të trajnimit në fushën e teknologjisë digjitale dhe e | TM1 - TM2 2023 | - | 11,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Hartohet raporti i analizës së programeve të trajnimit dhe nevojave të mësimdhënësve për | Raporti i analizës.<br>Pako e programit të trajnimit. | N/A |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| nevojave të mësimdhënësve në shërbim për zhvillim të kompetencës digjitale te mësimdhënësit dhe zhvillimi i programeve të trajnimit. | | | | | | ZHP në fushën e kompetencave digjitale.<br><br>Programi i trajnimit në fushën e kompetencave digjitale dhe modulet e trajnimit të aprovuara. | | |
| 5.4.7. Ofrimi i programeve të trajnimit për mësimdhënës në shërbim në fushat e kompetencës digjitale te mësimdhënësit. | TM3 2023 - TM4 2026 | - | 930,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Trajnohen rreth 24 000 mësimdhënësve/edukatorëve x 5 ditë trajnimi (çdo vit gjatë periudhës katërvjeçare 2023-2026 nga 6 000). | Evidencat e trajnimeve. | 80-100%<br><br>Me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar, është përpiluar një planprogram trajnimi për mësuesit e shkollave të mesme të ulëta dhe një program i përshtatur për shkollat e AAP-së. Një trajnim i programit të trajnerëve u përfundua me sukses në pranverë 2023 dhe u pasua nga sesionet e trajnimit të mësuesve që do të përfundonin në nëntor 2023, me rreth 500 mësues. Trajnimi është në proces akreditimi nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve në MESTI. |
| 5.4.8. Mbështetja e mësimdhënësve me materiale ndihmëse, udhëzues praktik për përkrahjen e nxënësve për zotërimin e kompetencës digjitale. | TM3 - TM4 2023 | - | 32,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekzistojnë udhëzues praktikë për mësimdhënësit. | Udhëzuesit praktikë të publikuar. | 40-59%<br><br>Dy konsulentë vendas kanë përpiluar një manual për Kompetencat Dixhitale të Edukatorit në maj 2023. Mësuesit kanë fituar kompetenca dixhitale përmes masave të ndryshme: trajnime për ngritjen e kapaciteteve të cilat përmes mësimdhënies në mënyrë indirekte do t'i ndihmojnë studentët të përmirësojnë aftësitë e tyre dixhitale. Përafërsisht 2000 nxënës të shkollave të mesme të ulëta po trajnohen për të rritur kompetencat dixhitale përmes mekanizmave të bazuar në shkollë (aktivitete që zbatohen me mentorim në klubet dixhitale dhe/ose mediatike të shkollës. Në Junik është krijuar dhe është në përdorim një udhëzues praktik nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, i cili orienton mësimdhënësit mbi si të integrojnë kompetencat digjitale në procesin mësimor dhe në tekste shkollore. Kjo përmbush një pjesë të rëndësishme të planit për të mbështetur mësimdhënësit në këtë fushë. |
| 5.4.9. Përcaktimi i kompetencave themelore digjitale për mësimdhënësit para shërbimit. | TM1 - TM2 2023 | - | 9,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>IAL-të | Ekziston dokumenti i aprovuar për kompetencat digjitale themelore te mësimdhënësit para shërbimit në Kosovë. | Dokumenti i miratuar nga MASHTI. | N/A<br><br>Universiteti i Gjilanit angazhohet në përfshirjen e teknologjisë Informative në Programet studimore të FE-së. |
| 5.4.10. Analiza e programeve aktuale për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm (PMA) lidhur me përfshirjen në programe të fushave të kompetencave themelore digjitale te mësimdhënësit dhe qasjet metodologjike në zhvillimin e tyre të mësimdhënësit e ardhshëm. | TM1 - TM2 2023 | - | 20,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>IAL-të | Ekziston raporti i analizës së përfshirjes së kompetencave digjitale të mësimdhënësve në programet për përgatitje të mësimdhënësve, i harmonizuar me DigCompEdu. | Raporti i analizës. | N/A |
| 5.4.11. Përfshirja e kompetencave themelore digjitale për mësimdhënës në të gjitha programet për PMA, si dhe në programin dhe manualin e mentorimit të studentëve në praktikën pedagogjike. | TM3 - TM4 2023 | - | 11,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI<br><br>IAL-të | Programet për përgatitje të mësimdhënësve dhe manualet e mentorimit të studentëve në praktikën pedagogjike, të rishikuara dhe miratuara. | Programet për përgatitje të mësimdhënësve dhe manualet e mentorimit të studentëve në praktikën pedagogjike të rishikuara dhe të miratuara. | N/A |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.4.14. Zhvillimi dhe hapja e një programi të ri Baçelor në FE të UP-së për përgatitjen e mësimdhënësve të TIK-ut. | TM2 2022 - TM3 2024<br><br>TM3 2024 - TM4 2026 | - | - | NA | UP | Hapet programi i ri Baçelor në FE të UP-së për përgatitjen e mësimdhënësve të TIK-ut. | Dosja e programit të akredituar. | N/A |
| 5.4.15. Vlerësimi i nevojave të personelit akademik për zhvillim profesional në fushat e kompetencës digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore. | TM1 - TM4 2023 | - | - | NA | IAL | Raporti i vlerësimit të nevojave të personelit akademik për ZHP në fushat e kompetencës digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore. | Raporti i analizës së nevojave. | N/A |
| 5.4.16. Përfshirja e kompetencës digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore në planet për zhvillim profesional të personelit akademik të IAL-ve. | TM1 - TM4 2023 | - | - | NA | IAL | Janë hartuar plane për ZHP të personelit akademik nga të gjitha IAL, duke përfshirë edhe zhvillimin e kompetencës digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore. | Planet për zhvillim profesional të personelit akademik të IAL-ve. | N/A<br><br>Në Universitetin e Gjilanit është hartuar Plani i Zhvillimit Profesional për Personel Akademik, ehste bere funksionalizimi I Institutit në FE. krijimi I Qendrës së Trajnimit dhe organizimi i trajnimeve për zhvillim të kompetencave digjitale. |
| 5.4.19. Kompetenca digjitale e personelit akademik futet si standard i ri në UA-në përkatëse që e rregullon këtë çështje. | TM1 - TM4 2023 | - | - | NA | MASHTI<br>AKA | Kompetenca digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore ekziston si kriter në UA-në e rishikuar. | UA i miratuar nga MASHTI. | N/A |
| 5.4.20. Analizimi i përfshirjes së kompetencës digjitale për qytetarët në kurrikulat lëndore për klasë në nivelet e arsimit parauniversitar, si vazhdimësi e dokumenteve kurrikulare (KK dhe KB). | TM1 - TM2 2023 | - | 8,000 | Donatorët<br>Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston raporti i analizës së përfshirjes së fushave të kompetencës digjitale për qytetarët në kurrikulat lëndore parauniversitare, duke pasur pikë-referencë DigComp. | Raporti i analizës. | N/A |
| 5.4.21. Rishikimi i kurrikulave lëndore bazuar në rekomandimet nga analizimi i përfshirjes së kompetencës digjitale për qytetarët në kurrikulat lëndore ekzistuese, si dhe fillimi/fuqizimi i lëndëve/përmbajtjeve të reja (si: kodimi, programimi, etj.). | TM3 2023 - TM2 2024 | - | 20,000 | Donatorët<br>Buxheti i Kosovës | MASHTI | Kurrikulat/programet lëndore për klasë të rishikuara dhe të aprovuara nga MASHTI përfshijnë fushat e kompetencave digjitale të veçanta për qytetarët, duke pasur pikë- referencë DigComp. | Raportet e rishikimit të kurrikulave. | N/A |
| 5.4.23. Zhvillimi udhëzuesve për vlerësimin e kompetencës digjitale të nxënësve në klasë dhe përmes testeve kombëtare dhe për vlerësimin e kompetencës digjitale te studentët, si dhe përdorimi i instrumenteve për vlerësimin e kompetencës digjitale të nxënësve/studentëve. | TM1 - TM3 2023<br><br>TM1 2024 - TM4 2026 | - | 19,000 | Donatorët<br>Buxheti i Kosovës | MASHTI | Hartohen dhe publikohen udhëzuesit për vlerësimin e kompetencës digjitale të nxënësve/studentëve.<br><br>Kompetenca digjitale te nxënësit/studentët vlerësohet sistematikisht. | Udhëzuesit e publikuar.<br><br>Raportet e vlerësimit dhe rezultatet e testeve shtetërore. | N/A |
| 5.4.25. Organizimi i ngjarjeve dhe projekteve për nxënës dhe studentë që mundësojnë zhvillimin dhe promovimin e kompetencës digjitale për qytetarët. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 100,000 | Donatorët<br>Buxheti i Kosovës | MASHTI | Çdo vit gjatë periudhës katërvjeçare 2023-2026 organizohen ngjarje/projekte që kanë për qëllim zhvillimin dhe promovimin e kompetencës digjitale te qytetarët (nxënësit/studentët). | Raportet e ngjarjeve/projekte ve të realizuara. | N/A |
| 5.4.26. Kultivimi i kompetencës digjitale te studentët futet si kërkesë për akreditim për çdo program studimi në IAL. | TM1 - TM4 2023 | - | - | NA | MASHTI<br>AKA | Kompetenca digjitale për studentët ekziston si kriter për akreditim të programeve të studimit në UA-në e rishikuar. | UA i miratuar nga MASHTI. | N/A |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.4.27. Përcaktimi i kompetencave themelore digjitale të personelit udhëheqës, menaxherial, administrativ e profesional, jo-mësimdhënës të institucioneve të fushës së arsimit (IEAA, IAL, DKA, MASHTI, Agjencitë, Institutet). | TM1 - TM2 2023 | - | 9,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston dokumenti i aprovuar për kompetencat digjitale themelore të personelit udhëheqës, menaxherial, administrativ e profesional jo-mësimdhënës të institucioneve të fushës së arsimit (IEAA, IAL, DKA, MASHTI, Agjencitë, Institutet) në Kosovë. | Dokumenti i miratuar nga MASHTI. | N/A |
| 5.4.28. Vlerësimi i nevojave të personelit në institucionet arsimore për zhvillim të kompetencës digjitale dhe zhvillimi i programit të trajnimit. | TM3 - TM4 2023 | - | 13,000 | Donatorët Buxheti i Kosovës | MASHTI | Raporti i vlerësimit të nevojave të personelit të institucioneve arsimore në fushat e kompetencës digjitale.<br><br>Përgatitet programi i trajnimit. | Raporti i nevojave. | N/A |

| 5.5. Objektivi Specifik | Treguesi | Vlera Bazë | Synimi i Përkohshëm 2024 | Burimi |
|---|---|---|---|---|
| **Krijimi i mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit në mënyrë efektive dhe efikase** | **Numri i zyrtarëve për Teknologji dhe Digjitalizim në arsim të punësuar në Ministri.** | **0** | **6** | **Lista e të punësuarve në MASHTI.** |
| | **Numri i zyrtarëve të IT- së të punësuar nga DKA-të për mirëmbajtjen e rrjetit dhe pajisjeve teknologjike nëpër IEAA.** | **0** | **50** | **Lista e të punësuarve nga DKA-të.** |
| | **Numri i koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim të punësuar nga DKA-të për përkrahjen e shkollave për përdorim të teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim.** | **0** | **50** | **Lista e të punësuarve nga DKA-të.** |
| | **Numri i koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim të caktuar/punësuar nga IAL, Agjencitë, Institutet, etj..** | **0** | **30** | **Evidencat e IAL-ve, Agjencive dhe Instituteve.** |

| Veprimi | Periudha e zbatimit | Buxheti | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe | Produkti (Output) | Burimi i verifikimit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2023 | | | | | |
| 5.5.1. Krijimi i Divizionit për Teknologji dhe Digjitalizim në Ministrinë e Arsimit. | TM4 2022<br><br>TM1 2023<br><br>TM1 2024<br><br>TM1 2025 | 5,547 | 27,572 | Buxheti i Kosovës | MASHTI | Ekziston Divizioni për Teknologji dhe Digjitalizim në MASHTI.<br><br>Punësohen 7 zyrtarë për Teknologji dhe Digjitalizim në MASHTI (2 në vitin 2022, 2 në vitin 2023, 2 në vitin 2024 dhe 1 në vitin 2025). | Lista e zyrtarëve të punësuar në MASHTI. | N/A<br><br>Divizioni për Teknologji dhe Digjitalizim në MASHTI ende nuk është krijuar, për arsye se ende nuk është miratuar organogrami i ri i MASHTI-t. |
| 5.5.2. Krijimi i njësive të mirëmbajtjes së rrjetit dhe pajisjeve teknologjike nëpër IEAA në niveli komunal.<br>Punësimi i Specialistëve të IT-së. | TM1 2023 - TM4 2026 | - | 257,850 | Buxheti i Kosovës | DKA-të MASHTI | Punësohen 100 specialistë të IT-së nga DKA-të (nga 25 persona çdo vit gjatë katër viteve 2023-2026).<br><br>Afërsisht 1 specialist i IT-së për rreth 230 kompjuterë/ pajisjet tjera teknologjike (duke llogaritur vetëm furnizimet e reja). | Listat e specialistëve të IT-së të punësuar nga DKA-të. | N/A |

DRAFT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.5.3. Punësimi i koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim në nivel komunal për përkrahjen e IEAA-ve për përdorim të teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim. Paraprakisht hartohen Termat e Referencës për koordinatorët. | TM3 2023<br><br>TM1 2024 - TM4 2026 | - | 2,000 | Buxheti i Kosovës | DKA-të MASHTI | Punësohen 100 koordinatorë për Teknologji dhe Digjitalizim nga DKA-të (50 persona në fillim të vitit 2024 dhe 50 persona në fillim të vitit 2025).<br><br>Afërsisht 1 koordinator për rreth 230 mësimdhënës ose 1 koordinator për rreth 11 IEAA. | Listat e koordinatorëve të punësuar nga DKA- të. | N/A<br><br>Në Junik është punësuar një koordinator për Teknologji dhe Digjitalizim. Planifikimi për punësimin e koordinatorëve shtesë nëse është e nevojshme, për të siguruar mbulim më të gjerë dhe më efikas të të gjitha IEAA-ve në komunë. Gjithashtu në Podujevë është punësuar një ekspert i IT-së në DKA dhe në Deçan janë duke u zhvilluar procedurat e përzgjedhjes së një koordinatori për IT. |

DRAFT